



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 61

24 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 116/2013
datë 15.4.2013

Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline Ag, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline Ag, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)..... 2645

Ligj nr. 117/2013
datë 15.4.2013

Për ratifikimin e protokollit të katërt shtesë të Konventës Europiane të Ekstradimit..... 2721

LIGJ
Nr. 116/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME QEVERINË E VENDIT PRITËS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK PIPELINE AG, LIDHUR ME PROJEKTIN E
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP), SI DHE TË MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I
MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK PIPELINE AG, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8106, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

5 PRILL 2013

**MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE
TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS
ADRIATIK**

HYRJE

Kjo Marrëveshje lidhet në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë sot në datën 5 prill 2013, midis:

1. REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Shteti), përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave; dhe
2. TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, një Shoqëri e organizuar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e Zvicrës, me degë në Republikën e Shqipërisë pranë adresës: “Torre



Drin”, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit në Tiranë, me nr. regjistrimi të subjektit: K92402023O (Investitori i Projektit dhe bashkërisht me Shtetin, Palët).

MEQENËSE:

A. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Investitori i Projektit, në mirëbesim kanë ndërmarrë një sërë negociatash në lidhje me formën, përmbajtjen dhe tekstin e një marrëveshjeje me qeverinë pritëse (MQP) për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti).

B. Në datën 18 janar 2013, Këshilli i Ministrave i Shtetit dhe Investitori i Projektit nënshkruan një Marrëveshje Paraprake (MP), e cila bashkëngjitur përmban një version të miratuar të MQP-së me disa ndryshime, që duhet të kryhen mbi versionin e MQP-së të rënë dakord, përpara nënshkrimit nga Palët. Midis ndryshimeve të tjera të rëna dakord në MP-në, kishte rregullime në lidhje me versionin e rënë dakord, me qëllim përafrimin e tij me marrëveshjen me qeverinë pritëse që do të lidhet midis Investitorit të Projektit dhe Republikës së Greqisë (MQP me Greqinë), për sa u përket disa çështjeve specifike financiare.

C. MQP-ja me Greqinë nuk është lidhur ende dhe as është rënë dakord në lidhje me formën e dokumentit të kësaj marrëveshjeje. Rrjedhimisht, qëndrimi i Republikës së Greqisë në lidhje me çështjet financiare specifike të cituara më sipër, nuk është qartësuar në mënyrë përfundimtare nga Palët.

D. Pavarësisht sa më sipër, Palët kanë vijuar me nënshkrimin e MQP-së dhe Shteti do të vijojë më tej me ratifikimin e MQP-së nga Parlamenti Shqiptar, duke marrë në konsideratë faktin që nëse do të jetë e nevojshme, MQP-ja do të ndryshohet nga Palët në përputhje me këtë Marrëveshje, me qëllim përafrimin e saj me MQP-në e Greqisë për sa u përket çështjeve specifike financiare.

E. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është rrjedhimisht vendosja e kriterëve për çdo ndryshim të MQP-së dhe të sigurojë që Palët do të nënshkruajnë dokumentacionin e nevojshëm dhe do të vijojnë me ratifikimin e mëtejshëm ose veprimet e tjera, me qëllim që të sigurojnë se MQP-ja, e ndryshuar, është e vlefshme dhe ka fuqinë e ligjit të Shtetit. Kjo Marrëveshje përcakton, gjithashtu, bazat mbi të cilat Palët kanë rënë dakord për të negociuar dhe për të përfunduar një marrëveshje angazhimi për zhvillimin e tregjeve të gazit, si dhe një marrëveshje për përfitimet vendase.

F. Është rënë dakord që kjo Marrëveshje do të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar njëkohësisht me MQP-në, përveç rastit kur është zgjidhur në përputhje me nenin 3.

Palët kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. MQP-ja

Përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk do të kenë detyrimin për të kryer ndryshime të MQP-ja.

2. Ndryshimet e kërkuara në lidhje me MQP-në pas nënshkrimit dhe/ose ratifikimit.

Secila nga Palët merr përsipër, sa më parë të jetë e mundur, pas nënshkrimit të MQP-së me Greqinë, të nënshkruajë të gjithë dokumentacionin që mund të jetë i nevojshëm për ndryshimin e MQP-së si vijon:

a) Nëse në MQP me Greqinë, Investitorit të Projektit i kërkohet:

i) të paguajë ndonjë formë tarife në favor të Republikës së Greqisë, të cilën në kushte normale sipas legjislacionit grek, Investitori i Projektit nuk do të ishte i detyruar ta paguante, me kërkesën e Shtetit, do të ndryshohet MQP-ja, në mënyrë të tillë që Investitori i Projektit të detyrohet të paguajë një tarifë të përlogaritur mbi të njëjtën bazë si tarifa e parashikuar në MQP me Greqinë, por nuk do të kryhet asnjë ndryshim, i cili ka si efekt zvogëlimin e tarifave që Investitori i Projektit është i detyruar të paguajë në favor të Shtetit; ose

ii) të paguajë në favor të Republikës së Greqisë një shumë më të madhe tatimesh sesa ajo që Investitori i Projektit do të ishte i detyruar të paguante në kushte normale sipas legjislacionit grek, me kërkesën e Shtetit, do të ndryshohet MQP-ja në mënyrë të tillë që Investitori i Projektit të detyrohet të paguajë në favor të Shtetit tatime shtesë, të cilat pasqyrojnë në mënyrë proporcionale

shumën shtesë të tatimeve që Investitori i Projektit është i detyruar të paguajë në favor të Republikës së Greqisë në krahasim me legjislacionin në fuqi në Greqi;

b) nëse Investitori i Projektit është i detyruar të paguajë ndonjë shumë financiare në Greqi, ekuivalenti i së cilës është shprehimisht i përjashtuar sipas MQP-së, do të ndryshohet dispozita përkatëse e MQP-së, në mënyrë që të jetë në përputhje me pozitën e Investitorit të Projektit në Greqi; dhe

c) nëse pikënisja e negociatave për MCP-në (siç është përcaktuar në MQP) është më e lartë në Greqi se ajo e përcaktuar në klauzolën 24.8 (a) dhe (b) të MQP-së;

dhe Shteti do të ndërmarrë çdo hap të mëtijshëm, i cili mund të jetë i nevojshëm që të sigurohet se MQP-ja e ndryshuar ka fuqinë e ligjit të Shtetit, përfshirë, por pa u kufizuar, çdo ratifikim të MQP-së nga Parlamenti Shqiptar, siç mund të jetë e nevojshme për këtë qëllim.

3. Marrëveshja e angazhimit për zhvillimin e tregjeve të gazit

a) Palët kanë rënë dakord mbi kushtet paraprake të përcaktuara në aneksin 1 në lidhje me Marrëveshjen e angazhimit për zhvillimin e tregjeve të gazit (Marrëveshja për AZHTG), e cila do të përcaktojë veprimet që duhet të ndërmerren nga Investitori i Projektit, në rast vendimi pozitiv të tij për ndërtimin (VPN) në lidhje me zhvillimin e tregut shqiptar të gazit.

b) Menjëherë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të angazhohen në mirëbesim dhe në mënyrë bashkëpunuese për hartimin e plotë të Marrëveshjes për AZHTG në mënyrë të tillë që ajo:

i) të pasqyrojë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në aneksin 1;

ii) të përfshijë procese dhe kushte të detajuara, në mënyrë që të bëjë të mundur zbatimin në praktikë të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në aneksin 1; dhe

iii) të jetë e mundur vënia në zbatim.

c) Pavarësisht sa më sipër, Palët deklarojnë se një VPN pozitiv do të shërbejë si kusht paraprak për zbatimin dhe vlefshmërinë e Marrëveshjes për AZHTG.

4. Marrëveshja për përfitimet vendase

a) Palët kanë rënë dakord në lidhje me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në aneksin 2, për sa i përket marrëveshjes për përfitimet vendase, e cila do të përcaktojë veprimet që do të ndërmerren nga Investitori i Projektit në lidhje me përfitimet lokale, të cilat duhet të sigurohen si pasojë e Projektit.

b) Menjëherë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të angazhohen në mirëbesim dhe në mënyrë bashkëpunuese për hartimin e plotë të Marrëveshjes për përfitime lokale, në mënyrë që ajo:

i) të pasqyrojë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në aneksin 2;

ii) të përfshijë procese dhe kushte të detajuara, në mënyrë që të bëjë të mundur zbatimin në praktikë të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në aneksin 2;

iii) të jetë e mundur vënia në zbatim.

c) Pavarësisht sa më sipër, Palët deklarojnë se një VPN pozitiv do të shërbejë si kusht paraprak për zbatimin dhe vlefshmërinë e Marrëveshjes për përfitimet vendase.

5. Kohëzgjatja

a) Efektet e kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe ligji, i cili ratifikon këtë Marrëveshje është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe (përveç nëse Palët bien dakord që kjo Marrëveshje të zgjidhet përpara përfundimit të afatit) do të përfundojë:

i) për efekt të nenit 2, në momentin e verifikimit të njërit prej kushteve të mëposhtme, i cili verifikohet i pari:

A. Në datën e nënshkrimit të MQP-së me Greqinë, nëse, në atë datë, nuk do të rezultonte asnjë detyrim për Palët për të ndërmarrë ndonjë veprim në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;



B. Në datën kur Palët do të kenë përfunduar të gjitha veprimet që kërkohen prej tyre në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

C. Në datën kur Investitori i Projektit njofton Shtetin se Gazsjellësi TAP nuk është përzgjedhur nga Konsorciumi Shah Deniz, faza II sipas kushteve, të cilat janë të pranueshme për aksionarët e Investitorit të Projektit; dhe

ii) për efekt të nenit 3 dhe 4:

A. Në datën në të cilën Palët kanë përfunduar të gjitha veprimet që kërkohen të ndërmerren prej tyre në përputhje me këtë dispozitë të Marrëveshjes; dhe

B. Në datën kur Investitori i Projektit njofton Shtetin se Gazsjellësi TAP nuk është përzgjedhur nga Konsorciumi Shah Deniz, faza II, sipas kushteve, të cilat janë të pranueshme për aksionarët e Investitorit të Projektit.

b) Kjo Marrëveshje do të përfundojë nëse MQP-ja për çdo arsye nuk do të jetë më e vlefshme dhe në fuqi.

6. Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje, si dhe çdo e drejtë dhe detyrim jashtëkontraktor i lindur si pasojë ose në përputhje me të, do të rregullohen sipas ligjit anglez.

7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Çdo mosmarrëveshje, pretendim ose pakënaqësi, që mund të lindë në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë mosmarrëveshjet që lidhen me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin, mospërbushjen ose zgjidhjen e saj, ose që lidhet me pasojat e pavlefshmërisë së saj, si dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me detyrime jashtëkontraktore që lindin si pasojë ose në përputhje me të (për efekt të këtij neni "Mosmarrëveshja"), do të depozitohet dhe zgjidhet me arbitrazh sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (për efekt të këtij neni "Rregullat").

b) Rregullat janë përfshirë sipas referimit në këtë paragraf dhe fjalët me germa të mëdha të përdorura në këtë paragraf, të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u është dhënë atyre të Rregullat.

c) Numri i arbitrave do të jetë një. Në përputhje me nenin 12 (3) të Rregullave, Palët do të emërojnë bashkërisht arbitrin e vetëm, i cili do të miratohet nga Gjykata e Dhomës Ndërkombëtare e Tregtisë. Secila Palë bie dakord shprehimisht dhe jep miratimin e saj për këtë procedurë lidhur me emërimin dhe caktimin e Gjykatës së Arbitrazhit.

d) Selia apo vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë Londra dhe gjuha e përdorur në procedurat e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

e) Njoftimi i çdo kërkesë për arbitrazh, të paraqitur në përputhje me këtë paragraf, do të kryhet në adresën e dhënë për dërgimin e njoftimeve sipas nenit 8 (c) të kësaj Marrëveshjeje.

f) Përfshihet juridiksioni i gjykatave angleze sipas aktit të 45-të dhe të 69-të të arbitrazhit të vitit 1996.

8. Të ndryshme

a) Fjalët me germa të mëdha, të përdorura në këtë Marrëveshje të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe, do të kenë kuptimin që iu është dhënë atyre në MQP.

b) Rregullat për interpretimin dhe kuptimin të përcaktuara në MQP do të zbatohen *mutatis mutandis* në këtë Marrëveshje.

c) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen në adresat e përcaktuara në MQP.

d) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk krijon të drejta të ekzekutueshme nga palë të treta.

e) Kjo Marrëveshje nuk do të modifikohet apo ndryshohet përveç nëse është rënë dakord me shkrim midis të dyja Palëve.

f) Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në versionin në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Në rast mospërputhje midis këtyre dy versioneve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: Florjon Mima

Pozicioni: Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

INVESTITORI I PROJEKTIT

Trans Adriatic Pipeline AG

Nga: Kjetil Tungland

Pozicioni: Drejtor Menaxhues

ANEKSI 1

MARRËVESHJA E ANGAZHIMIT PËR ZHVILLIMIN E TREGJEVE TË GAZIT - KUSHTET PARAPRAKE

Palët	Republika e Shqipërisë (Shteti) Trans Adriatic Pipeline AG (Investitori i Projektit)
Marrëveshja për AZHTG	Marrëveshja për AZHTG-në do të jetë ligjërish detyruese për Palët. Marrëveshja AZHTG: a) do të pasqyrojë angazhimet TG dhe kushtet TG të përshkruara më poshtë; dhe b) do të përfshijë procese dhe kushte të detajuara, në mënyrë që të mundësojë zbatimin në praktikë të angazhimeve TG dhe përmbushjen e kushteve TG.
Angazhimet TG	Sipas Marrëveshjes për AZHTG, Investitori i Projektit do të ndërmarrë (në varësi të përmbushjes së kushteve GM të përcaktuara më poshtë) veprimet e mëposhtme (Angazhimet TG) në lidhje me zhvillimin e tregut të brendshëm shqiptar të gazit: a) do të koordinojë prokurimin për dhe zbatimin e një studimi fizibiliteti të zhvillimit të tregut të gazit (Studimi i Fizibilitetit) lidhur me potencialin për një treg të brendshëm shqiptar të gazit (Angazhimi TG #1); b) do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të kërkuar financimin nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit dhe palë të tjera të interesuara në lidhje me Studimin e Fizibilitetit (Angazhimi TG #2); c) në rast se financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit dhe palë të tjera të interesuara në lidhje me vlerësimin është i pamjaftueshëm, do të financojë Studimin e Fizibilitetit deri në një vlerë maksimale prej 250.000 euro (Angazhimi TG #3); d) do të projektojë, do të prokurojë dhe do të ndërtojë pajisjet për reduktimin e presionit dhe pajisjet matëse në një pikë të vetme dalëse të pranuar (pika fillestare dalëse shqiptare) për kërkesën e parë sipas skenarit për kapacitetin e rezervimit të referuar në Kushtin TG (c)



	(ii), këtu më poshtë, nga Sistemi i Gazsjellësit në rrjetin shqiptar të shpërndarjes së gazit dhe/ose linjat direkte të lidhjes (Angazhimi TG #4), me kusht që në asnjë rast kapaciteti minimal për Pikë Fillestare Dalëse Shqiptare të mos bjerë nën 0,3 BCM në vit.
Kushtet TG	Përmbushja e kushteve të mëposhtme (Kushtet TG) do të jenë një parakusht për detyrimin e Investitorit të Projektit të përmbushë angazhimet përkatëse TG: a) Kushtet TG ndaj të gjitha Angazhimeve TG: i) Konsorciumi i Shah Deniz, faza II, ka përzgjedhur Gazsjellësin TAP sipas kushteve të pranueshme nga aksionarët e Investitorit të Projektit; ii) Marrëveshja Ndërqeveritare dhe MQP-ja janë nënshkruar, ratifikuar nga Parlamenti i Shtetit dhe janë bërë efektive dhe kanë hyrë në fuqi; iii) është marrë një VPN pozitiv; dhe iv) Palët kanë rënë dakord se rezultatet e Studimit Paraprak të Fizibilitetit të ndërmarra sipas këtij dokumenti justifikojnë zbatimin e Angazhimeve TG. b) Kushtet TG shtesë për Angazhimet TG #1 dhe #3: i) të jenë siguruar angazhime për financimin e mjaftueshëm të Studimit të Fizibilitetit, duke marrë në konsideratë pjesën takuese të financimit të Investitorit të Projektit, referuar në Angazhimin TG #3. c) Kushtet TG shtesë ndaj Angazhimit TG #4: i) jo më vonë se dy vjet pas Datës së Operimit Tregtar ekziston ose do të ekzistojë një rrjet vendas shpërndarjeje i gazit në Shqipëri dhe/ose linja direkte lidhjeje; dhe ii) ekziston një kapacitet rezervimi i përshtatshëm sipas metodologjisë së tarifave të TAP.
Ligji i zbatueshëm	Marrëveshja për AZHTG do të rregullohet nga ligji anglez.
Dispozita shtesë	Marrëveshja për AZHTG do të përfshijë parashikime që janë në mënyrë të arsyeshme të zakonshme për marrëveshje të ngjashme, përfshirë këtu (pa u kufizuar) në lidhje me kufizimin e përgjegjësisë, sipërmarrjet e bashkëpunimit, përfaqësuesit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konfidencialitetit.
Përkufizimet	Termat me germa të mëdha të përdorura në këtë aneks do të kenë kuptimin e përcaktuar në MQP, nëse nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje.

ANEKSI 2
MARRËVESHJA E PËRFITIMEVE VENDASE – KUSHTET PARAPRAKE

Palët	Republika e Shqipërisë (Shteti) Trans Adriatic Pipeline AG (Investitori i Projektit)
Marrëveshja për përfitimet vendase	Marrëveshja për përfitimet vendase do të jetë ligjërisht detyruese për Palët. Marrëveshja për përfitimet vendase: a) do të pasqyrojë Angazhimet PV dhe Kushtet PV të përshkruara më poshtë; dhe b) do të përfshijë procese dhe kushte të detajuara, në mënyrë që të mundësojë zbatimin në praktikë të Angazhimeve PV dhe përmbushjen e kushteve PV.
Angazhimet PV	Në përputhje me Marrëveshjen për përfitimet vendase, Investitori i Projektit do të ndërmarrë (në varësi të përmbushjes së kushteve PV të përcaktuara më poshtë) aktivitetet e mëposhtme (Angazhimet PV) në lidhje me sigurimin e përfitimeve vendase brenda territorit shqiptar: a) të përmirësojë të dhënat kadastrale për korridorin e Sistemit të Gazsjellësit dhe për dy zonat kadastrale që nuk kanë përfunduar regjistrimin fillestar, sikurse parashikohet në Marrëveshjen Kadastrale; b) të zbatojë standarde ndërkombëtare, siç janë Kërkesat e Performancës së Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si pikë referimi për planifikimin dhe zbatimin e Projektit; c) të rekrutojë dhe të përdorë burimet vendase, të bashkëpunojë me bizneset vendase dhe për aq sa është e lejueshme nga ligji i zbatueshëm, t'i japë përparësi nëse kanë kualifikime të barabarta dhe janë në përputhje me kërkesat e Investitorit të Projektit; d) të rrisë aftësitë e partnerëve vendas dhe të krijojë mundësitë ekonomike përmes forcimit të trajnimit profesional dhe teknik vendor lidhur me gazin dhe edukimin lidhur me gazsjellësit; e) të investojë shumën prej 2.000.000 euro në një program përmirësimi të aftësive të ndërmarrjeve dhe të fuqisë punëtore shqiptare për të rritur mundësitë e tyre për të përfituar nga zbatimi i Projektit në Shqipëri; f) të investimojë shumën prej 5.000.000 euro për të përmirësuar kushtet e jetesës në komunitetet përreth dhe biodiversitetin dhe pyjet në zonë dhe përreth mjediseve të banimit më të prekura nga projekti; dhe g) t'i japë autoriteteve lokale dhe komunitetit mundësinë për të marrë përsipër përgjegjësi dhe për të përfituar nga infrastrukturën e lidhura me Projektin (rrugët hyrëse, furnizimi me ujë, vendet përpunimit të mbetjeve, sistemet e derdhjes së ujërave të zeza etj.).



Kushtet PV	Përmbushja e sa më poshtë (Kushtet PV) përbën kusht paraprak për lindjen e detyrimit të Investitorit të Projektit për të përmbushur Angazhimet PV përkatëse: a) Kushtet PV ndaj të gjitha Angazhimeve PV: i) është marrë një VPN-je pozitive; b) Kushtet PV shtesë ndaj Angazhimeve PV (e): i) Konsorciumi Shah Deniz, faza II ka përzgjedhur Gazsjellësin TAP sipas kushteve të pranueshme për aksionarët e Investitorit të Projektit; c) Kushtet PV shtesë ndaj Angazhimeve PV (f) & (g): i) Konsorciumi Shah Deniz, faza II ka përzgjedhur Gazsjellësin TAP sipas kushteve të pranueshme për aksionarët e Investitorit të Projektit; ii) Marrëveshja Ndërqeveritare dhe MQP-ja janë nënshkruar, ratifikuar nga Parlamenti i Shtetit dhe gjithashtu janë bërë efektive dhe kanë hyrë në fuqi.
Ligji i zbatueshëm	Ligji anglez do të rregullojë Marrëveshjen për përfitimet vendase.
Dispozita shtesë	Marrëveshja për përfitimet vendase do të përfshijë parashikime që janë në mënyrë të arsyeshme të zakonshme për marrëveshje të ngjashme, përfshirë këtu, (pa u kufizuar) në lidhje me kufizimin e përgjegjësisë, sipërmarrjet e bashkëpunimit, përfaqësuesit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konfidencialitetit.
Përkufizimet	Termat që fillojnë me germa të mëdha, të përdorura në këtë aneks do të kenë kuptimin e parashikuar në MQP, nëse nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë dokument.

MARRËVESHJE ME QEVERINË E VENDIT PRITËS

5 PRILL 2013

MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DUKE VEPRUAR NËPËRMIJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG LIDHUR ME PROJEKTIN E
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK

PREAMBULA

Kjo Marrëveshje me qeverinë e vendit pritës është lidhur në qytetin e Tiranës në Republikën e Shqipërisë, në datën 5 prill 2013,

Midis:

1. Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave; dhe
2. TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Zvicrës, me një degë të regjistruar në Shqipëri në adresën: “Torre Drin”, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë me nr. regjistrimi K92402023O.

HYRJE:

A. Investitori i Projektit dhe Palët e Interesuara janë duke konsideruar ndërtimin e një sistemi gazsjellës eficient, të sigurt, të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për transportimin e gazit natyror të prodhuar nga faza II në fushën Shah Deniz në Republikën e Azerbajxhanit dhe më pas nga rajoni më gjerë, nga një pikë ndërlidhëse në Republikën e Greqisë në të gjithë territorin e Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë dhe përtej nën detin Adriatik për shpërndarjen në tregjet brenda Republikës së Italisë.

B. Palët pranojnë se Projekti është i një rëndësie strategjike dhe se ai do t'i mundësojë Republikës së Shqipërisë të bëhet një vend tranzit qendror për sigurinë e energjisë së Bashkimit Europian dhe në diversitetin e objektivave të furnizimit; ai do të sjellë furnizime të mundshme të gazit natyror, të ardhura fiskale dhe përfitime të tjera ekonomike që Projekti do të sjellë për Republikën e Shqipërisë; dhe kjo paraqet mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm në lidhje me projekte të ardhshme në fushën e energjisë, duke përfshirë ato që lidhen me magazinimin e gazit.

C. Bazuar në afatet dhe në kushtet e kësaj Marrëveshjeje, marrëveshjet e Projektit dhe marrëveshjet e tjera tregtare të lidhura në pajtim dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë edhe kontratat e zbatimit, Investitori Projekti do të ketë të drejtë, në Republikën e Shqipërisë, të zbatojë Projektin dhe të ndërtojë, të zotërojë dhe të operojë Sistemin e Gazsjellësit dhe të shfrytëzojë kapacitetin që do të rezultojë nga Sistemi i Gazsjellësit.

D. Shteti bie dakord të nxisë dhe të mbrojë investimin në Sistemin Gazsjellës dhe të ruajë ndërtimin efikas, të sigurt, të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm, pronësinë dhe operimin e Sistemit të Gazsjellësit brenda Territorit të Republikës së Shqipërisë, në pajtim me detyrimet e shprehura në këtë Marrëveshje, Marrëveshjet e Projektit, Marrëveshjet Ndërqeveritare, Marrëveshjen Ndërqeveritare, MÇP-në, Traktatin e Kartës së Energjisë, Marrëveshjen e lidhur midis Zvicrës dhe Republikës së Shqipërisë datë 22 shtator 1992 për promovimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve (BIT zviceran) dhe Konventën ndërmjet Zvicrës dhe Shtetit për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

E. Shteti hyn në këtë Marrëveshje në emër të, dhe në mënyrë të tillë që të ngarkojë me detyrime të gjitha palët shtetërore.

F. Është parashikuar që aksionarët e Investitorit të Projektit mund të ndryshojnë nga koha në kohë pas datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

G. Kjo Marrëveshje lidhet mbështetur, në vijim të dhe sipas Marrëveshjes Ndërqeveritare të nënshkruar në Athinë më 13 shkurt 2013 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Greqisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë lidhur me Gazsjellësin Trans Adriatik dhe ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 25 mars 2013 dhe, ndër të tjera, me qëllim zbatimin në legjislacionin shqiptar të detyrimeve, marrëveshjeve dhe angazhimeve shtetërore të parashikuara në, ose në lidhje me Marrëveshjen Ndërqeveritare.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord si më poshtë:

interpretime dhe qëllimi i marrëveshjes

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Fjalët me germa të mëdha të përdorura në këtë Marrëveshje (përfshirë preambulën), dhe jo ndryshe të përcaktuara këtu, kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Aktivitete të Projektit” do të thotë aktivitetet e kryera ose që do të kryhen nga Pjesëmarrësit në Projekt në lidhje me Projektin.

“Aplikim për Përfundim” do të thotë çdo aplikim për përfundim në bazë të:



a) Nenit 35 të Direktivës 2009/73/ED dhe nenit 1, paragrafi 17, i ligjit italian të datës 23 gusht 2004, nr. 239, të ndryshuar në vijim, dhe dekretit ministror italian datë 11 prill 2006, të dorëzuar nga Investitori i Projektit më 31 gusht 2011 në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik Italiane (MZHE);

b) Nenit 36 të Direktivës 2009/73/EC të datës 13 korrik 2009, që shfuqizon direktivën 2003/55/EC dhe nenit 76, paragrafi 1 dhe 2 i ligjit mbi operimin e tregjeve, kërkimit, prodhimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe rrjeteve të shpërndarjes së hidrokarbureve, si dhe dispozita të tjera të dorëzuar nga Investitori i Projektit në datën 31 gusht 2011 pranë Autoritetit Rregullator të Energjisë (ARE) të Greqisë; dhe

c) Nenit 22 të Direktivës 2003/55/EC të datës 26 qershor 2003 dhe nenit 40, paragrafi 1, i ligjit shqiptar të datës 30 qershor 2008, nr. 9946, dorëzuar nga Investitori i Projektit në datën 1 shtator 2011 pranë ERE.

“Autoritet Lokal” do të thotë çdo dhe të gjitha komunat, bashkitë, rrethet dhe çdo nënndarje tjetër sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8652, datë 31 korrik 2000 “Për organizmin dhe funksionimin e pushtetit lokal” të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

“Autorizim i Ndihmës Shtetërore” do të thotë çdo vendim i autoritetit përkatës, përfshirë Komisionin e Ndihmës së Shtetit Shqiptar ose çdo autoritet tjetër kompetent kombëtar europian që kjo Marrëveshje dhe detyrimet e Shtetit sipas saj nuk përbëjnë një ndihmë të paligjshme shtetërore brenda kuptimit të ligjit shqiptar ose nenit 18 (1) (c) të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, apo, në rast se masat e marra përmbledhin ose përmbajnë ndihmë shtetërore, kjo ndihmë është në përputhje me ligjin shqiptar dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë.

“Autoritet i Pavarur” do të thotë ERE ose çdo autoritet tjetër i Shtetit, i cili është ligjërish i pavarur nga qeveria qendrore e Shtetit dhe i cili nuk është objekt kontrolli ose drejtimi (ose në bazë të ligjit shqiptar ose nga marrëveshje apo praktike) nga qeveria qendrore e Shtetit.

“Autoritet Shtetëror” do të thotë çdo organ shtetëror të çdo niveli autoriteti, qoftë organ që ushtron pushtet ekzekutiv, ose çdo funksion shtetëror, dhe duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjitha organet qendrore, rajonale, bashkiake dhe lokale (për shmangien e çdo dyshimi, jo çdo autoritet lokal ose autoritet i pavarur) ose çdo element përbërës i organeve të tilla që kanë fuqinë për të qeverisur, rregulluar, vjelë ose mbledhur taksat, të akordojnë licenca ose leje ose në një mënyrë ndryshe të prekin të drejtat dhe detyrimet e çdo Pjesëmarrësi në Projekt në lidhje me Projektin.

“Data Bazë” do të thotë 28 janar 2013.

“Data e Nënshkrimit” do të thotë data në të cilën kjo Marrëveshje është nënshkruar nga Palët.

“Data Efektive” ka kuptimin dhënë asaj në nenin 2.2.

“Data e Operimit Tregtar” do të thotë data në të cilin Sistemi i Gazsjellësit fillon ose konsiderohet se ka filluar operimin tregtar për qëllim të marrëveshjeve të transportimit të gazit ndërmjet Investitorit të Projektit dhe Transportuesve.

“Ditë Pune” do të thotë çdo ditë në të cilën bankat e kleringut janë zakonisht të hapura për biznesin në Kantonin e Zug-ut, Zvicër, ditë e cila nuk është e shtunë, e diel ose ditë pushimi zyrtar në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë.

“Entitet” do të thotë çdo shoqëri, korporatë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, shoqëri komandite, shoqëri kolektive, partneritet, shoqëri me kapital të përbashkët, shoqëri me kapital të përbashkët e paregjistruar, shoqatë, trust ose çdo entitet juridik, organizatë ose ndërmarrje rregullisht e themeluar me marrëveshje ose sipas ligjeve të çdo shteti apo njësie administrative të tyre.

“Entitet Shtetëror” do të thotë çdo subjekt në të cilin, Shteti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka një kontroll në kapital ose ka një interes pronësor ose interes ekonomik të ngjashëm, ose që Shteti drejtpërdrejt ose tërthorazi e kontrollon, për shmangien e çdo dyshimi, duke përjashtuar, çdo autoritet lokal dhe autoritet të pavarur. Për qëllim të këtij përkufizimi, kontroll do të thotë

zotërim, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i të drejtave për të qeverisur drejtpërdrejt ose të shkaktojë qeverisjen e administrimit dhe politikave të Entitetit, qoftë nëpërmjet pronësisë së shumicës apo interesave të tjerë kontrollues në tituj me të drejtë vote, kapitali ose interesa të tjera pronësore në një Entitet, me ligj ose me marrëveshje midis personave për dhënien e një pushteti të tillë apo të drejtave të votës.

“Entitet Ndërhyrëse” ka kuptimin dhënë për të në nenin 47.1 (c) (vi).

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri.

“EURIBOR” do të thotë për çdo ditë në të cilën bankat e kleringut janë zakonisht të hapura për biznesin në Londër, norma fikse ndërbankare për depozitat në euro me afat 3-mujor e Londrës, sikurse citohet në faqen Reuters EURIBOR në atë ditë ose, nëse faqja Reuters EURIBOR pushon së ekzistuari ose nuk publikon më normën e mësipërme, atë që do të publikohet në London Financial Times, ose nëse asnjë nga këto burime nuk është më e vlefshme ose pushon së publikuari këtë normë, atëherë do t’i bëhet referim burimeve të tjera, publikimeve ose normave të përzgjedhura nga Investitori i Projektit, i cili do ta kryejë këtë veprim mbi baza të arsyeshme.

“Filial” do të thotë, çdo Entitet, Person tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontroll të përbashkët me atë Entitet. Për qëllim të këtij përkufizimi, kontroll do të thotë zotërim, i drejtpërdrejt ose i tërthortë, i të drejtave për të qeverisur drejtpërdrejt ose të shkaktojë qeverisjen e administrimit dhe politikave të Entitetit, qoftë nëpërmjet pronësisë së shumicës apo interesave të tjera kontrolluese në tituj me të drejtë vote, kapitali ose interesa të tjera pronësore në një Entitet, me ligj ose me marrëveshje midis personave për dhënien e një pushteti të tillë apo të drejtave të votës.

“Fletore Zyrtare” do të thotë Gazeta Zyrtare, e publikuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.

“Forcë Madhore” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 35.2.

“Gaz Natyror” do të thotë çdo hidrokarbur, të cilët janë nxjerrë nga nëntoka në gjendje natyrore dhe janë të gaztë në temperaturë dhe presion normal.

“Huadhënës” do të thotë çdo institucion financiar (duke përfshirë bankat tregtare, agjencitë multilaterale të kreditimit dhe agjencitë e eksportit të kreditit) ose ndonjë person tjetër që siguron ndonjë borxh, hua, garanci, kontribut financiar, çdo lloj kreditimi financiar (duke përfshirë çdo *hedging* ose marrëveshje të tjera derivative), zgjerim të kredisë apo financim tjetër për ndonjë mbajtës të interesit ose sigurimin e tyre në respekt të e në lidhje me Sistemin e Gazsjellësit (duke përfshirë çdo rifinancim të saj) dhe çfarëdo pasuesi apo pasardhësi të lejuar të çdo institucioni të tillë financiar apo personi tjetër.

“Humbje ose Dëmi” do të thotë çdo humbje, kosto, dëmtim, përgjegjësi, detyrim, shpenzim (përfshirë interesin, kamatat, tarifat e avokatit dhe pagesat), proceset gjyqësore, procedime, pretendime, ngarkime me detyrime, kamata ose dëme të shkaktuara nga një person, duke përfshirë, pa kufizim, çdo shumë të pagueshme sipas çdo kontrate të zbatimit nga Investitori i Projektit, por, në çdo rast, duke përjashtuar çdo dëm ose humbje vijuese (përfshirë, pa kufizim, humbje të fitimeve dhe humbje të kontratave), në çdo mënyrë që të shkaktohen, përveç nëse humbja ose dëmi vijues:

a) përfshin çdo shumë të tillë të pagueshme në bazë të një kontrate zbatimi nga Investitori i Projektit; ose

b) shkaktohet në rrethanat e parashikuara në nenin 32.2 ose nenin 33.

“Infrastrukturë Shqiptare” do të thotë çdo pjesë e Sistemit të Gazsjellësit të ndodhur ose që do të ndodhet në territorin shqiptar.

“Investim” për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo arbitrazh sipas nenit 37 këtu, ka kuptimin e përcaktuar në Traktatin për Kartën e Energjisë në nenin 1 (6) të Traktatit për Kartën e Energjisë.



“Investitor i Projektit” do të thotë Trans Adriatic Pipeline AG, një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese në bazë të ligjit zviceran.

“Kontraktor” do të thotë çdo person që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qoftë me kontratë, nënkontratë (të çdo niveli), ose në çdo mënyrë, furnizon me mallra, punime, teknologji ose shërbime, përfshirë shërbimet financiare (përfshirë ndër të tjera, kredi, financime, siguracione ose çdo produkt tjetër financiar) Investitorin e Projektit ose çdo Filial të tij, në lidhje me Projektin, me një kontratë, vlera vjetore e së cilës është të paktën 100,000 euro, duke përfshirë, sidoqoftë, çdo veprim individual në rolin e tij/të saj si një punëmarrës të çdo personi tjetër.

“Korridor Interesi” ka kuptimin dhënë për të në pjesën 1 të shtojcës 1.

“Kontrata të Zbatuara” do të thotë të gjitha kontratat që ekzistojnë dhe çdo marrëveshje e ardhshme, kontratat dhe çdo dokument tjetër lidhur me Projektin në të cilin Investitori i Projektit është Palë, të cilat nuk janë Marrëveshjet e Projektit, përfshirë marrëveshjet me mbajtësit e interesave, huadhënësit, kontraktorët dhe transportuesit.

“Konventa Espoo” do të thotë Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Konventën Europiane mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkufitar (Espoo, 1991).

“Konventa e OBEZH-it për modelin tatimor” do të thotë Konventa e OBEZH-it për modelin tatimor mbi të ardhurat dhe kapitalin.

“Kursime” do të thotë, në lidhje me çdo ndryshim ligji, çdo kursim apo zvogëlim i kostos apo shpenzimit, apo rritje e të ardhurave, që rezultojnë drejtpërdrejt ose që i atribuohet, në një formë tjetër, drejtpërdrejt, ndryshimit të ligjit, i cili është gëzuar apo kryer nga Investitori i Projektit në lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e Projektit, duke përfshirë zvogëlimin ose kursimin në kostot e kapitalit, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes ose kostot e tatimeve të vendosura mbi ose të pagueshme nga Investitori i Projektit.

“Kursime nga Taksat” do të thotë, sa i përket vitit fiskal, shuma e kursimeve që Investitori i Projektit ka qenë në gjendje të realizojë drejtpërdrejt gjatë vitit fiskal, si rezultat i çdo legjislacioni të ri tatimor në shtet, të hyrë në fuqi gjatë këtij viti fiskal, ose që ka hyrë në fuqi gjatë viteve të mëparshme fiskale, në lidhje me të cilat pagesat ose ndalesat janë kryer.

“Kushte më të Mira të Disponueshme” do të thotë, në çdo kohë në lidhje me çdo mall, punime, shërbime ose teknologji të kryera apo të siguruar në çdo vendndodhje, normat mbizotëruese që ekzistojnë në rrjedhën e zakonshme të biznesit ndërmjet personave të palidhur për mallra punime, mallra, shërbime apo teknologji, të cilat janë të ngjashme në natyrë dhe në cilësi, të kryera në të njëjtën vendndodhje dhe në bazë të kushteve dhe afateve të krahasueshme me ato që zbatohen për mallrat, punimet, shërbimet apo teknologjinë.

“Kushtetutë” do të thotë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

“Leje Infrastrukturore” do të thotë leja infrastrukturore, për t’u lëshuar në baze të ligjit nr. 10119, datë 23 prill 2009 “Mbi planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

“Leje Shtetërore” do të thotë çdo autorizim, pëlqim, koncesion, licencë, leje ose çdo formë tjetër miratimi (përfshirë ato të përcaktuara në nenin 28.2) nga, ose me çdo palë shtetërore ose autoritet të pavarur, qoftë e marrë ose që do të merret në emër të Investitorit të Projektit ose të çdo pjesëmarrësi në Projekt në lidhje me ndonjë aktivitet të Projektit.

“Leje e Posaçme” do të thotë çdo leje e posaçme e Këshillit të Ministrave për ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës shqiptare, sikurse parashikohet në nenin 8 paragrafi 1 i ligjit për gazin.

“Licencë Ekzistuese” do të thotë koncesionet, licencat dhe të drejtat e mëposhtme që janë dhënë nga Shteti dhe janë listuar në shtojcën 6.

“Ligj Shqiptar” do të thotë ligjet e shtetit të detyrueshme dhe ligjërish të fuqi, nga koha në kohë, duke përfshirë Kushtetutën, të gjitha ligjet e tjera, kodet, dekretet, aktet nënligjore, rregulloret, komunikatat, deklaratat, vendimet kryesore, urdhrat, aktet normative dhe politikat, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shteti është palë, së bashku me të gjitha aktet e brendshme, ligjet dhe dekretet e ratifikuara ose në zbatimin të marrëveshjeve të tilla ndërkombëtare,

kësaj Marrëveshjeje, çdo ligj për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Ndërqeveritare dhe interpretimet gjyqësore mbizotëruese të të gjitha instrumenteve të tilla ligjore.

“Ligj Përkatës i Bashkimit European” do të thotë:

a) çdo nen i traktateve të Komunitetit ose ndonjë ligj, rregullore, direktivë, vendim ose parim të Bashkimit European, qoftë për shkak të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, ose në bazë të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European në rrugën drejt pranimit të mëvonshëm në Bashkimin European, të tilla si: Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, botuar në Fletore Zyrtare më 22 maj 2006 ose në ndonjë marrëveshje të tillë të mëvonshme; ose

b) çdo nen të traktateve të Komunitetit ose ndonjë ligj, rregullore, direktivë, vendim ose parim të Bashkimit European, të cilin Republika e Shqipërisë duhet ta zbatojë sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë (përfshirë *acquis communautaire*, sikurse përkufizohet në Traktatin e Komunitetit të Energjisë).

“Ligj për Shpronësimin” do të thotë ligji nr. 8561, datë 22 dhjetor 1999 “Mbi shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” të Republikës së Shqipërisë.

“Ligj për gazin” do të thotë ligji nr. 9946, datë 30 qershor 2008 “Për sektorin e gazit natyror” të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

“Ligj Tatimor i Shtetit” do të thotë të gjitha ligjet shqiptare në lidhje me taksat, të gjitha aktet legjislativë ose ekzekutive të çdo pale shtetërore apo autoriteti lokal në lidhje me taksat, të gjitha vendimet e çdo gjykate, panel arbitrazhi ose të ndonjë arbitri të emëruar nga çdo palë shtetërore apo autoritet lokal në lidhje me taksat, si dhe të gjitha deklaratat e praktikës ose të interpretimit në lidhje me taksat, të cilat janë publikuar nga çdo palë shtetërore ose autoritet lokal.

“MÇP” do të thotë marrëveshja paraprake për çmimin e lidhur, ose që do të lidhet, midis Shtetit dhe Konfederatës Zvicerane për shpërndarjen e të ardhurave midis Investitorit të Projektit dhe Selisë së tij të Përhershme në Shtet në përputhje me nenin 25 të Marrëveshjes për tatimin e dyfishtë midis Konfederatës Zvicerane dhe Republikës së Shqipërisë.

“Marrëveshje të Projektit” do të thotë çdo marrëveshje, kontratë, licencë, koncesion ose dokument tjetër, përveç kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshja Ndërqeveritare, në të cilat, në njërën anë Palët Shtetërore dhe nga ana tjetër, pjesëmarrësit në Projekt, të cilët janë palë ose do të jenë palë lidhur me aktivitetet e Projektit, si dhe çdo marrëveshje tjetër, kontratë ose dokument tjetër që mund të zgjatet, rinovohet, zëvendësohet, ndryshohet ose modifikohet kohë pas kohe në përputhje me kushtet e saj.

“Marrëveshje Ndërkombëtare” do të thotë Traktati për Themelimin e Komunitetit European (Traktatin e Romës i ndryshuar me Traktatin e Amsterdimit dhe Traktatin e Nicës), Traktati i Mاستrihtit (i ndryshuar me Traktatin e Amsterdimit, dhe Traktatin e Nicës) dhe Traktati për Themelimin e Komunitetit European të Energjisë Atomike, si dhe ato traktate që deri tashmë janë zëvendësuar nga Traktati i Lisbonës, që është Traktati për Bashkimin European dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit European.

“Marrëveshje” do të thotë Marrëveshja me qeverinë e vendit pritës, përfshirë çdo shtojcë dhe/ ose aneks bashkëngjitur kësaj, siç mund të ndryshohet, shtohet ose modifikohet në çdo formë, kohë pas kohe.

“Marrëveshje Ndërqeveritare” do të thotë marrëveshja ndërqeveritare e nënshkruar në Athinë më 13 shkurt 2013 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Greqisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë lidhur me Gazsjellësin Trans Adriatik dhe ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 25 mars 2013.



“Marrëveshje për Tatimin e Dyfishtë” do të thotë çdo marrëveshje ose konventë, në të cilën Shteti është palë, në lidhje me shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me taksat mbi të ardhurat ose kapitalin.

“Mbajtësit Ekzistues të Licencave” do të thotë ata persona, të cilët, në datën bazë, disponojnë të drejta koncesionare në bazë të licencës ekzistuese.

“Mbajtës i Interesit” do të thotë:

- a) Investitori i Projektit;
- b) çdo person që është mbajtës në çdo formë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të interesit pronësor ose në kapital të investitorit të projektit; ose
- c) çdo filial, pasues ose pasardhës i lejuar i çdo personi të referuar në paragrafin (a) ose (b) më sipër.

“METE” do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë.

“Monedhë e Konvertueshme” do të thotë një monedhë, e cila është gjerësisht e tregtuar në tregjet ndërkombëtare të këmbimit valutor, përfshirë euron, dollarin e Shteteve të Bashkuara, por duke përjashtuar lekun shqiptar.

“Mosmarrëveshje” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 37.1.

“Mosmarrëveshje Taksash” do të thotë një mosmarrëveshje, e cila kryesisht lidhet me zbatimin e duhur të ligjit shqiptar dhe të kësaj Marrëveshje në lidhje me vlerësimin dhe pagesën nga, një Investitor i Projektit, të taksave në përputhje me ligjin shqiptar dhe, për të mënjeluar çdo dyshim, jo një mosmarrëveshje, e cila lidhet me një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, një ndryshim të ligjit, shpronësim apo aplikim, zbatim ose interpretim të MÇP-së.

“MSHG-të Shqiptare” do të thotë çdo marrëveshje që mund të lidhet midis shitësve të gazit dhe klientëve në Republikën e Shqipërisë për shitjen e gazit natyror dhe që shpërndarja kryhet nga pika lidhëse në rrjetin shqiptar.

“Ndryshime të Ligjit” do të thotë:

a) një ndryshim në ligjin shqiptar që ndodh pas datës bazë, përfshirë ndryshimet që rezultojnë nga:

- i) ndryshimi, shfuqizimi, tërheqja, përfundimi ose skadimi i një ligji shqiptar;
- ii) miratimi, shpallja ose publikimi i një ligji të ri shqiptar; ose
- b) ndërmarrja e (ose dështimi për të ndërmarrë) çdo veprim ose ushtrimi i (ose dështimi për të ushtruar) çdo autoritet nga organet gjyqësore, gjykatat ose panel arbitrazhi dhe/ose nga çdo autoritet shtetëror dhe/ose autoritet i pavarur dhe/ose autoritet lokal, në një mënyrë të tillë që nuk është në pajtim me kërkesat e ligjit shqiptar, në datën bazë;

c) imponimi i një kërkesë për çdo leje shtetërore e cila nuk ekziston në datën bazë;

d) pas akordimit të një lejeje shtetërore (pavarësisht nëse është dhënë para ose pas datës bazë), një ndryshim në kushtet dhe afatet bashkëngjitur kësaj leje shtetërore, ose shtesa të ndonjë prej kushteve dhe afateve; ose

e) çdo leje shtetërore që është akorduar (pavarësisht nëse është dhënë para ose pas datës bazë) pushon së mbeturi në fuqi dhe efekt të plotë, ose nëse akordohet për një periudhë të kufizuar, që nuk rinovohet në kohë të caktuar mbi bazën e aplikimit rregullisht të kryer, ose rinovohet me kushte apo objekt kushtesh që janë thelbësisht më pak të favorshme për kërkuesit se ato të bashkëngjitura në lejen origjinale shtetërore,

por përjashton çdo ndryshim të përjashtuar të ligjit.

“Ndryshime Diskriminuese të Ligjit” do të thotë çdo ndryshim i ligjit, i cili:

a) kërkon që specifikimi, operimi, mirëmbajtja ose çmontimi i të gjithë ose të një pjese të infrastrukturës shqiptare, të gazit natyror që do të transportohet nëpërmjet saj, ose përmbushja e kontratave të zbatimit (në çdo rast, siç mund të jetë e zbatueshme) të jetë në përputhje me standarde ose rezultate, të cilat janë më të larta se ato që kërkohen në përgjithësi në Bashkimin Europian;

dhe/ose

b) diskriminon ata që janë në biznesin e zhvillimit, ndërtimit, operimit ose janë duke investuar në çdo formë të sipërmarrjes së gazsjellësit ose energjetike në Republikën e Shqipërisë ose që i ofrojnë shërbime ose punë çdo personi që zhvillon, ndërton, operon ose është duke investuar në çdo formë të sipërmarrjes së gazsjellësit ose energjetike në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose

c) diskriminon Investitorin e Projektit ose specifikisht ndonjë pjesëmarrës në Projekt.

“Ndryshime të Përrjashtuara të Ligjit” do të thotë çdo akt ose veprim, i cili ndërmerret me qëllim ratifikimi, zbatimi ose në një mënyrë tjetër bën të vlefshëm:

a) çdo ligj përkatës të Bashkimit European;

b) çdo detyrim të ndërmarrë nga Republika e Shqipërisë sipas marrëveshjeve të Organizatës Botërore të Tregtisë, përfshirë marrëveshjet e përgjithshme mbi tarifatat dhe tregtinë, marrëveshjet e përgjithshme mbi tregtinë në shërbime, aspektet lidhur me tregtinë e të drejtave të pronësisë intelektuale ose marrëveshje të tjera të ngjashme;

c) çdo dispozitë të çdo legjislacioni të Republikës së Shqipërisë që zbaton në ligjin shqiptar, çdo standard, konventa ose metodologji referuar në ndonjë shtojcë të kësaj Marrëveshjeje ose e cila në mënyrë të arsyeshme kërkohet për Shtetin të përmbushë detyrimet e tij ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lidhur me mjedisin, çështjet sociale, komunitetin, shëndetin dhe sigurinë, standardet dhe rregulloret e punësimit dhe trashëgimisë kulturore, të cilat në çdo rast janë në përputhje me praktikën ndërkombëtare;

d) ndryshimet në, ose përjashtimet, nga ligji shqiptar të kryera drejtpërdrejtë për këtë Marrëveshje, përfshirë ato të referuara në nenin 17.1 dhe 41, dhe modifikimet e ligjit shqiptar që u përkasin taksave të referuara në nenin 24;

e) çdo ndryshim në primet e kërkuara ose në kontributet për t'u kryer nga ana e punëmarrësve në lidhje me sigurimin shëndetësor shtetëror dhe sigurimin shoqëror shtetëror; ose

f) çdo ligj, i cili në datën bazë nuk ka hyrë në fuqi, por që është publikuar në Fletoren Zyrtare.

“Norma e Interesit të Rënë Dakord” do të thotë norma e interesit me bazë vjetore 3% plus EURIBOR në fuqi në ditën e punës menjëherë përpara ditës në të cilën lindin detyrimet për të kryer pagesa.

“OBEZH” do të thotë Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

“Palë” do të thotë secila palë e kësaj Marrëveshjeje.

“Palë Shtetërore” do të thotë Shteti, autoritetet shtetërore dhe entitetet shtetërore.

“Përfaqësues i Investitorit të Projektit” ku kuptimin që i është dhënë në nenin 27.2 (a).

“Përfaqësues Shtetëror” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 27.1 (a).

“Person” do të thotë çdo person ose entitet.

“Përjashtime Rregullatore” do të thotë çdo përjashtim që i është akorduar ose që do t'i akordohet Investitorit të Projektit dhe i koordinuar midis Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë (MZHE), Autoritetit Rregullator për Energjinë (ARE) dhe ERE, bazuar në aplikimet për përjashtim.

“Pika Lidhëse e Rrjetit Shqiptar” do të thotë, bashkërisht, pikën ose pikat lidhëse në Republikën e Shqipërisë, të lidhura ndërmjet Sistemit Gazsjellës dhe rrjetit shpërndarës shqiptar për shpërndarjen fizike të gazit natyror në përputhje me kushtet e MSHG-ve shqiptare.

“Pjesa Detare” do të thotë aktivitetet e Projektit të ndërmarra në atë pjesë të detit Adriatik që shtrihet midis Republikës së Italisë dhe Shtetit, shtratin dhe nëntokën e saj, kolonën ujore dhe hapësirën ajrore mbi të, e cila nuk është pjesë e ujërave territoriale të Shtetit, të përcaktuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike.

“Pjesëmarrës në Projekt” do të thotë çdo mbajtës i interesit, kontraktor, transportues dhe huadhënës.



“Politika Mjedisore dhe Sociale” do të thotë kërkesat e performancës sociale dhe mjedisore të përcaktuara në politikat mjedisore dhe sociale të miratuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në maj 2008, të ndryshuara kohë pas kohe.

“Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve lidhur me Taksat” ka kuptimin që i është dhënë atij në nenin 37.9.

“Projekt” do të thotë vlerësimi, zhvillimi, dizenjimi, ndërtimi, instalimi, financimi, rifinancimi, pronësia, sigurimi, operimi (përfshirë transportin e gazit natyror përmes Sistemit të Gazsjellësit), zëvendësimi, rinovimi, mirëmbajtja, zgjerimi, shtyrja, (përfshirë pjesët anësore) dhe në kohën përkatëse, çmontimin e Sistemit të Gazsjellësit.

“Punime për Hyrjen në Rrugën Publike” do të thotë çdo punim i ndërmarrë nga ose në emër të Investitorit të Projektit për të përmirësuar rrugë publike të caktuara me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të Projektit.

“Rregulloret për Zonën e Sigurisë dhe Konsultimit” do të thotë dakordësitë përkatëse për vendosjen e kufizimeve të sigurisë në përputhje me praktikën ndërkombëtare lidhur me përdorimin e tokës ngjitur me pikat e presionit të lartë të tubacioneve të gazsjellësit dhe infrastrukturën e lidhur me të (përfshirë Sistemin e Gazsjellësit) në territorin shqiptar, se këto dakordësi nuk do të ofrojnë më pak mbështetje për tubacionet përkatëse se sa kufizimet dhe kërkesat e përcaktuara në pjesën 3 të shtojcës 2.

“Seli e Përhershme” ka kuptimin e përcaktuar në Marrëveshjen për Tatimin e Dyfishtë. Nëse një marrëveshje e tillë nuk ekziston, atëherë “Seli e Përhershme” do të ketë kuptim të njëjtë me atë të përcaktuar në versionin më të fundit në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje të Konventës së OBEZH-it për Modelin Tatimor”.

“Sistem Gazsjellës” do të thotë Sistemi Gazsjellës i Gazit Natyror me kapacitet vjetor 10 BCM (që mund të shtrihet deri në 20 BCM), i cili synohet të shtrihet nga kufiri midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Turqisë, duke përfshirë territoret e Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë në afërsi të Lecce në Republikën e Italisë, përfshirë të gjitha asetet fizike që shoqërojnë këtë sistem, përfshirë të gjitha pajisjet dhe makineritë e rënda që instalohen në tokë, pajisjet, makineritë, tubacionet, depozitat, stacionet e kompresorëve, kabllo të fibrave optike dhe çdo aset tjetër fizik shtesë, por përjashton çdo tubacion tjetër gazsjellës tek i cili mund të ndërlidhet ky sistem gazsjellës.

“SNRF” do të thotë:

a) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të përcaktuara ose të pranuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK) (përfshirë, për të shmangur çdo dyshim, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të përcaktuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit, që janë pranuar nga BNSK-ja);

b) shënimet dhe interpretimet udhëzuese në lidhje me standardet e treguara në paragrafin (a), të zhvilluara nga Komiteti i Interpretimit të Raporteve Financiare ose Komiteti i Interpretimeve, i miratuar ose i pranuar nga BNSK-ja; dhe

c) të gjitha konventat, rregullat dhe procedurat e praktikave ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat, kohë pas kohe, konsiderohen të lejueshme nga BNSK-ja.

“Shitës të Gazit” do të thotë çdo person, i cili është një shitës sipas MSHG-ve shqiptare.

“Shpenzime Kapitali” do të thotë çdo shpenzim, i cili trajtohet si shpenzim kapitali në përputhje me SNRF-në.

“Shpenzime Operative” nënkupton të gjitha shpenzimet e realizuara dhe të akumuluar nga selia e përhershme e Investitorit të Projektit në territorin e Shtetit, të cilat nuk janë shpenzime kapitali, të llogaritura për të ardhurat e mësipërme përpara interesit dhe tatimit (EBIT) në llogarinë humbje dhe fitime të selisë së përhershme, të bazuara në SNRF. Kjo përfshin shpenzimet operative të realizuara dhe të akumuluar nga Investitori i Projektit, të cilat nuk janë shpenzime kapitali, të llogaritura për të ardhurat e mësipërme përpara interesit, tatimit dhe zhvlerësimit (EBITD) në

llogarinë humbje dhe fitime të selisë së përhershme të Investitorit të Projektit, të bazuara në SNRF dhe të caktuara në selinë e përhershme në Shtet nga Investitori i Projektit.

“Shpronësim” do të thotë çdo shtetëzim ose shpronësim, ose çdo masë që ka efekt të barasvlershëm me shtetëzimin ose shpronësimin, përfshirë:

- a) shtetëzimin ose shpronësimin e aseteve të çdo personi;
- b) marrjen e të drejtave të pronësisë ose kufizimi i përdorimit, gëzimi ose përdorimi i tyre, në atë mënyrë të barasvlershme me shtetëzimin ose shpronësimin, përfshirë shtetëzimin ose shpronësimin nëpërmjet pronësisë së kapitalit ose të interesave të barasvlershme në to;
- c) revokimin e çdo lejeje shtetërore, e cila është e barasvlershme me shtetëzimin ose shpronësimin;
- d) masat ose efektet, të cilat, të marra individualisht ose veç e veçmas, nuk mund të përbëjnë shtetëzim ose shpronësim, por kur merren së bashku janë të barasvlershme me shtetëzimin ose shpronësimin; dhe
- e) masat ose efektet lidhur me taksat, të cilat qoftë veçmas ose në total janë të barasvlershme me shtetëzimin ose shpronësimin.

“Shteti” do të thotë Republika e Shqipërisë, duke përjashtuar vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet lokale dhe autoritetet e pavarura.

“Taksat” do të thotë të gjitha rëndesat tatimore ekzistuese dhe të ardhshme, detyrimet, doganat, taksat, pagesat, tarifatat, gjërat, vlerësimet, taksat (përfshirë TVSH-në ose taksat e shitjes), detyrime për t’u paguar dhe kontributet e pagueshme ose të vendosura nga një shtet, çdo organ apo ndonjë nënndarje e një shteti, qoftë qendror apo lokal, apo ndonjë organ tjetër që ka fuqi efektive për të vendosur ndonjë rëndesë tatimore të tillë brenda territorit të një shteti dhe taksë do të thotë çdo njërin prej tyre dhe taksimi do të interpretohet në përputhje me të.

“Tatim Shqiptar mbi të Ardhurat” do të ketë kuptimin e dhënë në nenin 24.6.

“Territor Shqiptar” do të thotë territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Territor” do të thotë, në kuptim të çdo shteti, tokën e atij shteti, përfshirë territorin detar dhe zonat e tjera detare, mbi të cilat ky shtet ka juridiksion ose ushtron të drejta sovraniteti në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike.

“Të Drejtat Përkatese” do të thotë të gjitha ato të drejta të ekzaminimit, testimit, vlerësimit, analizimit, inspektimit, ndërtimit, përdorimit, pushtimit, kontrollit, pronësisë, cedimit dhe gëzimit në lidhje me tokën e Projektit në territorin shqiptar, sikurse kërkohet për të ushtruar aktivitetet e Projektit.

“Tokë” do të thotë:

- a) të gjitha tokat, brigjet, shtretërit e deteve, shtretërit e lumenjve dhe shtretërit e liqeneve;
- b) kanalet ujore mbi çdo shtrat të deteve, shtrat të lumenjve dhe shtrat të liqeneve;
- c) hapësira ajrore mbi dhe zonat poshtë nën sipërfaqen e të gjitha atyre që janë përmendur më sipër; dhe
- d) çdo vendndodhje tjetër gjeografike.

“Tokë e Projektit” do të thotë e gjithë toka që është e nevojshme për zbatimin e Projektit, duke përfshirë tokën e përhershme, tokën e përkohshme, korridorin e interesit dhe toka të tjera të referuara apo të identifikuar në, ose në pajtim me, pjesën 1 të shtojcës 1.

“Tokë joshtetërore” do të thotë çdo tokë në territorin shqiptar përveç atyre që janë tokë shtetërore.

“Tokë e Përhershme” ka kuptimin dhënë për të në pjesën 1 të shtojcës 1.

“Tokë Shtetërore” do të thotë çdo tokë në territorin shqiptar, e cila është në pronësi ose kontrollohet nga çdo palë shtetërore, por jo për shmangien e çdo dyshimi, çdo tokë në territorin shqiptar, e cila është në pronësi ose kontrollohet nga çdo autoritet lokal.

“Tokë e Përkohshme” ka kuptimin dhënë për të në pjesën 1 të shtojcës 1.



“Traktati i Kartës së Energjisë” do të thotë Traktati i Kartës së Energjisë i nënshkruar në Lisbonë më 17 dhjetor 1994 dhe në fuqi nga data 16 prill 1998.

“Traktati për Komunitetin e Energjisë” do të thotë Traktati për Themelimin e Komunitetit të Energjisë ndërmjet Komunitetit Europian nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Malit të Zi, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës (ish-Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë i Kombeve të Bashkuara) në anën tjetër, e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 korrik 2006.

“Transportues” do të thotë çdo person, i cili ka një të drejtë ligjore (qoftë që rrjedh nga një kontratë ose ndryshe) për transportimin e gazit natyror nëpërmjet ose në çdo pjesë të Sistemit të Gazsjellësit.

“Transport” do të thotë ngarkesë, dërgesë ose çdo transportim ose transmetim tjetër i gazit natyror, nëpërmjet marrëveshjeve ligjore të çdo lloji, përfshirë transitin, sikurse përcaktohet në nenin 7 (10) (a) të Traktatit të Kartës së Energjisë.

“TVSH” do të thotë tatimi mbi vlerën e shtuar ose çdo taksë tjetër e ngjashme, e aplikueshme mbi furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, të drejtave përkatëse, punimeve, shërbimeve dhe/ose teknologjisë brenda territorit të një shteti.

“Udhëzuesi i OBEZH-it për Transferimin e Çmimit, i vitit 2010” do të thotë udhëzuesi i OBEZH-it për transferimin e çmimit për shoqëritë shumëkombëshe dhe administratat tatimore datë 22 korrik 2010, i ndryshuar kohë pas kohe.

“Veprim Mospërmbyllje” ka kuptimin dhënë për to në nenin 47.1 (c) (iii).

“Vit” do të thotë periudha e 12 muajve të njëpasnjëshëm, sipas kalendarit gregorian, duke filluar në datën 1 janar, përveç nëse një datë e ndryshme fillimi është përcaktuar shprehimisht në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

“Vlerë Tregu” do të thotë vlera e interesit të një pjesëmarrësi në Projekt, investimet, prona, marrëveshjet tregtare, të drejtat (qoftë kontraktuale ose të tjera), privilegjet dhe përjashtimet, të cilat janë ndërmarrë, zvogëluar, zhvleftësuar, të dëmtuara ose ndryshe të cenuara thelbësisht si rezultat i shpronësimit, duke marrë parasysh që investimet dhe biznesi i pjesëmarrësit në Projekt, i lidhur ose i ndikuar nga Projekti, dhe që përcaktohet në bazë të një shqetësimi të vazhdueshëm, duke përdorur metodën e zvogëlimit të fluksit të parasë, duke supozuar një blerës të gatshëm dhe një shitës të gatshëm në një mjedis joarmiqtësor dhe pa marrë parasysh të gjitha rrethanat e pafavorshme (përfshirë ndonjë zvogëlim të vlerës), që çon deri në, ose janë të lidhura me shpronësimin dhe që në përcaktimin e kësaj vlere, parimi i dëmshpërblimit që do të zbatohet, do të jetë me vlerat e përcaktuara të kohës menjëherë para shpronësimit. Norma e skontimit që do të përdoret për qëllime të llogaritjes së fluksit të parasë do të jetë kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit të pjesëmarrësit përkatës në Projekt.

1.2 Interpretime

a) Ndarja e kësaj Marrëveshjeje në nene, pika dhe pjesë të tjera dhe vendosja e krerëve është vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojë ndërtimin ose interpretimin këtu në vijim.

b) Përveç sa parashikohet, të gjitha referencat në një “nen”, “paragraf”, “pikë”, “shtojcë”, e ndjekur nga një numër ose germë i referohet një neni, paragrafi, pike ose shtojcë të veçantë të kësaj Marrëveshjeje.

c) Përkufizimi “kjo Marrëveshje”, “këtu në vijim”, “në këtë”, “këtu më poshtë” dhe shprehje të ngjashme i referohen kësaj Marrëveshjeje dhe jo në veçanti një neni, pike ose pjesëve të tjera këtu në vijim.

d) Përveç sa parashikohet, referimet në një datë ose në një orë të ditës në këtë Marrëveshje janë të orës së Europës Qendrore dhe një referencë në një ditë do të interpretohet si një periudhë kohore, që fillon në mesnatë dhe përfundon 24 orë më pas.

e) Nëse një periudhë kohore është përshkruar në këtë Marrëveshje si e llogaritur nga një ditë e caktuar ose në ditën e një ngjarjeje të mundshme, do të llogaritet ekskluzivisht në atë ditë.

f) Kur një shprehje është përcaktuar në këtë Marrëveshje, një pjesë tjetër e shprehjes apo një formë gramatikore e asaj shprehjeje ka një kuptim përkatës.

g) Një referencë në këtë Marrëveshje për çdo organ politik apo ligjor, organizatë, ministri apo njësi të ngjashme do të përfshijë një referencë ndaj atij organi politik apo ligjor, organizate, ministri apo njësi të ngjashme sikurse mund të riorganizohet, riformohet, zëvendësohet ose riemërtohet nga koha në kohë.

1.3 Ndërtimi

a) Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike ose konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që sjellin njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe anasjellat, dhe fjalët që sjellin çdo gjini do të përfshijnë të gjitha gjinitë, dhe “përfshijë”, “përfshin” dhe “duke përfshirë” do të konsiderohet se ndiqet me fjalët “pa kufizim”.

b) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, që përfshijnë fjalët “Për t’u rënë dakord”, “njoftuar”, “të lejuara”, “të akorduara”, “të vendosura”, “të miratuara”, “miratim” ose fjalët e një rrënje që kërkojnë marrëveshje përkatëse: njoftim, leje, pëlqim, vendim ose miratim do të jepen me shkrim dhe nënshkruhen nga një përfaqësues i autorizuar i Palës ose palëve përkatëse.

1.4 Njohuri

Referencat në këtë Marrëveshje të fjalëve “njohuri”, “dijeni” dhe përkufizimeve sinonime, përveç nëse përmbajtja tregon ndryshe, do të konsiderohen se i referohen njohurisë aktuale sesa njohurisë praktike apo të atribuar.

1.5 Dokumente dhe ligje

a) Një referencë në këtë Marrëveshje ose në një instrument tjetër përfshin çdo shtyrje, rinovim, ndryshim, modifikim, varietet ose zëvendësim të çdo njëres prej tyre.

b) Një referencë në këtë Marrëveshje për një statut është një referencë në një statut të Shtetit, përveç nëse parashikohet ndryshe.

c) Një referencë në këtë Marrëveshje për një statut, udhëzim, kod ose ligj tjetër përfshin rregulloret dhe çdo instrument ligjor dhe konsolidimet, ndryshimet, rimiratim ose zëvendësim i çdonjëres prej tyre.

2. DATA EFEKTIVE DHE KOHËZGJATJA

2.1 Pa paragjykuar nenin 2.6, efektshmëria e kësaj Marrëveshjeje është objekt i:

- a) nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Palët;
- b) miratimit të menjëhershëm të kësaj Marrëveshjeje më pas nga Këshilli i Ministrave;
- c) Marrëveshjes Ndërqeveritare të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse dhe ratifikuar nga Parlamenti i Shtetit;
- d) publikimit në Fletoren Zyrtare të ligjit të Parlamentit, i cili ratifikon këtë Marrëveshje;
- e) përjashtimeve rregullatore që do të akordohen, të zbatueshme në infrastrukturën shqiptare;
- f) Autorizimit të Ndhmës Shtetërore që do të akordohet; dhe
- g) datës efektive në përputhje me nenin 2.2.

2.2 Nëse njëra nga Palët vlerëson se të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përshkruar në nenin 2.1 (g)) janë plotësuar, ajo duhet të njoftojë Palën tjetër. Nëse Pala tjetër bie dakord që të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përshkruar në nenin 2.1 (g)) janë plotësuar, ajo duhet të konfirmojë dakordësinë e saj nëpërmjet njoftimit të Palës së parë, data e këtij njoftimi do të konsiderohet si data efektive. Pa paragjykuar nenin 2.6, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet e zbatueshme në datën efektive.

2.3 Menjëherë pas datës së nënshkrimit, Shteti:

a) do të paraqesë menjëherë këtë Marrëveshje në Parlamentin e Shtetit për ratifikim dhe/ose miratim të saj, me qëllim që ta bëjë këtë Marrëveshje efektive në bazë të Kushtetutës, si pjesë të ligjit shqiptar;



b) do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, me qëllim që të paraqesë siç duhet projektet për të mundësuar legjislacionin dhe ligjet e tjera që mund të jenë të nevojshme për ta bërë efektive këtë Marrëveshje dhe, në veçanti, të drejtat, garancitë, përjashtimet, grantet, privilegjet dhe standardet, heqjet dorë dhe dëmshpërblimet e përgjegjësisë ligjore të zbatueshme për Projektin në bazë të Kushtetutës si pjesë të ligjit shqiptar;

c) do të bëjë përpjekjet maksimale për të marrë sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur çdo ratifikim të tillë dhe/ose miratim të Marrëveshjes, si dhe miratim të ndonjë legjislacioni të tillë përpara ose së bashku me këtë ratifikim dhe/ose miratim; dhe

d) do të bëjë përpjekjet maksimale për të marrë autorizimin e ndihmës shtetërore.

2.4 Nëse pavarësisht nga përpjekjet më të mira të Shtetit, autoritetet përkatëse, duke përfshirë edhe Komisionin Shqiptar të Ndihmës Shtetërore ose ndonjë autoritet kompetent kombëtar ose evropian, akordon autorizimin e ndihmës shtetërore, sipas modifikimeve të kësaj Marrëveshjeje, ose duke iu nënshtruar kushteve të tjera, ky vendim i autoritetit përkatës do të konsiderohet të jetë autorizim i ndihmës shtetërore për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, në qoftë se modifikime të tilla ose këto kushtet janë pranuar me shkrim nga Investitori Projektit.

2.5 Shteti, kohë pas kohe dhe me kërkesë me shkrim të Investitorit të Projektit, do t'u përgjigjet me shkrim pyetjeve të Investitorit të Projektit për avancimin e Shtetit lidhur me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas nenit 2.3.

2.6 Pavarësisht se kjo Marrëveshje do të bëhet efektive në datën efektive, detyrimet e Palëve sipas neneve 2, 36, 37, 38, 40, 41, 44, 45, 48 dhe 49, do të bëhen efektive dhe fillojnë në datën e nënshkrimit.

3. MARRËDHËNIET ME MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, LIGJET SHQIPTARE DHE LEJET SHTETËRORE

3.1 Marrëdhëniet me marrëveshjet ndërqeveritare dhe MÇP-në.

a) Palët pranojnë se kjo Marrëveshje është “Marrëveshja e Qeverisë së Vendit Pritës” midis Republikës së Shqipërisë dhe Investitorit të Projektit e referuar në Marrëveshjen Ndërqeveritare.

b) Kjo Marrëveshje lidhet:

i) në kuadër të dhe në lidhje me Marrëveshjen Ndërqeveritare dhe MÇP-në (pavarësisht se MÇP-ja mund të mos jetë në fuqi në Datën Efektive);

ii) në përpunim të parimeve të përcaktuara në Marrëveshjen Ndërqeveritare; dhe

iii) për qëllime, midis të tjerash, të vënies në zbatim, në ligjin shqiptar, të detyrimeve, marrëveshjeve dhe angazhimeve të Shtetit, në bazë, ose në lidhje me Marrëveshjen Ndërqeveritare dhe MÇP-në (pavarësisht nëse MÇP-ja mund të mos jetë në fuqi në datën efektive).

3.2 Marrëdhëniet me Traktatin për Kartën e Energjisë

Palët bien dakord që Projekti, të drejtat e transportuesve sipas marrëveshjeve të transportit të gazit apo të marrëveshjeve të rezervimit të kapacitetit me Investitorin e Projektit, të drejtat e pjesëmarrësve në Projekt sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë këtu, të drejtat e tyre sipas nenit 32) dhe të drejtat e shitësve të gazit nën MSHG-të shqiptare, do të konsiderohen secili si një “Investim” në Republikën e Shqipërisë në kuptim të nenit 1 (6) të Traktatit për Kartën e Energjisë dhe se, pa kufizim, personat e përmendur më poshtë, në cilësitë e treguara më poshtë, do të konsiderohen si “Investitorë” në kuptim të nenit 1 (7) të Traktatit për Kartën e Energjisë në lidhje me të njëjtën dhe Shteti nuk do të kërkojë të pohojë të kundërtën.

Investitorë

a) Investitori i Projektit, si pronar dhe ndërtues i Sistemit të Gazsjellësit, përfshirë dhe infrastrukturën shqiptare;

b) çdo ortak i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i Investitorit të Projektit, kohë pas kohe që është themeluar në një shtet që është palë kontraktore e Traktatit për Kartën e Energjisë;

c) çdo dërgues (në cilësi të tij si i tillë), i cili është një palë në një MSHG shqiptare, kohë pas kohe, që është themeluar në një shtet që është palë kontraktore e Traktatit për Kartën e Energjisë;

d) çdo shitës i gazit (në cilësi të tij), i cili është një palë në një MSHG shqiptare, kohë pas kohe, që është themeluar në një shtet që është palë kontraktuese e Traktatit për Kartën e Energjisë.

3.3 Marrëdhënia me marrëveshje të tjera

Asgjë në këtë Marrëveshje ose në ndonjë Marrëveshje të Projektit do të privojë secilin pjesëmarrës të Projektit nga të drejtat apo dëmshpërblimet që është titullar, ose do të ndikojë çdo detyrim që ai ose çdo Palë Shtetërore mund të ketë kohë pas kohe, sipas Traktatit për Kartën e Energjisë, Traktatit për Komunitetin e Energjisë ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare (përfshirë, për shmangie të çdo dyshimi, çdo marrëveshje ndërkombëtare, protokoll, pakt, konventë, shkëmbim letrash ose instrument i ngjashëm).

3.4 Marrëdhënia me ligjet shqiptare

a) Shteti deklaron se Projekti është “në interes publik” për qëllime të:

i) Nenit 50, paragrafi 1, i ligjit për gazin; dhe

ii) Nenet 1 dhe 5 të ligjit për shpronësimin.

b) Palët këtu njohin dhe bien dakord se është në synimin e tyre të përbashkët që, në datën efektive dhe duke marrë parasysh ato përjashtime dhe ndryshime të ligjit shqiptar, të parashikuara në këtë Marrëveshje (përfshi ato të referuara në nenet 17.1 dhe 41):

i) kjo Marrëveshje do të jetë pjesë e ligjit shqiptar dhe midis të tjerash, do të jetë ligji shqiptar ai që vë në zbatim detyrime, marrëveshjet dhe angazhimet e Shtetit në bazë dhe në lidhje me Marrëveshjen Ndërqeveritare; dhe

ii) asnjë ligj shqiptar (përfshirë interpretimin dhe zbatimin e procedurës së tyre) që është në kundërshtim me, ose në mospërputhje, me kushtet e Marrëveshjes ose të çdo dokumenti të Projektit që mund të kufizojë, të zvogëlojë, të ndikojë në mënyrë të pafavorshme të drejtat, që i janë akorduar shoqërisë së Projektit ose çdo pjesëmarrësi në Projekt sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo marrëveshje tjetër e Projektit ose në një mënyrë tjetër të ndryshojë, të shfuqizojë ose të marrë përparësi mbi, tërësisht apo një pjesë të kësaj Marrëveshjeje ose çdo marrëveshjeje tjetër të Projektit përfshirë:

A. ligjin nr. 9946, datë 30 qershor 2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

B. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25 gusht 2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënie e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”;

C. ligjin nr. 8897, datë 16 maj 2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe ligjin nr. 10 448, datë 14 korrik 2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe i gjithë legjislacioni dytësor;

D. ligjin nr. 10 431, datë 9 qershor 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe i gjithë legjislacioni dytësor;

E. ligjin nr. 10 440, datë 7 korrik 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” / ligjin nr. 10 448, datë 14 korrik 2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe i gjithë legjislacioni dytësor;

F. ligjin nr. 10 119 datë 23 prill 2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar;

G. ligjin nr. 7850, datë 29 korrik 1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

H. ligjin nr. 8561, datë 22 dhjetor 1999 “Mbi shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”;

I. ligjin nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;

J. ligjin nr. 9920, datë 19 maj 2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar;

K. ligjin nr. 7928, datë 27 prill 1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

L. ligjin nr. 9632, datë 30 tetor 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; dhe

M. ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar,



dhe të gjitha dhe çdo dekret legjislativ, udhëzim dhe vendim ministror, qarkore, rregullore ose akt administrativ i çdo lloji, i nxjerrë kohë pas kohe objekt dhe në përputhje me legjislacionin e mësipërm.

c) Pavarësisht statusit që kjo Marrëveshje do të ketë sipas ligjit shqiptar (përfshirë në kuadër të nenit 3.1 (b)), asgjë në këtë Marrëveshje nuk kufizon ose ndikon në një formë tjetër mbi të drejtat dhe kompetencat e Shtetit për të zbatuar çdo ndryshim të përjashtuar të ligjit.

3.5 Marrëdhënia me lejet e kërkuara shtetërore

Shteti konfirmon se lejet përkatëse shtetërore të listuara në shtojcën 3 dhe leja e posaçme, janë lejet kryesore shtetërore të kërkuara për Projektin.

3.6 Autoriteti për aktivitetet e Projektit deri në këtë datë

Shteti njeh dhe deklaron se Investitori i Projektit është dhe ka qenë tërësisht i autorizuar sipas ligjit shqiptar të ushtrojë aktivitetet e Projektit deri në këtë datë dhe të lidhë këtë Marrëveshje.

4. TRANSPORTIMI I GAZIT NATYROR

Shteti dhe çdo Palë Shtetërore do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar aktivitetet e Projektit të shoqëruara me transportin e gazit natyror nëpërmjet Sistemit Gazsjellës ose në çdo pjesë (përfshirë infrastrukturën shqiptare), në përputhje me parimet e lirisë së transitit dhe pa asnjë dallim të origjinës, destinacionit ose pronësisë së këtij gazi natyror dhe pa vendosur asnjë vonesë të paarsyeshme, kufizim apo detyrim për pagesë.

5. LEJA E POSAÇME DHE LEJA INFRASTRUKTURE

5.1 Menjëherë pas datës efektive, Shteti do të pajisë Investitorin e Projektit me lejen e posaçme për Projektin pa asnjë kërkesë për dokumentacion të mëtejshëm ose veprim nga ndonjë pjesëmarrës në Projekt. Kjo Marrëveshje do të konsiderohet se përmbush të gjitha kërkesat e referuara në paragrafin (18) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25.8.2010, që Investitori i Projektit të hyjë në marrëveshje me Shtetin ose çdo palë shtetërore ose autoritet të pavarur lidhur me lejen e posaçme. Pa paragjykuar kushtet e përgjithshme të mësipërme, kjo Marrëveshje nuk kërkohet të ketë përmbajtjen e përshkruar në paragrafin (18) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25.8.2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”.

5.2 Investitorit të Projektit nuk do t’i kërkohet të themelojë një shoqëri në Republikën e Shqipërisë sipas paragrafëve (2), (4), (5), (6.a) dhe (7) të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25 gusht 2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”. Investitorit të Projektit (me degë të regjistruar në Shqipëri, siç përmendet në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje) do t’i jepet leja e posaçme.

5.3 Shteti është dakord që METE, menjëherë përpara skadimit të lejes së posaçme (përfshi çdo leje të posaçme të mëtejshme, të lëshuar në bazë të nenit 5.3), qoftë në përputhje me kushtet ose me ligjin shqiptar, do të pajisë Investitorin e Projektit me një tjetër leje të posaçme për Investitorin, sipas nenit 8, paragrafi 2 të ligjit për gazin, pa kushte të tjera dhe me afat për 30 vite të mëtejshme, pa asnjë kërkesë për ndonjë veprim nga çdo palë shtetërore ose autoritet i pavarur. Dispozitat e paragrafëve (18/c) dhe (27) të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25 gusht 2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, lidhur me rinovimin e lejes së posaçme nuk do të zbatohen për Investitorin e Projektit.

5.4 Shteti bie dakord që METE të pajisë Investitorin e Projektit me një leje infrastrukturore për të gjithë Sistemin Gazsjellës, sa u përket aktiviteteve të Projektit që do të kryhen në lidhje me [korridorin e interesit] në përputhje me nenin 28 dhe pa paragjykuar nenin 28.6 (f). Leja infrastrukturore do të lëshohet në mënyrë graduale, në lidhje me seksionet dhe fazat e ndryshme të zhvillimit të Sistemit Gazsjellës, në përputhje me kërkesat e Investitorit të Projektit, kohë pas kohe

dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse sa i përket fazës ose seksionit në fjalë, siç kërkohet nga dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10 119, datë 23 prill 2009 “Për planifikimin e territorit”.

6. RREGULLORJA E ERE-s

Shteti bie dakord që:

a) çdo leje shtetërore e lëshuar nga ERE për Investitorin e Projektit në bazë të ligjit për gazin (përfshirë, pa u kufizuar, nenin 14 të ligjit për gazin):

i) mund të transferohet nga Investitori i Projektit te çdo palë e tretë që do të marrë përsipër ato aktivitete të Projektit, të cilat lidhen me operimin e infrastrukturës shqiptare; dhe

ii) do të jetë në gjendje të transferohet sërish tek Investitori i Projektit me zgjedhjen e Investitorit të Projektit; dhe

b) përveç për sa është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me ligjin përkatës të Bashkimit Europian (përfshirë, pa u kufizuar, rastet kur ligji përkatës i Bashkimit Europian mund të kërkojë ndryshime të një lejeje shtetërore, në vijim të skadimit të përjashtimeve rregullatore) ose për aq sa këto veprime janë në përputhje me kushtet mbi të cilat përjashtimet rregullatore janë lëshuar, ERE nuk do të ketë të drejtë të ndryshojë ose të shfuqizojë çdo leje shtetërore të lëshuar nga ERE për Investitorin e Projektit në bazë të ligjit për gazin, përfshirë çfarëdo tjetër që mund të lejohet:

i) në bazë të ligjit për sektorin e energjisë (ligj nr. 9072, datë 22 maj 2003), i ndryshuar; ose

ii) në bazë të rregullave të ERE-s të licencimit të gazit dhe procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm/plotë, revokimit dhe rinovimit të licencave,

dhe çdo leje shtetërore do të jetë në gjendje të ndryshohet ose shfuqizohet me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me afatet e saj. Ky nen 6(b) ka përparësi mbi çdo ligj shqiptar që bie në kundërshtim me të (përveç ligjit shqiptar që vë në zbatim ligjin përkatës europian).

7. PIKAT LIDHËSE TË RRJETIT SHQIPTAR

Palët (ose përfaqësuesit e tyre) në mirëbesim do të negociojnë, do të pajtohen dhe do të lidhin një marrëveshje interkoneksioni që përmban afate dhe kushte në lidhje me vendndodhjen e pikës lidhëse të rrjetit shqiptar, ndërtimin dhe funksionimin e interkoneksionit midis infrastrukturës shqiptare dhe rrjetin vendas të gazit në Shqipëri dhe të gjitha çështjet e lidhura me to. Kjo marrëveshje interkoneksioni do të konsiderohet të jetë një Marrëveshje Projekti për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

DETYRIMET E PËRGJITHSHME

8. BASHKËPUNIMI

8.1 Shteti njeh dhe bie dakord që Projekti është një projekt me rëndësi kombëtare dhe në interesin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

8.2 Shteti siguron dhe do të sigurojë që çdo Palë Shtetërore të bashkëpunojë aktivisht me Investitorin e Projektit që të zbatojë Projektin sa më efektivisht që të jetë e mundur. Shteti në vijim do të përdorë mjetet tij më të mira që të marrë mbështetje nga, dhe aktivisht do të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve lokale, kurdoherë që kjo mbështetje ose ky bashkëpunim është i nevojshëm për këtë qëllim.

8.3 Shteti do të këshillohet menjëherë me Investitorin e Projektit dhe qeveritë e vendeve të tjera, përfshirë ato të Republikës së Italisë, Republikës së Greqisë dhe Zvicrës, lidhur me çdo masë, përfshirë çdo masë në lidhje me Investitorin e Projektit dhe/ose qeveritë e tjera, me anë të të cilave Shteti mund t'i bëjë aktivitetet ndërkufitare të Projektit më efektive, në kohë dhe efikase, përfshirë efektshmërinë dhe koordinimin e doganave, procedurave të transportit, tarifave dhe praktikave, dhe të përdorë masat e zakonshme dhe lehtësitë matëse brenda territorit shqiptar, në mënyrë që të monitorojë transportin e gazit natyror.

8.4 Përjashtimisht nga sa parashikohet në nenin 33 dhe 43, Shteti merr përsipër që as vetë, dhe as Palët Shtetërore të mos kryejnë veprime që kanë si qëllim dështimin, pengimin ose vonesën e Projektit ose të çdo aktiviteti të Projektit.



9. AKORDIMI I TË DREJTAVE

9.1 Për qëllime të Projektit dhe objekt i kushteve të këtushme dhe të marrëveshjeve të Projektit, Shteti do t'u akordojë:

a) pjesëmarrësve në Projekt, të drejtën dhe privilegjin absolut dhe të pakufizuar të zbatojnë dhe të kryejnë Projektin në përputhje me ligjin shqiptar; dhe

b) Investitorit të Projektit të drejtën ekskluzive dhe të pakufizuar dhe privilegjin të ndërtojë, të ketë në pronësi dhe kontroll infrastrukturën shqiptare.

9.2 Shteti është dakord se, nëse do të kërkohet nga Investitori i Projektit, të vërtetojë akordimin e të drejtave të pjesëmarrësve në Projekt sipas kësaj Marrëveshjeje në një dokument me shkrim në formën e mjaftueshme dhe të kënaqshme për të lehtësuar kryerjen e Projektit ose të aktiviteteve të Projektit në çdo pjesë të tyre.

9.3 Përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, ose me miratim paraprak me shkrim të Shoqërisë së Projektit, as Shteti dhe as ndonjë Palë Shtetërore nuk do të akordojnë të drejta lidhur me përdorimin e infrastrukturës shqiptare ose të drejta në lidhje me tokën e Projektit ose do t'i akordojnë ndonjë personi ndonjë të drejtë që është në mospërputhje ose në kundërshtim, ose mund të ndërhyjë në ndonjë formë në ushtrimin ose gëzimin e plotë nga secili prej pjesëmarrësve në Projekt të të drejtave sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë prej marrëveshjeve të Projektit.

9.4 Sipas kufizimeve detyruese të vendosura nga ligji shqiptar, Shteti do të sigurojë se secila Palë tjetër Shtetërore, në mënyrë të pakthyeshme, pranon të gjitha të drejtat e akorduara ose që i janë vënë në dispozicion Investitorit të Projektit ose secilit pjesëmarrës në Projekt sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.5 Pavarësisht nga secili nen tjetër i kësaj Marrëveshjeje ose i kushteve të lejes së posaçme, ose ndonjë leje shtetërore tjetër, Investitori i Projektit nuk do të ketë asnjë detyrim të zbatojë Projektin ose të ndërmarrë aktivitete të Projektit dhe as Investitori i Projektit dhe as ndonjë pjesëmarrës në Projekt nuk do të kenë ndonjë përgjegjësi kundrejt secilës palë shtetërore, autoriteti të pavarur ose autoriteti lokal për shkak të moszbatimit të Projektit apo moskryerjes së aktiviteteve të Projektit për çfarëdolloj arsye.

10. MARRËVESHJET E PROJEKTIT LIDHUR MIDIS AUTORITETEVE SHTETËRORE DHE/OSE ENTITETEVE SHTETËRORE

10.1 Shteti do të sigurojë përmbushjen në afat të detyrimeve të secilit autoritet shtetëror dhe entitet shtetëror sipas secilës marrëveshje të Projektit të lidhur nga çdo autoritet shtetëror dhe/ose entitet shtetëror.

10.2 Sipas afateve të kësaj Marrëveshjeje, Shteti në një mënyrë të përcaktuar mirë do të akordojë ose do të shkatojë akordimin me shkrim të të gjitha dekreteve, miratimeve, urdhrave, rregulloreve, rregullave, interpretimeve, autorizimeve, aprovimeve të lejeve të autoriteteve të nevojshme dhe do të bëjë të mundur që secila palë shtetërore dhe/ose entitet shtetëror përkatës të përmbushë në një mënyrë të përcaktuar të gjitha detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjeve të Projektit. Shteti, me kërkesën e Investitorit të Projektit, do të japë prova të mjaftueshme për sa më sipër.

10.3 Privatizimi, falimentimi, likuidimi, riorganizmi dhe secili ndryshim në ortakërinë, strukturën organizative, kapacitetin dhe ekzistencën ligjore të çdo Pale shtetërore dhe/ose entiteti shtetëror nuk do të ndikojë detyrimet e Shtetit këtu më poshtë.

10.4 Shteti përgjatë gjithë afatit të secilës marrëveshje të Projektit në të cilën është palë një autoritet shtetëror ose një entitet shtetëror, do të sigurojë që detyrimet e autoritetit shtetëror ose entitetit shtetëror sipas asaj marrëveshjeje të Projektit do të ndërmerren dhe do të kryhen gjithmonë nga një entitet i autorizuar të kryejë dhe i aftë të zbatojë detyrime të tilla, përveç rasteve kur, sipas ndonjë kufizimi në Kushtetutë, Shteti do të kryejë vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha këto detyrime të këtij autoriteti shtetëror ose entiteti shtetëror.

11. ANGAZHIME LIDHUR ME VEPRIMET E AUTORITETEVE LOKALE

11.1 Objekt i kufizimeve detyruese të vendosura nga ligji shqiptar, Shteti:

a) do të bëjë që autoritetet lokale të jenë në përputhje me këtë Marrëveshje sikur autoritetet lokale të jenë autoritete shtetërore; dhe

b) do të përmbushin detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje njëjloj sikur përkufizimi “Autoritet Shtetëror” të përfshijë autoritetet lokale.

11.2 Palët pranojnë kufizimet detyruese të vendosura nga ligji shqiptar, por bien dakord që pavarësisht këtyre kufizimeve, Shteti është në një pozitë më të mirë për të administruar dhe të prokurorë që autoritetet lokale të veprojnë në të njëjtën mënyrë që do t’u kërkohej sikur ato të ishin “Autoritete Shtetërore”.

12. DEKLARIME DHE GARANCI TË SHITETIT

12.1 Shteti deklaron dhe garanton se:

a) ka kompetencën të hyjë dhe të zbatojë këtë Marrëveshje dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe se të gjitha këto veprime janë autorizuar rregullisht me të gjitha procedurat e tij dhe janë rregullisht të autorizuar nga ligji shqiptar për të ekzekutuar këtë Marrëveshje dhe për t’u detyruar, për t’u angazhuar dhe për t’u vendosur detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje, për të dhe secilën Palë Shtetërore këtu më poshtë;

b) ai ka përfunduar të gjitha ratifikimet dhe ka kompletuar të gjitha veprimet parlamentare legjislative dhe veprime të tjera dhe miratime të kërkuara nga ligji shqiptar për të mundësuar që Marrëveshja Ndërqeveritare të jetë efektive dhe ndryshe ka mundësuar që Marrëveshja Ndërqeveritare të jetë detyruese për Shtetin, sipas ligjit ndërkombëtar dhe ligjit shqiptar;

c) për aq sa këto veprime nuk janë përfunduar në datën efektive, menjëherë pas lidhjes së MÇP-së, do të kryejë të gjitha veprimet dhe miratimet e kërkuara nga ligji shqiptar, në mënyrë që MÇP-ja të jetë efektive dhe të mundësojë që MÇP-ja të jetë detyruese për Shtetin dhe e zbatueshme nga Investitori i Projektit sipas ligjit shqiptar;

d) ai ka përfunduar të gjitha veprimet parlamentare, legjislative dhe veprime të tjera dhe akte të kërkuara nga ligji shqiptar, duke bërë që kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe akordime të ndryshme dhe detyrimet e Palëve Shtetërore sipas kësaj Marrëveshjeje në favor të pjesëmarrësve të Projektit të jenë efektive për Shtetin, si pjesë e ligjit shqiptar dhe si detyrime të detyrueshme të Palëve Shtetërore;

e) detyrimet e Shtetit sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë, pa u kufizuar, detyrimet e Shtetit sipas nenit 10.1) dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera, Projektit në të cilat Shteti ose secila Palë Shtetërore është palë janë të vlefshme, të detyruese dhe të ekzekutueshme kundrejt Shtetit dhe secilës Palë Shtetërore në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjeve të tjera të Projektit dhe janë në përputhje dhe të lejuara nga Kushtetuta;

f) deklaratimet, garancitë dhe angazhimet e bëra nga Shteti në Marrëveshjen Ndërqeveritare dhe në MÇP zbatohen *mutatis mutandis*, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe janë të ekzekutueshme sipas saj nga pjesëmarrësit në Projekt;

g) përveç sa është parashikuar në lidhje me të drejtat e akorduara (në datën bazë) për mbajtësit e licencave ekzistuese sipas licencave ekzistuese dhe pa paragjykuar detyrimet e Shtetit në lidhje me licencat ekzistuese, siç përcaktohet në shtojcën 1, as Shteti dhe as ndonjë autoritet shtetëror nuk ka akorduar ose është i detyruar t’i akordojë ndonjë personi, ndonjë të drejtë ose privilegj që është në mospërputhje ose që kundërshton, ose që mund të kufizojë, ose ndërhyjë me kryerjen dhe gëzimin e të drejtave dhe privilegjeve të mbajtura nga secili pjesëmarrës në Projekt ose që do të akordohet në bazë të, ose në përputhje me këtë Marrëveshje;

h) përveç sa është parashikuar në lidhje me të drejtat e akorduara (në datën bazë) për mbajtësit e licencave ekzistuese sipas licencave ekzistuese dhe pa paragjykuar detyrimet e Shtetit në lidhje me licencat ekzistuese, siç përcaktohet në shtojcën 1, ekzekutimi, shpërndarja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të kundërshtojë, rezultojë në një shkelje thelbësore ose përbën



mospërbushje thelbësore me dhe sipas çdo kushti të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, marrëveshje, dekreti ose urdhri në të cilin ai është palë ose nëse nëpërmjet të cilit detyrohet secili aset i tij ose ndikohet, përfshirë çdo marrëveshje midis Shtetit dhe Bashkimit European, ose çdo marrëveshje e Organizatës Botërore të Tregtisë;

i) asnjë deklarim ose garanci e bërë prej tij në këtë Marrëveshje nuk ka lënë jashtë tregimin e një fakti thelbësor të nevojshëm për të bërë një deklarim të tillë apo garanci të rreme në dritën e rrethanave nën të cilën ajo është bërë, fakte thelbësore, të cilat në datën e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje janë njohur apo duhet të ishin njohur në mënyrë të arsyeshme nga Shteti.

12.2 Këto deklarime dhe garanci bëhen në përputhje me:

a) nenet 12.1 (b), 12.1 (c), 12.1 (d), 12.1 (g), 12.1 (h) dhe 12.1 (i) (për sa lidhen me deklarimet dhe garancitë e mësipërme), janë bërë në datën efektive; dhe

b) nenet 12.1 (a), 12.1 (e), 12.1 (f) dhe 12.1 (i) (për sa lidhen me deklarimet dhe garancitë e mësipërme), janë bërë në datën efektive dhe janë përsëritur në secilën ditë më pas, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese me pas.

13. DEKLARIME DHE GARANCI TË INVESTITORIT TË PROJEKTIT

13.1 Investitori i Projektit deklaron dhe garanton se:

a) ai është rregullisht i organizuar, ekziston vlefshmërisht dhe nuk është në gjendje falimentimi ose likuidimi, ose procedura të ngjashme me to, në përputhje me ligjet e Zvicrës, ka fuqi ligjore për t'u angazhuar në biznese që aktualisht ushtron dhe parashikon të ushtrojë dhe është rregullisht i licencuar apo rregullisht i kualifikuar dhe në gjendje të shëndetshme, si një shoqëri e huaj në çdo juridiksion ku natyra e veprimtarisë së biznesit të kryer nga ai kërkojnë domosdoshmërisht këto licenca apo kualifikime;

b) ka fuqi të hyjë dhe të zbatojë këtë Marrëveshjeje dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe se të gjitha këto veprime janë autorizuar rregullisht me të gjitha procedurat e nevojshme prej tij;

c) ekzekutimi, shpërndarja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të kundërshtojnë, rezultojë në shkelje, ose përbën një shkelje ose përshpejton zbatimin e kërkuar nga çdo kusht i dokumenteve ligjore të themelimit dhe organizmit të tij, dekret ose urdhër në të cilin ai është palë, ose nëse nëpërmjet të cilit detyrohet ose ndikohet secili aset i tij;

d) kjo Marrëveshjeje është nënshkruar vlefshmërisht dhe rregullisht, dhe shpërndarë nga ai dhe përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues kundrejt tij, të ekzekutueshëm në përputhje me kushtet e tij, përveç nëse dhe në atë mënyrë që ekzekutueshmëria mund të kufizohet nga falimentimi, riorganizimi ose procese ligjore të tjera të ngjashme, që ndikojnë të drejtat e kreditorëve në përgjithësi ose parimet e përgjithshme të kapitalit;

e) në dijeni të tij nuk ka veprime, padi, procese ose hetime pezull kundër tij përpara ndonjë gjykate, paneli arbitrazhi ose organi qeveritar, veprime që individualisht ose bashkërisht mund të rezultojnë në një mospërbushje thelbësore për biznesin e tij ose kushteve të aseteve, financiare ose ndryshe, ose një dëmtim i tij që ndikon aftësitë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) nuk ka dijeni për ndonjë shkelje ose mospërbushje të ndonjë urdhri, dekreti, vendimi ose mase provizore të ndonjë gjykate, paneli arbitrazhi ose organi qeveritar, i cili mund të përbëjë një mospërbushje thelbësore ose dëmtim;

g) është në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme kundrejt tij dhe nuk ka qenë subjekt i ndonjë gjobe, penaliteti, vendimi për sekuestrim ose përgjegjësi penale, të cilat së bashku ndikojnë ose mund të ndikojnë thelbësisht ecurinë e biznesit të tij ose kushtet financiare të tij ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

h) asnjë deklarin apo garanci e dhënë prej tij në këtë Marrëveshje nuk përmban ndonjë fakt të pavërtetë, ose ndonjë fakt thelbësor që lë jashtë pa përmendur një fakt thelbësor që është i nevojshëm që të sigurojë se ky deklarin apo garanci nuk është i rremë në dritën e rrethanave nën të cilën ajo është bërë në momentin që është bërë.

13.2 Këto deklarime dhe garanci janë bërë në përputhje me:

a) Nenet 13.1 (a), 13.1 (c), 13.1 (e), 13.1 (f), 13.1 (g) dhe 13.1 (h) (për sa lidhen me deklarinimet dhe garancitë e mësipërme), janë bërë në datën efektive; dhe

b) Nenet 13.1 (b), 13.1 (d) dhe 13.1 (h) (për sa lidhen me deklarinimet dhe garancitë e mësipërme), janë bërë në datën efektive dhe janë përsëritur në secilën ditë më pas, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese më pas.

14. SIGURIA

14.1 Shteti do të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme (duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut), duke përfshirë parimet udhëzuese për biznesin dhe të drejtat e njeriut, siç janë miratuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në datën 16 qershor 2011:

a) për të siguruar se nuk ka shkeljet të aktivitetëve të Projektit; dhe

b) për të mbrojtur aktivitetet e Projektit në territorin, infrastrukturën shqiptare dhe të gjithë personat brenda territorit shqiptar të përfshirë në aktivitetet e Projektit nga humbjet ose dëmet, në çdo rast të shkaktuara nga lufta, bllokada, revolucion, sabotimi, vandalizmi, trazira, kryengritjet, trazirat civile, terrorizmi, rrëmbimi, zhvatjet tregtare, krimi i organizuar ose çdo ngjarje tjetër shkatërruese.

14.2 Investitori i Projektit do të bashkëpunojë me Shtetin, në mënyrë që të lejojë Shtetin të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 14.1.

14.3 Shteti do të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të asistuar Investitorin e Projektit në identifikimin e ndonjë materiali ushtarak/artileri të paplasur, që mund të gjendet mbi ose nën, si dhe në afërsi të çdo toke të Projektit. Nëse gjatë zhvillimit të aktivitetëve të Projektit zbulohet material ushtarak i paplasur (ose sende që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohen material ushtarak i paplasur), Shteti pas njoftimit të marrë, do të kryejë zhvendosjen e menjëhershme të këtyre sendeve, me anë të forcave të sigurisë së Shtetit.

15. MBËSHTETJA E QEVERISË

15.1 Pa paragjykuar nenet 10.2, 24.6 dhe 41, Shteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar marrjen, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të të gjitha masave të arsyeshme dhe do të shpallë të gjitha ligjet dhe aktet ligjore që janë ose mund të bëhen të nevojshme sipas ligjit shqiptar, në mënyrë që t'u mundësojë pjesëmarrësve në Projekt të përmbushin kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të marrëveshjeve të Projektit dhe të autorizojë, të mundësojë dhe të mbështesë veprimtaritë dhe transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha marrëveshjet e Projektit.

15.2 Shteti, për aq sa është e mundur, do të konsultohet dhe do të informojë Investitorin e Projektit në lidhje me zhvillimin e çdo ligji ose akti ligjor të nevojshëm dhe mbi gjendjen e të gjitha veprimtarive, të cilat janë ose mund të jenë të nevojshme për të qenë në përputhje me nenin 15.1.

16. TOKA E PROJEKTIT

Toka e Projektit do të identifikohet dhe disa të drejta në tokën e Projektit do të fitohen në përputhje me shtojcën 1 dhe Palët do të pajtohen me detyrimet e tyre në lidhje me tokën e Projektit siç është parashikuar në shtojcën 1.

17. ZHVILLIMET E MËTEJSHME

17.1 Menjëherë pas datës efektive dhe, në çdo rast, përpara fillimit të ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit në Territor, Shteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar miratimin në ligjin shqiptar të rregulloreve për zonën e sigurisë dhe konsultimit.



17.2 Shteti do të sigurojë që asnjë person, përveçse një pjesëmarrësi në Projekt, i cili vepron në lidhje me Projektin, të mos ndërmarrë asnjë veprimtari zhvillimi apo ndërtimi brenda zonave të përcaktuara, ose që do të përcaktohet nga rregulloret për zonën e sigurisë dhe konsultimit që mund të ketë një ndikim negativ në Sistemin e Gazsjellësit pa miratimin paraprak me shkrim të Investitorit të Projektit, dhe ky miratim nuk do të mbahet në mënyrë të paarsyeshme.

17.3 Menjëherë pas miratimit të tyre në ligjin shqiptar, palët shtetërore do të zbatojnë me përpikëri rregulloret për zonën e sigurisë dhe të konsultimit. Nëse Investitori i Projektit njofton Shtetin lidhur me një shkelje të rregullores për zonën e sigurisë dhe konsultimit nga çdo person në lidhje me Sistemin e Gazsjellësit, palët shtetërore do të ndërmarrin menjëherë të gjitha masat ligjore për të ndaluar veprimet përkatëse të personit.

18. STANDARDET MJEDISORE, SOCIALE DHE KOMUNITARE TË SHËNDETIT E TË SIGURISË

18.1 Palët pranojnë se gjatë zhvillimit të aktiviteteve të Projektit, pjesëmarrësit në Projekt do të zbatojnë dhe do të pajtohen:

a) me ato standarde mjedisore dhe ato sociale dhe komunitare të shëndetit e sigurisë të listuara në pjesën 2 të shtojcës 2 (në çdo rast siç mund të ndryshohet ose zëvendësohet herë pas here); dhe

b) me përjashtim kur është i papajtueshëm me standardet e treguara në pikën “a” më sipër (përveç kur papajtueshmëria kërkon zbatimin e një standardi objektivisht më të lartë), ligjin shqiptar lidhur me standardet mjedisore, ato sociale dhe komunitare të shëndetit dhe të sigurisë.

18.2 Deri në masën që çdo Projekt i aktivitetit është rregulluar me ligjin shqiptar, duke mbuluar materialisht çështje të ngjashme të referuara në nenin 18.1, Shteti dhe secila nga palët e tjera shtetërore dhe secili autoritet i pavarur pranon dhe jep pëlqimin për atë aktivitet të Projektit, nga ose në emër të pjesëmarrësve në Projekt, deri në masën që ky aktivitet është ndërmarrë në përputhje me standardet e treguara në nenin 18.1 dhe se çdo aktivitet i tillë do të konsiderohet se është në përputhje me secilin ligj shqiptar që mbulon materialisht një çështje të njëjtë.

18.3 Palët do të bashkëpunojnë me pjesëmarrësit në Projekt dhe do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të asistuar pjesëmarrësit në Projekt në lidhje me ato aktivitete të Projektit që lidhen me zbulimin dhe heqjen e fosileve, monedhave, sendeve me vlerë apo antike dhe strukturat, si dhe mbetje të tjera apo njësi të interesave gjeologjike apo arkeologjike të gjetura si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Nëse heqja e këtyre njësive do të kërkonte, zakonisht apo si një kërkesë e ligjit shqiptar do të duhej të ndërmerrej nga një shtet palë, Shteti do të sigurojë se kjo heqje do të kryhet menjëherë pas njoftimit të kryer nga Investitori i Projektit.

18.4 Jo më vonë se 60 ditë pas paraqitjes, nga Investitori i Projektit, të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social në lidhje me aktivitetet e Projektit, Shteti do të fillojë procedurën e konsultimit me Republikën Greke dhe Republikën e Italisë të kërkuar nga Konventa Espoo në lidhje me Projektin.

18.5 Palët njohin dhe bien dakord që:

a) ligji nr. 8990, datë 23 janar 2003 “Mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis” (ligji i mëparshëm mjedisor) është zëvendësuar nga ligji nr. 10 440, datë 7 korrik 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe ligji nr. 10 448, datë 14 korrik 2011 “Për lejet e mjedisit” (ligji i ri mjedisor); dhe

b) përpara hyrjes plotësisht në fuqi të ligjit të ri mjedisor, Investitori i Projektit ka ndërmarrë një sërë veprimtarish në bazë të ligjit të mëparshëm mjedisor, përfshirë këtu përgatitjen dhe paraqitjen pranë autoriteteve shtetërore përkatëse, të aplikimit për leje mjedisore. Pavarësisht hyrjes plotësisht në fuqi të ligjit të ri mjedisor:

i) aplikimi i Investitorit të Projektit për leje mjedisore për projektin dhe vlerësimi i autoriteteve shtetërore përkatëse për dhënien e saj, përfshirë të gjitha kërkesat procedurale dhe për dokumentacionin, që lidhen me këtë aplikim, do të rregullohet nga ligji i mëparshëm mjedisor;

ii) pas dhënies së lejes mjedisore për projektin, asnjë palë shtetërore nuk do të ketë të drejtë të revokojë ose të shfuqizojë këtë leje mjedisore, bazuar në faktin që ajo është dhënë sipas ligjit të mëparshëm mjedisor; dhe

iii) përveç sa parashikohet në lidhje me aplikimin e Investitorit të Projektit për leje mjedisore për Projektin dhe vlerësimin e autoriteteve shtetërore përkatëse për dhënien e saj, Investitori i Projektit do të veprojë në përputhje me ligjin e ri mjedisor (siç ndryshohet kohë pas kohë, por pa paragjykuar të drejtat që Investitori i Projektit mund të ketë në bazë të nenit 32 (ndryshimi i ligjit) në lidhje me këtë ndryshim), duke filluar nga hyrja në fuqi e tij.

19. STANDARDET E PUNËS

19.1 Palët deklarojnë se gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të Projektit, pjesëmarrësit në Projekt do të zbatojnë dhe do të pajtohen me (në çdo rast siç mund të ndryshohet apo zëvendësohet herë pas here):

a) “Standardet Thelbësore të Punës” të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës;

b) ato standarde të detajuara në kërkesat për zbatim 2 (kushtet e punës) të politikës sociale dhe mjedisore; dhe

c) me përjashtim për aq sa nuk përputhet me standardet e referuara në paragrafët “a” dhe “b” më sipër (përveç nëse këto mospërputhje kërkojnë zbatimin e një standardi objektivisht më të lartë), ligjin shqiptar lidhur me standardet e punës.

19.2 Deri në masën që çdo Projekt i aktivitetit është rregulluar me ligjin shqiptar, duke mbuluar materialisht çështje të njëjta si ajo e referuar në nenin 19.1, Shteti, secila nga palët e tjera shtetërore dhe secili autoritet i pavarur pranon dhe jep pëlqimin për atë aktivitet të Projektit, i ndërmarrë nga ose në emër të pjesëmarrësve në Projekt, deri në masën që ky aktivitet është ndërmarrë në përputhje me standardet e treguara në nenin 19.1 dhe se çdo aktivitet i tillë do të konsiderohet se është në përputhje me secilin ligj shqiptar që mbulon materialisht një çështje të njëjtë.

20. STANDARDET TEKNIKE

20.1 Palët pranojnë se gjatë ushtrimit të aktiviteteve të Projektit, pjesëmarrësit në Projekt do të zbatojnë dhe do të pajtohen me ato standarde teknike të listuara në pjesën 1 të shtojcës 2 (në çdo rast siç mund të ndryshohet apo të zëvendësohet herë pas here) dhe për aq sa nuk drejtohet nga ato standarde teknike të listuara në pjesën 1 të shtojcës 2 ose ligjin shqiptar, ato standarde të përdorura përgjithësisht, herë pas here në Bashkimin Europian.

20.2 Deri në masën që çdo Projekt i aktivitetit është rregulluar me ligjin shqiptar, duke mbuluar materialisht çështje të njëjta si ajo e referuar në nenin 20.1, Shteti, secila nga palët e tjera shtetërore dhe secili autoritet shtetëror pranon dhe jep pëlqimin për atë aktivitet të Projektit, i ndërmarrë nga ose në emër të pjesëmarrësve në Projekt, deri në masën që ky aktivitet është ndërmarrë në përputhje me standardet e treguara në nenin 20.1 dhe se çdo aktivitet i tillë do të konsiderohet se është në përputhje me secilin ligj shqiptar që mbulon materialisht një çështje të njëjtë.

21. PERSONELI DHE TRAJNIMI

Secili pjesëmarrës në Projekt do të ketë të drejtë, për qëllime të ushtrimit të aktiviteteve të Projektit, të punësojë apo të lidhë kontrata me personat dhe përfaqësuesit e tyre përkatës (të çfarëdolloj kombësie apo shtetësie) që sipas opinionit të pjesëmarrësve në Projekt zotërojnë njohuritë, kualifikimet dhe ekspertizën e nevojshme për të ushtruar këto aktivitete.

22. PËRMBAJTJA LOKALE

Investitori i Projektit, në masën e lejueshme nga ligji i zbatueshëm, do të kërkojë sipas kontratave të tij me secilin kontraktor që siguron shërbime për ndërtimin, operimin apo



mirëmbajtjen, apo materialet për infrastrukturën shqiptare që t'u jepet përparësi furnizuesve shqiptarë në ato raste në të cilat furnizuesit shqiptarë janë në të gjitha aspektet thelbësore, konkurrues në çmim, cilësi, saktësinë financiare dhe vlefshmërinë në krahasim me furnizuesit e disponueshëm nga vendndodhje të tjera.

23. AKSESIMI I BURIMEVE DHE I INFRASTRUKTURËS

23.1 Shteti dhe secila nga palët shtetërore do të kryejë të gjitha përpjekjet e mundshme të arsyeshme për të asistuar pjesëmarrësit në Projekt me kërkesën e Investitorit të Projektit për përfundimin (përfshirë nga autoritetet lokale), sipas kushteve më të mira të disponueshme lidhur me projektin:

a) uji menjëherë i disponueshëm i një cilësie dhe sasive të ndodhur në afërsi të tokës së Projektit, në mënyrë që të kryhen testime hidrostatike dhe testime të tjera të Sistemit të Gazsjellësit, së bashku me të drejtën për të disponuar atë në vendndodhjen(t) në afërsi të tokës së Projektit në përfundim të këtij testimi dhe ky disponim duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e parashikuara në nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje;

b) të gjitha mallrat, punët, shërbimet (duke përfshirë punën dhe burimet njerëzore) dhe teknologjia që mund të jetë e nevojshme ose e përshtatshme për Projektin në gjykimin e arsyeshëm të Investitorit të Projektit, që nuk zotërohet, kontrollohet ose normalisht ofrohet nga autoritetet shtetërore dhe/ose entitetet shtetërore (përfshirë këtu lëndën e parë, elektricitetin, ujin (përveç ujit të përcaktuar në nenin 23.1 (a)) gazin, mjetet e komunikimit, utilitetet e tjera, ndërtimin në tokë dhe mundësitë e fabrikimit, bazat e furnizimit, anijet, lehtësitë e importit për mallra dhe pajisje, magazinimin dhe mjetet e transportit).

23.2 Shteti dhe secila nga palët shtetërore do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të asistuar secilin pjesëmarrës në Projekt me kërkesë të Investitorit të Projektit, për të marrë me kushtet më të mira të disponueshme, sa u përket juridiksioneve dhe autoriteteve jashtë territorit shqiptar, ato të drejta, licenca, viza, leje, miratime, certifikata, autorizime dhe lejime të nevojshme apo të përshtatshme për Projektin, përfshirë:

a) magazinimin ose vendosjen e linjave të tubacionit, materialeve, pajisjeve dhe furnizimeve të tjera të destinuara për në ose që dalin nga territori shqiptar;

b) të gjitha anijet që lundrojnë për në ose nga territori shqiptar në lidhje me kryerjen e aktiviteteve të Projektit; dhe

c) importin dhe/ose eksportin ose rieksporin e ndonjë malli, pune, shërbimi ose teknologjie të nevojshme për Projektin,

me kusht që në çdo rast, mënyra që Shteti ose secila palë shtetërore do të akordojë këtë asistencë, do të jetë në diskrecionin e Shtetit ose asaj pale shtetërore.

TAKSAT, IMPORTI DHE EKSPORTI, MONEDHA

24. TAKSAT

Të përgjithshme

24.1 Shteti do të garantojë se trajtimi për qëllime të detyrimeve tatimore i pjesëmarrësve në Projekt dhe çdo personi tjetër në lidhje me çdo pjesë të Projektit, ose aktive dhe aktivitete të lidhura me të, do të jetë jo më pak i favorshëm, se trajtimi i zbatueshëm për shtetasit e tij, në të njëjtat rrethana, sipas ligjit të përgjithshëm në lidhje me detyrimet tatimore.

24.2 Në lidhje me masat për detyrimet tatimore përkatëse ose pagesa të tjera, pavarësisht nga emri apo origjina e tyre, Shteti do të bashkëpunojë me shtetet e tjera në nivel shumëpalësh, për të siguruar një aplikim të drejtë dhe transparent të detyrimeve tatimore të pjesëmarrësit të Projektit dhe çdo person tjetër, në lidhje me çdo pjesë të Projektit ose aktive dhe aktivitete të lidhura me të, në përputhje me frymën e marrëveshjeve të ndryshme për tatimin e dyfishtë, të lidhura midis Shtetit dhe shteteve të tjera. Shteti do të përpiqet të minimizojë numrin dhe kompleksitetin e formaliteteve në lidhje me taksat dhe të zvogëlojë dhe të thjeshtojë kërkesat e dokumentacionit në lidhje me taksat.

24.3 Shteti konfirmon se, përveç sa është rënë dakord shprehimisht dhe sa është parashikuar në MÇP, nuk do të vendosë asnjë detyrim tatimor mbi të gjitha ose një pjesë të Projektit të kryer jashtë territorit shqiptar (përfshirë midis të tjerash, aktivitetet e Projektit që do të kryhen në atë pjesë të detit Adriatik që shtrihet midis Republikës së Italisë dhe Shtetit, në shtratin, nëntokën dhe hapësirën ajrore mbi të, e cila nuk përbën pjesë të detit territorial të Shtetit, të përcaktuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike).

24.4 Shteti merr përsipër:

- a) të pajtohet me dhe të zbatojë plotësisht MÇP-në sipas afateve/kushteve të saj; dhe
- b) të mos amendojë, ndryshojë, pezullojë apo përfundojë MÇP-në pa miratimin paraprak me shkrim të Investitorit të Projektit.

24.5 Përveç sa është parashikuar dhe lejuar, shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, ligji tatimor i shtetit, në datën bazë, do të jetë i vlefshëm dhe do të zbatohet ndaj Investitorit të Projektit gjatë kohëzgjatjes së Projektit.

Tatimi mbi fitimin

24.6 Selia e Përhershme e Investitorit të Projektit në Shtet do të jetë subjekt i tatimit shqiptar mbi fitimin, sipas ligjit nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998 (tatimi shqiptar mbi të ardhurat) (siç kjo taksë ekziston dhe zbatohet në datën bazë).

24.7 Shpërndarja e të ardhurave midis Investitorit të Projektit dhe Selisë së Përhershme në Shtet do të bëhet sipas parimeve të zbatueshme të OBEZH-it, përfshirë këtu parimin e pavarësisë kontraktore (*arms length*), si përcaktohet në Udhëzuesin e OBEZH-it për Transferimin e Çmimit, të vitit 2010, dhe do të miratohet nga Republika e Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane si palë e MÇP-së.

24.8 Bazuar në shpërndarjen e funksioneve, risqeve dhe aktiveve materiale dhe jomateriale midis Investitorit të Projektit dhe Selisë së Përhershme të Investitorit të Projektit në Shtet, sipas parimit të pavarësisë kontraktore (*arms length*), Selia e Përhershme e Investitorit të Projektit në Shtet do të përfitojë:

a) një kompensim bazuar në metodën kosto plus, që do të thotë aplikimi i një marzhi rritjeje me të paktën 10% mbi shpenzimet operative të kryera, të provigjonuara dhe të alokuara në çdo vit financiar; dhe

b) duke filluar nga data e operimit tregtar, një e ardhur shtesë si përqindje e pjesës së vlerës kontabël të Sistemit Gazsjellës, sipas SNRF-së që i përket infrastrukturës shqiptare, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit në çdo vit financiar. Përqindja e lartpërmendur do të jetë të paktën 3.9%; dhe

c) nëse vlera kontabël e Sistemit Gazsjellës, sipas SNRF-ve që i përket infrastrukturës shqiptare, do të rritet pas datës së operimit tregtar, kjo vlerë më e madhe do të jetë baza e llogaritjes së të ardhurave sipas nenit 24.8 (b), duke filluar nga viti financiar në të cilin kjo rritje bëhet efektive.

24.9 Është e njohur që pavarësisht ndonjë dispozite tjetër në këtë Marrëveshje që parashikon ndryshe, marrëveshjet për tatimin e dyfishtë do të kenë efekt për dhënien e përfitimeve në lidhje me taksat që kanë të bëjnë me të gjithë ose një pjesë të aktiviteteve të Projektit.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

24.10 Shteti pranon se TVSH-ja nuk duhet të jetë kosto për Projektin (si direkt ashtu dhe nëpërmjet mekanizmit të vetëfaturimit), duke qenë se qëllimi i Projektit nuk është ofrimi i mallrave, punëve apo shërbimeve për konsum përfundimtar brenda Shtetit, por ofrimi i shërbimeve për transportuesit që veprojnë si persona të tatueshëm jashtë territorit shqiptar, i cili është në të njëjtën linjë me parimin e paanshmërisë së sistemeve të TVSH-së, për të pajisur bizneset me aktivitet të tatueshëm me një të drejtë të përgjithshme për rimbursimin e TVSH-së.



24.11 Për sa më sipër, Shteti bie dakord si vijon:

a) Vendi i furnizimit të shërbimeve të ofruara nga Investitori i Projektit për transportuesit do të jetë vendi ku secili prej tyre ka themeluar biznesin e tij, ose nëse shërbimet janë ofruar te një seli e përhershme e transportuesit, në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai ka themeluar biznesin e tij, vendi i ofrimit për këto shërbime do të jetë vendi ku është vendosur Selia e Përhershme.

b) Aktiviteti i Investitorit të Projektit për ofrimin e shërbimeve të transportit të gazit natyror të transportuesit, do të konsiderohet si jashtë objektit të TVSH-së shqiptare me të drejtën për zbritje dhe e gjithë TVSH-ja shqiptare që ka rënduar Investitorin e Projektit në lidhje me të gjithë ose një pjesë të aktiviteteve të Projektit do të jetë e rimbursueshme.

c) Furnizimi me gaz natyror nga transportuesit si karburant për operimin e Sistemit të Gazsjellësit për Investitorin e Projektit do të jetë objekt i TVSH-së për importin në normën e përcaktuar nga ligji shqiptar i zbatueshëm. TVSH-ja për importin do të llogaritet në bazë të çmimit të pagueshëm nga Investitori i Projektit për dorëzimin në kushtet CIF, sipas inkotermave të gazit natyror për linjën e parë të mbushjes së gazit për Sistemin Gazsjellës, i cili do të vlerësohet kundrejt normës mesatare të tregut në nivelin në pikën e shkëmbimit virtual në Itali, për muajin në të cilin gazi është konsumuar në stacionet e mbushjes sipas përshkrimit në nenin 25.2.

d) Marrja e pagesave për likuidimin e dëmeve nga një seli e përhershme nuk do të krijojë një detyrim për TVSH-në.

Të ndryshme

24.12 Nëse rimbursimi nga administrata tatimore e Shtetit, nuk është bërë brenda periudhës së 30 ditëve kalendarike, në përputhje me nenet 75 dhe 76 të ligjit nr. 9920, datë 19 maj 2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, administrata e taksave duhet të paguajë interesin mbi shumën e mbipagesës, si vijon:

a) nëse një mbipagesë është kredituar kundrejt një përgjegjësie tjetër tatimore, ky interes paguhet nga data e mbipagesës deri në datën e rregullt të pagesës së taksës kundrejt së cilës është bërë kreditimi;

b) nëse një mbipagesë është rimbursuar, ky interes do të paguhet për periudhën që fillon 30 ditë pas kryerjes së mbipagesës deri në pagimin e rimbursimit.

Pavarësisht ndonjë ligji shqiptar që parashikon të kundërtën, norma e interesit e zbatueshme në të tilla rrethana do të jetë norma e interesit e rënë dakord. Interesi është i pagueshëm në të gjitha rrethanat dhe prej tij nuk mund të hiqet dorë nga Shteti (duke përfshirë dhe administratën tatimore të Shtetit), apo apelohej, përveç në masën në të cilën janë bërë gabime në llogaritjet e shumave përkatëse të interesit, ose në masën në të cilën përgjegjësia tatimore, mbi të cilën aplikohet ka ndryshuar. Pa paragjykuar nenin 31.8, këto pagesa interesi, si dhe çdo pagesë tjetër interesi e bërë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë ato në bazë të nenit 42, janë objekti i tatimit shqiptar mbi të ardhurat.

24.13 Çdo kompensim, duke përfshirë çdo interes mbi këtë kompensim, i marrë nga Investitori i Projektit nga çdo shtet palë në bazë të kësaj ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose çdo marrëveshje tjetër të Projektit, nuk do të jetë objekt i asnjë forme tatimi nga ndonjë autoritet shtetëror.

24.14 Çdo kompensim, duke përfshirë çdo interes mbi të, për t’u paguar nga Investitori i Projektit te çdo shtet palë, i cili i atribuohet Selisë së Përhershme të Investitorit të Projektit në Shtet, në bazë të kësaj ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose çdo marrëveshje tjetër të Projektit, nuk do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore në Shtet.

24.15 Në lidhje me çdo kompensim, duke përfshirë interesin mbi të, të paguar ose të marrë në bazë të kësaj, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose çdo marrëveshje tjetër të Projektit nga, ose te (sipas rastit) çdo shtet palë, Investitori i Projektit dhe jo Selia e Përhershme e Investitorit të Projektit në Shtet, do të konsiderohet si pagues ose marrës (sipas rastit) i këtij kompensimi.

24.16 Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, pjesëmarrësit në Projekt, si dhe punëmarrësit përkatës, nuk do të kenë përgjegjësi kundrejt Shtetit, për dështimet nga ana e ndonjë pjesëmarrësi tjetër në Projekt për të vepruar në përputhje me ligjin tatimor shtetëror, për sa u përket taksave në lidhje me të gjithë ose pjesë të aktiviteteve të Projektit.

24.17 Dispozitat e këtij neni 24 nuk do të ndryshohen gjatë periudhës së kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin e të dyja Palëve. Në asnjë rast, ndryshimet e këtij neni 24 nuk do të jenë prapavepruese.

24.18 Pa kufizuar zbatimin e nenit 43, dispozitat e këtij neni 24 do të jenë të vlefshme edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të mbeten në fuqi gjatë kohëzgjatjes së Projektit. Nëse një pjesëmarrës në Projekt nuk ka më këtë status, dispozitat e këtij neni 24 do të vazhdojnë të zbatohen për taksat ose çdo detyrim në lidhje me taksat ose çdo detyrim regjistrimi, që lind nga ose në lidhje, drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejtë me aktivet ose aktivitetet e këtij pjesëmarrësi në Projekt, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha periudhat, në të cilat ky person ka pasur këtë status.

25. IMPORTI DHE EKSPORTI

25.1 Shteti dhe çdo palë shtetërore do t'u akordojë gazit natyror dhe mallrave e shërbimeve të tjera, të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me aktivitetet e Projektit, një trajtim jo më pak të favorshëm në lidhje me importimin dhe/ose eksportimin e tyre nga Shteti (sipas rastit), se trajtimi që u sigurohet mallrave dhe shërbimeve me origjinë të ngjashme, të cilat nuk janë të lidhura me Projektin.

25.2 Furnizimi i linjës së parë të mbushjes me gaz të Sistemit Gazsjellës për Investitorin e Projektit, do të jetë objekt i detyrimeve doganore, mbi bazën e çmimit të pagueshëm nga Investitori i Projektit për dorëzimin e këtij gazi natyror në kushtet CIF të inkotermave. Furnizimi me gaz për konsum në stacionet e mbushjes nga transportuesit për Investitorin e Projektit, do të jetë objekt i detyrimeve doganore të pagueshme në ditën e 10-të të çdo muaji dhe të llogaritur në bazë të normës mesatare të tregut në pikën e shkëmbimit virtual në Itali, për muajin në të cilin gazi është furnizuar dhe sasinë aktuale të gazit të konsumuar në muajin e mëparshëm.

25.3 Shteti do të minimizojë numrin dhe kompleksitetin e formaliteteve të importit dhe eksportit dhe do të zvogëlojë kërkesat e dokumentacionit në lidhje me mallrat dhe/ose shërbimet e përmendura më lart.

25.4 Dispozitat e këtij neni 25 do të përfshijnë tarifën, pagesat, formalitetet dhe kërkesat e vendosura nga Shteti dhe/ose palët shtetërore për importimin dhe eksportimin në lidhje me aktivitetet e Projektit, përfshirë, por pa u kufizuar në ato që kanë lidhje me transaksionet konsullore, si: faturat konsullore dhe certifikatat, kufizimet sasiore, licencimet, ndryshimin e kontrollit, shërbimet statistikore, dokumentet, dokumentimin dhe certifikimin, analizën dhe inspektimin, dhe karantinën, higjienën, dhe dezinfektimin.

26. MONEDHA E HUAJ

26.1 Shteti konfirmon se në datën efektive, pjesëmarrësit në Projekt në lidhje me aktivitetet e Projektit do të kenë të drejtën, në bazë të ligjit shqiptar, që midis të tjerash:

a) të sjellin në, të mbajnë dhe të nxjerrin nga territori shqiptar monedhë të huaj dhe të hapin, mbajnë dhe përdorin pa asnjë kufizim llogari bankare në monedhë të huaj dhe llogari të tjera në territorin shqiptar;

b) të hapin, të mbajnë dhe të përdorin llogari bankare në monedhën vendase dhe llogari të tjera në territorin shqiptar;

c) të shkëmbejnë çdo monedhë në kurset e tregut ose në kurset zyrtare, të cilat nuk janë në nivelet e tregut;

d) të blejnë dhe/ose të shkëmbejnë monedhë lokale me dhe/ose në monedhë të huaj;

e) të transferojnë, të mbajnë dhe të ruajnë monedhë të huaj jashtë territorit shqiptar;



f) të përjashtohen nga të gjitha shkëmbimet e detyrueshme, nëse ka, të monedhës së huaj në monedhën vendase ose në ndonjë monedhë tjetër;

g) të paguajnë jashtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, plotësisht ose pjesërisht, në monedhë të huaj, pagesat, shtesat dhe përfitime të tjera të ndonjë punëmarrësi të huaj;

h) të paguajnë kontraktorët (vendas ose të huaj) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, plotësisht ose pjesërisht, në monedhë të huaj, për mallrat, punimet, teknologjinë ose shërbimet e tyre të furnizuara në Projekt; dhe

i) të kryejnë pagesat e parashikuara sipas Marrëveshjes së Projektit ose Kontratës së Zbatimit në monedhë të huaj,

dhe Shteti do të sigurojë që pjesëmarrësit e Projektit të kenë, në çdo kohë, pas datës efektive, këto të drejta në bazë të ligjit shqiptar në lidhje me aktivitetet e Projektit, por, në çdo rast, sipas kërkesave procedurale, të cilat nuk janë më tepër rënduese sesa ato të kërkuara nga standardet e pranura ndërkombëtare.

26.2 Shteti do të ndërmarrë gjithë masat dhe hapat e nevojshëm për të siguruar se ai dhe çdo palë shtetërore ka në dispozicion në çdo kohë monedhë të konvertueshme dhe mjetet efektive të pagesës për t'i transferuar te personi përkatës në vlerë të plotë dhe në kohën përkatëse.

26.3 Për të shmangur çdo dyshim, asnjë palë shtetërore nuk do të jetë e detyruar t'u ofrojë pjesëmarrësve në Projekt ndonjë lehtësi për këmbimin e monedhës, përfshirë lehtësitë në lidhje me këmbimin e monedhës me kurset e tregut ose kurset zyrtare, të cilat nuk janë në nivelin e tregut.

ZBATIMI

27. PËRFAQËSUESIT

27.1 Përfaqësuesit e Shtetit

a) Shteti dhe Këshilli i Ministrave emërojnë ministrin përgjegjës për energjinë (përfaqësuesin e Shtetit) si përfaqësuesin e tyre për të gjitha çështjet që lindin në lidhje me këtë Marrëveshje, i cili do të jetë i autorizuar të japë njoftimet dhe të komunikojë me Investitorin e Projektit në emër dhe për llogari të Shtetit dhe çdo ministrie të Shtetit. Palët pranojnë se Shteti ka të drejtë të zëvendësojë Përfaqësuesin e Shtetit pas njoftimit të arsyeshëm të Investitorit të Projektit.

b) Investitori i Projektit do të ketë të drejtën të bazohet në komunikimet, veprimet, informacionin dhe paraqitjet e përfaqësuesit të Shtetit, njësoj sikur këto të ishin komunikimet, veprimet, informacioni dhe paraqitjet e Shtetit.

27.2 Përfaqësuesit e Investitorit të Projektit

a) Investitori i Projektit do të emërojë, brenda 30 ditësh pune nga data e nënshkrimit, një ose më shumë përfaqësues, komitete ose organe të tjera funksionale, me të cilat ose nëpërmjet të cilave Investitori i Projektit mund të veprojë me qëllimin për të lehtësuar metodën dhe mënyrën e ushtrimin në kohën e duhur dhe me efektivitet nga ana e Investitorit të Projektit të të drejtave dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje (përfaqësuesi/t e Investitorit të Projektit).

b) Pas emërimit të përfaqësuesit/ve të Investitorit të Projektit, Shteti do të ketë të drejtën të bazohet në komunikimet, veprimet, informacionin dhe paraqitjet e përfaqësuesit/ve të Investitorit të Projektit në lidhje me fushën e njoftuar të autoritetit të këtij përfaqësuesi të Investitorit të Projektit, njësoj sikur këto të ishin komunikimet, veprimet, informacioni dhe paraqitjet e Investitorit të Projektit. Palët pranojnë se Investitori i Projektit do të ketë të drejtën, që pas njoftimit të arsyeshëm të Shtetit, të heqë, të zëvendësojë ose të pushojë përdorimin e një ose më shumë përfaqësuesve të Investitorit të Projektit, me kusht që gjithmonë do të ketë të paktën një përfaqësues të Investitorit të Projektit.

28. LEJET SHTETËRORE

28.1 Me kërkesën e ndonjërit prej pjesëmarrësve në Projekt, Shteti do të mundësojë ose do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që autoriteti shtetëror ose autoriteti i pavarur përkatës të japë menjëherë me shkrim një përshkrim të detajuar të të gjithë dokumentacionit ose informacionit tjetër që kërkohet të dorëzohet për marrjen e ndonjë leje shtetërore, së bashku me konfirmimin se ky

përshkrim i detajuar është gjithëpërfshirës dhe përfundimtar dhe se nëse ky dokumentacion ose informacion tjetër do të dorëzohet, leja shtetërore do të jepet.

28.2 Shteti do të kryejë ose do të mundësojë që Autoriteti Shtetëror ose Autoriteti i Pavarur përkatës, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe me përparësi, brenda afatit kohor të caktuar nga ligji shqiptar (ose në bazë të nenit 28.3, kur nuk ka një afat të përcaktuar, brenda 60 ditësh nga dorëzimi i aplikimit përkatës) dhe me kusht që aplikimi të përmbushë kërkesat e detyrueshme për marrjen e lejes shtetërore (përfshirë pagimin e çdo tarife dhe detyrimi të përshtatshëm), që ka të bëjë me lëshimin e lejes shtetërore, të lëshojë/japë çdo leje shtetërore të nevojshme si kërkesë e detyrueshme e ligjit shqiptar ose që është e përshtatshme sipas gjykimit të Investitorit të Projektit për të mundësuar këtë të fundit dhe gjithë pjesëmarrësit në Projekt të kryejnë aktivitetet e Projektit në kohë, në mënyrë të sigurt dhe të efektshme, dhe/ose të ushtrojnë të drejtat dhe të përmbushin detyrimet e tyre në përputhje me këtë Marrëveshje dhe marrëveshjet e Projektit, përfshirë dhe sa kanë lidhje me:

- a) detyrimet doganore;
- b) licencat e importit dhe eksportit;
- c) vizat, lejet e punës dhe lejet e qëndrimit;
- d) të drejtat dhe licencat në përputhje me ligjin shqiptar përkatës, për të përdorur aparaturë matëse dhe të komunikimit (përfshirë dedikimin e një numri të mjaftueshëm dhe ekskluziv të frekuencave të radios dhe telekomunikacionit, siç do të kërkohej nga Investitori i Projektit për të mundësuar operimin e njëjtë dhe të efektshëm të Sistemit të Gazsjellësit brenda dhe jashtë territorit shqiptar);
- e) të drejtën për të themeluar degë, seli të përhershme, filiale, shoqëri, zyra dhe çdo formë tjetër të aktivitetit tregtar apo pranisë në territorin shqiptar, si mund të gjykohej e nevojshme nga çdo pjesëmarrës në Projekt për të kryer në mënyrë të rregullt aktivitetet e Projektit, përfshirë të drejtën për të marrë me qira ose kur është e përshtatshme të blejë ose të përfitojë pasuri të paluajtshme ose të tjera, të cilat nevojiten për aktivitetet e Projektit ose për administrimin e aktivitetit tregtar ose interesave në Projekt;
- f) të drejtën për të përdorur automjete dhe pajisje të tjera mekanike, në përputhje me ligjin shqiptar përkatës, të drejtën të përdorë avionë, anije, si dhe mjete të tjera lundruese në territorin shqiptar;
- g) lejet ambientale dhe të sigurisë me kusht që kërkesat e nenit 18 të jenë përmbushur;
- h) lejet për ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës shqiptare;
- i) kalimin e një pjese të infrastrukturës shqiptare në infrastrukturën ekzistuese ose në elemente gjeografike të rregulluara, përfshirë këtu rrugë, hekurudha ose lumenj;
- j) zbatimin e punimeve për hyrjen në rrugët publike;
- k) rivendosjen e përkohshme të ndonjë infrastrukture ekzistuese ose elementi gjeografik të rregulluar, duke përfshirë rrugë, hekurudha apo lumenj, për qëllimin e kryerjes së ndonjë nga aktivitetet e Projektit në territorin shqiptar;
- l) lejet për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë ato në lidhje me administrimin e tokës dhe materialeve të ndotura dhe krijimin e hapësirave për depozitimin e mbetjeve, atje ku kapaciteti i landfillit të disponueshëm në zonën përkatëse është, nuk ekziston ose është i pamjaftueshëm; dhe
- m) përdorimin e ujit (përfshirë ato në lidhje me tërheqjen e ujit dhe uljen e nivelit të ujit), si dhe lejet për trajtimin e mbetjeve ujore.

28.3 Për qëllime të periudhës kohore të specifikuar në nenin 28.2, nëse një leje shtetërore, në bazë të ligjit shqiptar, duhet të merret nga Këshilli i Ujësijellësit ose Këshilli Kombëtar i Ujërave, periudha kohore përkatëse do të përshkruhet nga ligji shqiptar, ose, nëse nuk është përshkruar një periudhë e tillë, jo më vonë se 30 ditë nga mbledhja e Këshillit të Ujësijellësit ose Këshillit Kombëtar të Ujërave (sipas rastit), këto mbledhje duhet të zhvillohen në një interval kohor jo më të gjatë se 90 ditë.



28.4 Shteti, me kërkesë të një pjesëmarrësi në Projekt dhe në masën që është praktikisht e arsyeshme, do të përpiqet ose do të bëjë të mundur që autoriteti shtetëror ose autoriteti i pavarur përkatës, të përpiqet që të përmbledhë leje të shumëfishta shtetërore në një leje shtetërore të vetme, atje ku këto leje të shumëfishta shtetërore lidhen me një çështje të njëjtë ose të ngjashme.

28.5 Pa paragjykuar nenin 28.2, me masën që një pjesëmarrës në Projekt ka dorëzuar një aplikim për leje shtetërore përpara datës efektive, Shteti do të fillojë ose do të mundësojë që autoriteti shtetëror ose autoriteti i pavarur përkatës të fillojë rishikimin e këtij aplikimi, me qëllim dhënien e lejes shtetërore sa më shpejt të jetë e mundur pas datës efektive.

28.6 Në lidhje me të gjitha lejet e zhvillimit, ndërtimit dhe lejet e infrastrukturës:

a) Shteti konfirmon se Investitorit të Projektit do t'i kërkohej të adresojë aplikimet për këto leje te METE, si lëshuesi i lejes së infrastrukturës dhe jo te ndonjë autoritet lokal;

b) Shteti garanton se asnjë autoritet lokal nuk do të ketë kompetenca ose autoritet për sa u takon këtyre lejeve që lidhen me aktivitetet e Projektit;

c) pranohet se disa leje të tilla do të kërkohej për aktivitetet e Projektit dhe se këto leje do të kërkohej në kohë të ndryshme (për shembull, por pa u kufizuar në sa vijon, këto leje do të kërkohej për ndërtimin e rrugëve hyrëse për qëllime të punëve fillestare menjëherë pas datës efektive);

d) pranohet se leje të tilla mund t'i jepen Investitorit të Projektit sipas ligjit nr. 10 119, datë 23 prill 2009 "Për planifikimin e territorit", pavarësisht se Investitori i Projektit nuk do të kryejë vetë punimet e ndërtimit. Investitori i Projektit do të kontraktojë për kryerjen e këtyre punimeve vetëm persona, të cilët zotërojnë një licencë të tillë, kur kjo licencë kërkohej nga ligji;

e) Shteti do të garantojë dhe do të mundësojë që autoritetet shtetërore të sigurojnë që licencat dhe lejet e dhëna sipas ligjit nr. 10 119, datë 23 prill 2009 "Për planifikimin e territorit", t'i jepen Investitorit të Projektit dhe jo ndonjë personi tjetër, përveç rastit kur Investitori i Projekti në mënyrë specifike njofton Shtetin se dëshiron që leja në fjalë t'i jepet një personi tjetër;

f) pavarësisht nga ligji nr. 10 119, datë 23 prill 2009 "Për planifikimin e territorit" dhe ndonjë akti nënligjor përkatës, këto leje mund t'i jepen Investitorit të Projektit, pavarësisht se në kohën kur kërkohej leja, nuk ka të drejtat përkatëse në lidhje me aktivitetet, të cilat janë subjekt i lejes në fjalë;

g) për qëllim të ligjit nr. 10 119, datë 23 prill 2009 "Për planifikimin e territorit", vendndodhja e infrastrukturës shqiptare në Korridorin e Interesit (si përcaktohet në pjesën 1 të shtojcës 1, së bashku me ndonjë ndryshim të mëpasshëm, në Korridorin e Interesit të përcaktuar nga 6.1 (b) (iii) i pjesës 1), përbën pjesë të një plani sektorial kombëtar dhe për këtë arsye kërkesa për një plan sektorial kombëtar sipas këtij ligji është plotësuar për qëllimin e lëshimit të këtyre lejeve; dhe

h) kuptohet që Investitori i Projektit do të paraqesë dokumentet përkatëse të nevojshme, sipas dispozitave të ligjit nr. 9385, datë 4 maj 2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9693, datë 19 mars 2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, dhe më pas aplikimi i Investitorit të Projektit do të shqyrtohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkesat e parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 9385, datë 4 maj 2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të cilat parashikojnë kushtet për heqjen e pyjeve nga regjistri kadastral kombëtar dhe të hapësirave pyjore, të përmasave nga 10 hektar deri në 100 hektar, nga fondi kombëtar i pyjeve, me miratimin e Këshillit të Ministrave dhe për hapësira pyjore mbi 100 hektarë me miratimin e Parlamentit të Shtetit, të zbatueshme nga administrata e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

29. PËRJASHTIMET RREGULLATORE

29.1 Shteti njeh, garanton dhe pranon që:

a) vlefshmëria e vazhdueshme e përjashtimeve rregullatore, me marrjen e tyre, në lidhje me infrastrukturën shqiptare nuk do të ndikohet, në ndonjë formë, nga ushtrimi i mëpasshëm i kompetencave përkatëse të ERE-s, sa i përket realizimi të detyrave në lidhje me nenet 9, 10, 11 të 2680

direktivës 2009/73 të Bashkimit Europian, siç zbatohet në ligjin shqiptar;

b) përjashtimet rregullatore, me marrjen e tyre, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme në lidhje me infrastrukturën shqiptare deri në datën e skadimit të tyre dhe pavarësisht hyrjes në fuqi të çdo direktive që shfuqizon direktivën 2003/55 të Bashkimit Europian;

c) në çdo rast, as përjashtimet rregullatore me marrjen e tyre, as objekti i tyre, në lidhje me infrastrukturën shqiptare, nuk mund të ndryshohen nga asnjë palë shtetërore ose autoritet i pavarur, në dëm të Investitorit të Projektit, përveç për sa është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me ligjin përkatës të Bashkimit Europian, i cili hyn në fuqi pas datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

d) në bazë të nenit 11 (3) (b) të direktivës 2009/73 të Bashkimit Europian, dhënia e certifikimit, të referuar në nenin 10 të kësaj direktive, nuk do të vërë në rrezik sigurinë e furnizimit të Republikës së Shqipërisë ose të Komunitetit dhe se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenin 11 (3) (b) (i) deri te (iii) (përfshirë) janë marrë rregullisht në konsideratë. Shteti garanton se do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të arritur dhe siguruar përputhshmërinë e mëposhme me opinionet e dhëna nga Komisioni, siç parashikohet në këto nene 10 dhe 11.

29.2 Shteti do të bashkëpunojë dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të mundësojë që autoritetet e pavarura përkatëse të bashkëpunojnë, me rregullatorët përkatës në Republikën e Greqisë dhe Republikën e Italisë, si dhe me autoritetet përkatëse europiane, për të siguruar që përjashtimet rregullatore të qëndrojnë në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes.

29.3 Me kërkesën e Investitorit të Projektit, Shteti do të bashkëpunojë dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të mundësojë që autoriteti i pavarur përkatës të bashkëpunojnë, me rregullatorët përkatës në Republikën e Greqisë dhe Republikën e Italisë, si dhe me autoritetet përkatëse europiane, në lidhje me marrjen e përjashtimeve rregullatore, ose ndonjë shtesë ose zëvendësim të përjashtimeve rregullatore, të cilat mund të kërkohen nga Investitori i Projektit, përfshirë dhe ndonjë përjashtim rregullator në lidhje me zgjerimin e Sistemit të Gazsjellësit.

29.4 Shteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar marrjen në shqyrtim në kohë, të çdo aplikimi për ndonjë ndryshim të përjashtimeve rregullatore, ose ndonjë shtesë apo zëvendësim të përjashtimeve rregullatore sipas ligjit shqiptar ose ndryshe në territorin shqiptar, të cilat mund të kërkohen nga Investitori i Projektit herë pas herë.

PËRGJEGJËSITË

30. PËRGJEGJËSIA E INVESTITORIT TË PROJEKTIT

30.1 Sipas nenit 30.2, 30.3 dhe 30.4 dhe pa paragjykuar të drejtën e Shtetit të kërkojë përmbushje të plotë nga Investitori i Projektit të detyrimeve të Investitorit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje apo çdo marrëveshjeje të Projektit, Investitori i Projektit do të jetë përgjegjës kundrejt Shtetit për çdo humbje ose dëm të shkaktuar nga, ose që rrjedh nga shkelja nga Investitori i Projektit të detyrimeve të tij në këtë Marrëveshjeje.

30.2 Investitori i Projektit nuk do të ketë përgjegjësi sipas nenit 30.1, nëse dhe në masën që humbja apo dëmi është shkaktuar ose rrjedh nga:

a) shkelja nga Shteti ose çdo palë shtetërore e ndonjë detyre, apo detyrimi që lind nga kjo Marrëveshjeje apo çdo marrëveshjeje e Projektit; ose

b) çdo veprim apo mosveprim i ndonjë autoriteti lokal ose autoriteti të pavarur, i cili do të ishte një shkelje e detyrave apo detyrimeve që lindin nga kjo Marrëveshjeje apo çdo Marrëveshjeje e Projektit, nëse ky autoritet lokal, ose autoritet i pavarur, do të ishte një autoritet shtetëror; ose

c) çdo shkelje e ligjit shqiptar nga palët shtetërore, autoritetet e pavarura, ose autoritet lokale.

30.3 Investitori i Projektit nuk do të ketë përgjegjësi kundrejt Shtetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga ose në lidhje me çlirimin e gazit natyror nga Sistemi i Gazsjellësit ose për humbjet dhe dëmet që lindin nga ose në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër, e cila shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm material në ambient, ose rrezik për shëndetin dhe sigurinë, nëse, me gjithë ekzistencën e standardeve të përshtatshme të sigurisë sipas nenit 18, dëmi ose humbja ishte:



a) rezultati i një veprimi lidhur me një konflikt të armatosur, armiqësi, luftë civile apo kryengritje;

b) rezultati i një fenomeni natyror apo të veçantë, të pashmangshëm, të paparashikueshëm dhe me karakter të papërballueshëm;

c) rezultat i pajtueshmërisë me një masë të detyrueshme të ndonjë pale shtetërore, autoriteti të pavarur ose autoriteti lokal;

d) rezultat i ngjarjeve të parashikuara në paragrafin e fundit të nenit 14.1.

30.4 Çdo shpërblim ose pretendim për pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet nga Investitori i Projektit brenda ose përpara [30] ditëve nga marrja e vendimit përkatës ose pretendimit të pakundërshtuar për pagesë.

30.5 Çdo dëmshpërblim monetar i pagueshëm nga Investitori i Projektit të Shteti, sipas këtij neni 30, nëse kërkohet nga Shteti, do të paguhet në monedhën e konvertueshme të përcaktuar nga Shteti.

30.6 Investitori i Projektit nuk do të jetë përgjegjës kundrejt Shtetit apo ndonjë pale shtetërore për dëme ndëshkuese ose shembullore.

30.7 Sipas neneve 30.8 dhe 30.9, përveç kur duhet të bëhet një zbritje ose ndalesë në bazë të ndonjë ligji të zbatueshëm, çdo pagesë për t'u bërë nga Investitori i Projektit, sipas kësaj ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet pa zbritje për ose për llogari të çdo kompensimi, kundërpadie, zbritje ose ndalesë të çfarëdolloj natyre dhe pavarësisht se nga kush është vendosur.

30.8 Nëse ndonjë formë zbritjeje ose ndalesë nga pagesa është e detyrueshme për t'u mbajtur, për shkak të një ligji tjetër, të ndryshëm nga ligji shqiptar, Investitori i Projektit do të paguajë shumën shtesë të nevojshme për të siguruar që Shteti do të marrë një shumë neto të barabartë me shumën e plotë që ai do të kishte marrë, nëse pagesa do të ishte bërë pa zbritje ose ndalesa.

30.9 Pa paragjykuar asnjë pretendim që Investitori i Projektit mund të ketë në dispozicion sipas kësaj ose në lidhje me këtë Marrëveshje, Investitori i Projektit do të ketë të drejtë të zbresë çdo shumë TVSH-je të detyrueshme për rimbursim për të nga çdo shumë të parashikuar për çdo taksë të detyrueshme dhe të pagueshme nga Investitori i Projektit të çdo palë shtetërore.

30.10 Shteti nuk do të ketë të drejtën të kërkojë apo të deklarojë ndonjë anulim apo përfundim të kësaj Marrëveshjeje apo të ndonjë marrëveshjeje të Projektit, të cilën ka nënshkruar për shkak të shkeljes nga Investitori i Projektit apo ndonjë pjesëmarrës tjetër në Projekt, përveçse në përputhje me dispozitat e nenit 43.

31. PËRGJEGJËSIA E SHTETIT

31.1 Pa paragjykuar të drejtat e Investitorit të Projektit për të kërkuar përmbushje të plotë nga Shteti ose nga ndonjë palë tjetër shtetërore të detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje apo çdo marrëveshjeje të Projektit dhe pa paragjykuar ndonjë dispozitë të Marrëveshjes që parashikon një metodologji të veçantë për përlllogaritjen e kompensimit në rrethana të veçanta (përfshirë rastet në lidhje me ndryshimet në ligj ose shpronësimin), Shteti do të ofrojë kompensim monetar për çdo humbje ose dëm që i është shkaktuar Investitorit të Projektit, që është shkaktuar ose rrjedh nga:

a) çdo dështim i Shtetit ose i ndonjë pale shtetërore, qoftë si rezultat i veprimit ose mosveprimit, për të përmbushur plotësisht detyrimet në këtë Marrëveshje apo në ndonjë marrëveshje të Projektit apo në ligjin shqiptar të ndryshuar sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) çdo deklaram i pavërtetë nga Shteti apo ndonjë palë shtetërore në këtë Marrëveshje ose në ndonjë marrëveshje të Projektit; ose

c) çdo shkelje e detyrimeve ose shkelja e ndonjë ligji shqiptar nga Shteti ose ndonjë palë tjetër shtetërore;

31.2 Shteti nuk do të jetë përgjegjës sipas nenit 31.1, nëse dhe në masën që humbja ose dëmi është shkaktuar ose rrjedh nga shkelja nga Investitori i Projektit të detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje apo ndonjë marrëveshje të Projektit, ose sipas ligjit shqiptar të ndryshuar sipas kësaj

Marrëveshjeje.

31.3 Pa kufizuar nenin 31.1, Shteti do të zhdëmtojë pjesëmarrësit në Projekt për përgjegjësinë kundrejt palëve të treta për humbje apo dëm të shkaktuar, nga ose në lidhje me çlirimin e gazit natyror nga Sistemi i Gazsjellësit ose për humbje ose dëm të shkaktuara nga ose në lidhje me një ngjarje tjetër, e cila shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm material në ambient ose rrezik për shëndetin dhe sigurinë, nëse, me gjithë ekzistencën e standardeve të përshtatshme të sigurisë sipas nenit 18, dëmi ose humbja ishte:

a) rezultati i një veprimi lidhur me një konflikt të armatosur, armiqësi, luftë civile apo kryengritje në territorin shqiptar, në masën që është shkaktuar apo provokuar nga një palë shtetërore;

b) rezultat i pajtueshmërisë me një masë të detyrueshme të Shtetit, ndonjë palë shtetërore, autoritet i pavarur ose ndonjë autoritet lokal.

31.4 Çdo vendim ose kërkesë për pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet nga Shteti në ose pa kaluar 180 ditë nga marrja e vendimit ose të kërkesës së pakundërshtuar për pagesë.

31.5 Gjithë kompensimet monetare të pagueshme nga Shteti sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kërkohet nga Investitori i Projektit, do të paguhet në monedhën e konvertueshme, të përcaktuar nga Investitori i Projektit.

31.6 Shteti nuk do të jetë përgjegjës kundrejt Investitorit të Projektit për dëme ndëshkuese ose shembullore.

31.7 Sipas nenit 31.8, përveç se kur një zbritje ose mbajtje duhet të kryhet sipas ligjit të zbatueshëm, çdo pagesë që bëhet nga Shteti për ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet pa zbritje për, ose në lidhje me taksa aktuale ose të ardhshme, detyrime, rëndesa, tarifa, rregullime, kundërpretendime, mbajtje dhe zbritje të tjera të çfarëdo natyre dhe çfarëdo autoriteti që i cakton ato.

31.8 Nëse ndonjë formë zbritje apo mbajtjeje nga ndonjë pagesë duhet bërë për shkak të ndonjë ligji (duke përfshirë ligjin shqiptar) ose nëse ndonjë shumë e paguar (përfshirë pagimin e ndonjë interesi) është objekt i ligjit shqiptar mbi tatimin mbi të ardhurat, Shteti do ta paguajë atë shumë shtesë që është e nevojshme për të garantuar që pritësi i kësaj pagese do të marrë dhe ka të drejtë të mbajë një shumë neto të barabartë me shumën e plotë që do të merrte dhe që do të kishte pasur të drejtë të mbante nëse pagesa do të ishte bërë pa zbritje ose mbajtje dhe nuk do të ishte objekt i ligjit shqiptar mbi tatimin mbi të ardhurat.

31.9 Pa paragjykuar nenin 43, Investitori i Projektit nuk do të ketë të drejtën të kërkojë ose të deklarojë ndonjë anulim apo përfundim të kësaj Marrëveshjeje si rezultat i ndonjë shkeljeje të kësaj Marrëveshjeje nga ndonjë palë shtetërore.

32. NDRYSHIMI I LIGJIT

32.1 Njoftimet e hershme të ndryshimit të ligjit

a) Nëse ndonjë nga Palët merr dijeni për ndonjë fakt apo rrethanë që me një opinion të arsyeshëm krijon ose në mënyrë të arsyeshme konsiderohet se mund të krijojë në të ardhmen një ndryshim të ligjit, që mund të sjellë si rezultat një kompensim të pagueshëm ndaj tij, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet menjëherë të njoftojë Palën tjetër për këtë fakt apo rrethanë së bashku me detajet e arsyeshme të këtij fakti apo kësaj rrethane që janë brenda kufijve të njohurive të Palës në fjalë.

b) Sapo të jetë praktikisht e mundur, pasi njëra nga Palët ka njoftuar Palën tjetër në përputhje me nenin 32.1 (a), Investitori i Projektit do të njoftojë Shtetin, bazuar në njohuritë e tij të faktit apo të rrethanës, nëse e konsideron se ky fakt apo kjo rrethanë do të krijojte një ndryshim të ligjit sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse do të krijohej ky ndryshim, shumën e mundshme të kompensimit që mund të paguhej nga Shteti si rezultat i ndryshimit të ligjit (nëse do të ishte rasti), shumën e kursimeve që mund të krijohej si rezultat i ndryshimit të ligjit. Këto njoftime do të jenë thjesht informuese dhe nuk do të detyrojnë, apo ndryshe kufizojnë të drejtat e Investitorit të Projektit



dhe çdo pjesëmarrësi në Projekt, sipas kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë mënyrë tjetër.

c) Me kërkesën e Shtetit, Shteti (ose ndonjë palë shtetërore, autoritet lokal ose autoritet i pavarur, si mund të caktohet nga Shteti) dhe Investitori i Projektit do të takohen në një vend dhe kohë të pranuar nga të dy, për të diskutuar mbi faktet ose rrethanat përkatëse që mund të krijojnë një ndryshim të ligjit dhe propozimin për të vazhduar më tej.

32.2 Ndryshime të ligjit që çojnë në humbje ose dëme

a) Nëse ndonjë ndryshim i ligjit do të ketë efekt cenues, kundërshtues apo ndërhyrës në zbatimin e Projektit, ose që do të kufizojë, do të shkurtojë ose do të ndikojë negativisht në vlerën e Projektit ose ndonjë nga të drejtat, zhdëmtimet ose mbrojtjet e garantuara ose që lindin nga kjo Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje e Projektit, ose që krijon në mënyrë të drejtpërdrejtë dëme ose humbje të tjera për Investitorin e Projektit, Investitori i Projektit, brenda një viti nga data kur me kujdesin e duhur mund të vihej në dijeni për efektin mbi projektin të ndryshimit të ligjit, do të njoftojë me shkrim Shtetin.

b) Bazuar në paragrafin (c) më poshtë Shteti do të kompensojë Investitorin e Projektit për humbjet ose dëmet e pësuar nga ai Investitor i Projektit si rezultat i ndryshimit të ligjit. Ky kompensim, nëse kërkohet nga Investitori i Projektit në fjalë, do të paguhet në monedhën e konvertueshme të caktuar nga Investitori i Projektit dhe do të marrë formën si vijon:

i) në masën që ndryshimi i ligjit krijon (drejtpërdrejt ose jo) ndonjë humbje apo dëm që kërkon shpenzime kapitale, Shteti do t'ia kompensojë këtë humbje ose dëm Investitorit të Projektit, menjëherë pas kërkesës me shkrim të Investitorit të Projektit; dhe

ii) në masën që ndryshimi i ligjit krijon ndonjë humbje apo dëm që nuk kërkon shpenzime kapitale, Shteti do t'i rimbursojë Investitorit të Projektit një shumë që kompenson Investitorin e Projektit për humbje dhe dëme, sipas zgjedhjes së Investitorit të Projektit:

A. Menjëherë në një shumë, nëse Investitori i Projektit është i aftë të përlllogarisë mbi baza të arsyeshme, humbjen ose dëmin që ka pësuar ose që mund të pësojë Investitori i Projektit gjatë kohëzgjatjes së Projektit dhe t'i japë Shtetit prova të arsyeshme për bazën e këtyre llogaritjeve;

B. Në formën e paradhënies së pagesave vjetore tek Investitori i Projektit gjatë pjesës së mbetur të kohëzgjatjes së Projektit, ku shumat e këtyre pagesave do të rregullohet në mënyrë të përvitshme, në mënyrë që të reflektojë humbjet ose dëmet aktuale që janë shkaktuar nga ndryshimi i ligjit; ose

C. Në mënyrë të vazhdueshme, menjëherë kur pësohen këto humbje ose dëme.

c) Kur llogaritet shumata e kompensimit, që kërkohet të paguhet nga Shteti në lidhje me humbje ose dëme të krijuara nga një rritje e taksave shqiptare të pagueshme në lidhje me selitë e përhershme të Investitorit të Projektit në Shqipëri për çdo vit financiar, Shteti do të zbrisë një sasi të kursimeve tatimore (deri në masën e rritjes në fjalë) në lidhje me vitin fiskal përkatës. Investitori i Projektit nuk mund të zgjedhë të kompensohet nëpërmjet secilës nga mënyrat e pacaktuara në nënparagrafët A ose B të paragrafit (b) (ii) më lart, por do të kompensohet sipas mënyrës së përcaktuar në nënparagrafin C të paragrafit (b) (ii) më lart.

32.3 Ndryshime të ligjit që çojnë në kursime

Nëse si rezultat i një ndryshimi të ligjit, Investitori i Projektit është i aftë të realizojë kursime në lidhje me Projektin dhe Investitori i Projektit (në gjykimin e tij) realizon faktikisht kursime, atëherë Investitori i Projektit, nëse do të kërkohet me shkrim nga Shteti (kjo kërkesë do të bëhet jo më vonë se një vit nga data që ka ndodhur ndryshimi përkatës i ligjit), do të kompensojë Shtetin me:

a) gjysmën e shumës së këtyre kursimeve; ose

b) nëse:

i) kursimet janë kursime tatimore, të cilat nuk janë zbritur në bazë të paragrafit (c) të nenit 32.2; dhe

ii) në masën që mbetet një shumë kompensimi tatimor e parimbursuar (por vetëm deri në këtë masë),

të gjithë shumën e këtyre kursimeve.

Ky kompensim, nëse Shteti e kërkon, do të paguhet në monedhën e konvertueshme dhe sipas gjykimit të Investitorit të Projektit do të jetë në formën e:

A. Rimbursimit të Shtetit për gjysmën e kursimeve (ose nëse zbatohet paragrafi (b) më sipër, të gjithë shumën e kursimeve) të realizuara nga Investitori i Projektit si një rezultat i ndryshimit të ligjit, menjëherë pasi këto kursime janë realizuar; ose

B. Përveçse në rastin e kursimeve tatimore, rimbursimi të Shteti i gjysmës së kursimeve të realizuara nga Investitori i Projektit si rezultat i ndryshimit të ligjit, në formën e pagesave të barabarta vjetore ndaj Shtetit gjatë pjesës së mbetur të kohëzgjatjes së pritshme të Projektit. Në këtë rast, këto pagesa do të rëndohen me interes me normën e rënë dakord të interesit. Ky interes do të zbatohet nga data(t) kur këto kursime janë realizuar nga Investitori i Projektit deri në datën/datat kur janë kryer pagesat ndaj Shtetit.

Në këtë nen 32.3:

“Shumë kompensimi tatimor e parimbursuar” do të thotë, në çdo kohë, shuma nga e cila:

x) shuma e përgjithshme e pagesave të kryera nga Shteti në bazë të nenit 32.2 në lidhje me humbje ose dëme të krijuara nga ndonjë rritje e taksave shqiptare, të pagueshme në lidhje me selitë e përhershme të Investitorit të Projektit në Shqipëri; tejkalon

y) shumën e përgjithshme të kursimeve tatimore, që janë zbritur në bazë të paragrafit (c) të nenit 32.2 ose i janë rimbursuar Shtetit në bazë të këtij neni 32.3.

32.4 Kufiri i kompensimit për ndryshimin e ligjit

a) Asnjë nga Palët nuk do të detyrohet t’i paguajë Palës tjetër kompensim sipas nenit 32.2 ose 32.3 (sipas rastit) në një vit kalendarik, përveç kur shuma totale e humbjeve ose dëmeve që rezulton nga të gjitha ndryshimet në ligj, që kanë ndodhur gjatë atij viti kalendarik, tejkalon shumën 250,000 euro.

b) Nëse në një vit kalendarik ndryshimi i ligjit krijon pretendime që në total tejkalojnë shumën 250,000 euro, Pala, e cila është e detyruar të paguajë kompensimin sipas nenit 32.2 ose 32.3 (sipas rastit) do ta paguajë plotësisht kompensimin dhe për të shmangur çdo dyshim, kompensimi nuk do të jetë objekt i ndonjë zbritjeje për kufirin prej 250,000 eurosh të pretendimeve.

32.5 Kufizimi i pretendimeve në lidhje me ndryshimin e ligjit

a) Sipas nenit 32.5 (b), duke filluar nga përvjetori i njëzetepestë i datës efektive:

i) të drejtat dhe detyrimet e Shtetit dhe të Investitorit të Projektit në lidhje me ndryshimin e ligjit si përcaktohen në këtë nen 32, do të kufizohen vetëm në ndryshimet diskriminuese të ligjit; dhe

ii) kufiri i pretendimeve, i përmendur në nenin 32.4, do të jetë 500,000 euro.

b) Neni 32.5 (a) nuk do të kufizojë të drejtat dhe detyrimet e Shtetit dhe të Investitorit të Projektit në lidhje me ndryshimin e ligjit, të cilat lindin para përvjetorit të njëzetepestë të datës efektive.

33. SHPRONËSIMI

33.1 Asnjë investim i zotëruar apo që gëzohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, nga një pjesëmarrës në Projekt në lidhje me Projektin, nuk do të shpronësohet, përveç kur ky shpronësim është:

a) për një qëllim publik;

b) jodiskriminues;

c) i kryer sipas një procesi të rregullt ligjor; dhe

d) i shoqëruar me pagesë të menjëhershme, të përshtatshme dhe të efektshme të kompensimit, i cili nuk do të jetë më i vogël sesa është përcaktuar në këtë nen 33.

33.2 Sipas nenit 33.3, kompensimi i pagueshëm të çdo pjesëmarrës në Projekt, përveç se transportuesve (në cilësinë e tyre si transportues) ose shitësve të gazit (në cilësinë e tyre si shitës



gazi) në rastin e shpronësimit të një investimi të këtij pjesëmarrësi në Projekt nuk do të jetë më pak se vlera e drejtë e tregut të investimit të shpronësuar, e llogaritur në kohën menjëherë para se shpronësimi ose shpronësimi i afërt të bëhet i njohur në një mënyrë që ndikonte në vlerën e investimit.

33.3 Kompensimi i pagueshëm tek Investitori i Projektit pas shpronësimit të një pjese thelbësore apo gjithë investimit të Investitorit të Projektit në territorin shqiptar, në asnjë rast nuk do të jetë më i ulët se shuma e:

a) gjithë shumave të pagueshme nga Investitori i Projektit, sipas ndonjë kontrate zbatimi, përfshirë kontratat e zbatimit me huadhënësit;

b) të gjithë shumën e kapitalit apo borxhit të varur të investuar tek Investitori i Projektit nga një person që zotëron ndonjë formë të drejtpërdrejtë apo jo kapitali, apo interesi tjetër pasuror tek Investitori i Projektit, në masën që ky kapital apo borxh i varur nuk u është riparuar këtyre personave;

c) një shume të barabartë me vlerën aktuale neto të arkëtimit në kapital që do të kishin realizuar këta persona që zotërojnë ndonjë formë të drejtpërdrejtë apo jo, kapitalin apo interes pasuror tek Investitori i Projektit, në rast se shpronësimi nuk do të kishte ndodhur; dhe

d) humbjet dhe dëmet e tjera që janë shkaktuar drejtpërdrejt nga shpronësimi.

33.4 Në rast të shpronësimit nga Shteti apo ndonjë autoritet shtetëror, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo u shkakton humbje ose dëme transportuesve (në cilësinë e tyre si transportues) ose shitësve të gazit (në cilësinë e tyre si shitës gazi), Shteti do t'i paguajë atij transportuesi apo shitësi të gazit (sipas rastit) kompensim në shumën që kompenson tërësisht transportuesin apo shitësin e gazit (sipas rastit) për atë humbje ose dëm.

33.5 Kompensimi sipas këtij neni 33, me kërkesën e pjesëmarrësit përkatës në Projekt, duhet të shprehet dhe të jetë i pagueshëm në monedhën e konvertueshme të caktuar nga pjesëmarrësi në Projektin në fjalë. Pavarësisht nga neni 42, kompensimi do të përfshijë, gjithashtu, interesin në normën e miratuar të interesit, të llogaritur në bazë ditore dhe të shtuar, në mënyrë të përmuajshme nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës.

33.6 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë nen, mund të paraqitet nga pjesëmarrësi përkatës në Projekt (ose secili prej tyre) për zgjidhje sipas nenit 37 (nen në të cilin për qëllim të mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë nen çdo referencë në përkufizimin “Palë” do të lexohet dhe do të ketë kuptimin “Pjesëmarrës në Projekt”). Për të shmangur çdo dyshim, neni 26 (3) (b) (i) dhe (c) i Traktatit të Kartës së Energjisë, nuk do të zbatohet midis palëve dhe pjesëmarrësve në Projekt në lidhje me këto mosmarrëveshje.

34. PËRGJEGJËSIA NDAJ PALËVE TË TRETA

Sipas nenit 49.2, asgjë në këtë Marrëveshje:

a) nuk do të krijojë të drejta ose përgjegjësi kontraktore ose sipas ligjit shqiptar, në bazë të të cilave palët e treta (përveç ndonjë pjesëmarrësi në projekt, që është një palë e tretë në këtë Marrëveshje), mund të paraqesin pretendime kundër Shtetit, palëve shtetërore, autoriteteve lokale ose ndonjë pjesëmarrësi në Projekt; ose

b) nuk do të ndikojë ose në mënyrë tjetër ndryshojë të drejtat e Palëve kundrejt palëve të treta dhe të drejtat e palëve të treta kundrejt Palëve sipas ligjit shqiptar.

35. FORCA MADHORE

35.1 Mospërbushja ose vonesa në përmbushje të pjesës së secilës nga Palët në lidhje me një detyrim ose një pjesë të tij në këtë Marrëveshje, përveç kur është një detyrim për pagesë, do të pezullohet në masën që është shkaktuar nga Forca Madhore.

35.2 “Forca Madhore” në lidhje me një Palë, do të kufizohet vetëm në ngjarjet në vijim:

a) fatkeqësi natyrore (tërmete, shkarje toke, ciklone, përmytje, zjarre, rrufe, dallgë deti, shpërthime vullkani dhe ngjarje të tjera të ngjashme natyrore);

b) luftërat civile dhe luftërat (të deklaruara ose jo) midis shteteve sovrane, por kur ajo Palë është Shteti, vetëm nëse Republika e Shqipërisë nuk ka filluar luftë sipas parimeve të ligjit ndërkombëtar; dhe

c) embargo ndërkombëtare kundër shteteve sovrane, por kur ajo Palë është Shteti, vetëm nëse embargo nuk është kundër Republikës së Shqipërisë; dhe

d) kur ajo Palë është Investitori i Projektit, rebelimi civil ose kryengritjet, grevat dhe mosmarrëveshjet e tjera të punës, të cilat nuk kufizohen në punonjësit e pjesëmarrësve në Projekt, rebelime, akte terrorizmi, embargo ndërkombëtare, pamundësi për të marrë mallrat, materialet, shërbimet ose teknologjinë, pamundësi për të gjetur ose për të mbajtur mjete të nevojshme transporti, zbatimi i ligjeve, i marrëveshjeve ndërkombëtare, i rregullave, i rregulloreve dhe i dekreteve, veprime dhe mosveprime të Palëve Shtetërore ose autoriteteve lokale ose autoriteteve të pavarura,

dhe që në çdo rast, rrethanat e veçanta dhe ndonjë rezultat që e pengon përmbushjen e kërkesave të aktiviteteve të projektit nga Pala ose detyrimet e asaj Pale, ose të një pjese të tyre, nuk do të trajtohen si Forcë Madhore, përveç kur:

i) kapërcejnë kontrollin e tyre të arsyeshëm; dhe

ii) kur rrethanat që janë logjistikisht të parashikueshme, të mos jenë shkaktuar apo në krijimin e tyre të mos ketë kontribuar neglizhenca e tij apo e ndonjë personi lidhur me të ose nga shkelja prej tij (ose nga personat e lidhur me të) të kësaj Marrëveshjeje apo çdo marrëveshjeje të Projektit.

Për qëllim të këtij neni 35.2, "Personat e lidhur" me një Palë janë:

A. Në rastin e Shtetit, çdo Palë tjetër Shtetërore, autoritetet lokale ose autoriteti i pavarur; dhe

B. Në rastin e Investitorit të Projektit, çdo Pjesëmarrës tjetër në Projekt.

35.3 Nëse një Palë pengohet në përmbushjen e disa prej detyrimeve të saj në këtë Marrëveshje ose të një pjese të tyre (përveç detyrimit për pagesë), si rezultat i Forcës Madhore do të njoftojë menjëherë me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet:

a) të specifikojë detyrimet ose pjesën e detyrimeve që kjo Palë nuk mund të përmbushë;

b) të përshkruajë plotësisht ngjarjen e Forcës Madhore;

c) të bëjë vlerësimin e kohës gjatë së cilës ngjarja e Forcës Madhore dhe efektet e saj do të vazhdojnë; dhe

d) të specifikojë masat e propozuara për t'u marrë prej tij (ose tyre), për të rregulluar ose për të zvogëluar ngjarjen e Forcës Madhore.

Pas këtij njoftimi, për aq kohë sa do të vazhdojë Forca Madhore, detyrimet e palëve, të cilat nuk mund të përmbushen për shkak të Forcës Madhore, përveç detyrimit për pagesë, do të pezullohen.

35.4 Çdo Palë që pengohet në përmbushjen e detyrimeve ose një pjesë të tyre (përveç detyrimit për pagesë), si rezultat i Forcës Madhore do të ndërmarrë ato veprime që janë në dispozicion të saj dhe do të shpenzojë fondet e nevojshme për të rregulluar Forcën Madhore dhe për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve të pezulluara sa më parë që të jetë praktikisht e mundur.

35.5 Kur Shteti pengohet në përmbushjen e detyrimeve ose një pjese të tyre (përveç detyrimit për pagesë), si rezultat i Forcës Madhore, do të ndërmarrë dhe do të mundësojë që Palët Shtetërore përkatëse të ndërmarrin ato veprime që janë në dispozicion të tyre për të zvogëluar çdo humbje që Investitori i Projektit dhe pjesëmarrësit e tjerë në Projekt kanë pësuar gjatë vazhdimin të Forcës Madhore dhe si rezultat i saj.

35.6 Kur Investitori i Projektit pengohet në përmbushjen e detyrimeve ose një pjese të tyre (përveç detyrimit për pagesë), si rezultat i Forcës Madhore, do të ndërmarrë ato veprime që janë në dispozicion të tij për të zvogëluar çdo humbje që Palët Shtetërore kanë pësuar gjatë vazhdimin të Forcës Madhore dhe si rezultat i saj.



35.7 Asnjë dispozitë e ligjit shqiptar nuk do të përdoret për t'i dhënë asnjërës nga Palët një dëmshpërblim më të madh apo çlirim nga përgjegjësitë dhe/ose detyrimet e saj në çdo rrethanë që është jashtë kontrollit të asaj Pale, përveç dëmshpërblimit apo çlirim nga përgjegjësitë dhe/ose detyrimet e tij të përcaktuara me këtë Marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

36. HEQJA DORË NGA IMUNITETI

a) Në bazë të paragrafit (b) më poshtë, në masën e lejuar nga ligji shqiptar, në emër dhe për llogari të vet dhe në emër dhe për llogari të çdo Pale tjetër Shtetërore, Shteti në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar:

i) pranon juridiksionin e gjykatave angleze, gjykatave shqiptare dhe gjykatave të çdo juridiksioni tjetër në lidhje me njohjen e çdo vendimi apo urdhri të gjykatave angleze, gjykatave shqiptare dhe gjykatave të çdo juridiksioni tjetër, në mbështetje të një vendimi të arbitrazhit në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje dhe në lidhje me njohjen e ndonjë vendimi të arbitrazhit, dhe heq dorë e bie dakord të mos kërkojë imunitet sovran ose ndonjë lloj tjetër imuniteti nga juridiksioni i gjykatave angleze, gjykatave shqiptare dhe gjykatave të çdo juridiksioni tjetër, në lidhje me njohjen e çdo vendimi apo urdhri të gjykatës apo vendim të arbitrazhit dhe bie dakord të garantojë që asnjë kërkesë e tillë të mos bëhet në emër dhe për llogari të Shtetit;

ii) pranon ekzekutimin e çdo urdhri apo vendimi në mbështetje të arbitrazhit apo të ndonjë vendimi të dhënë në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje dhe dhënien e çdo dëmshpërblimi në gjykatat angleze, gjykatat shqiptare dhe gjykatat e çdo juridiksioni tjetër, përpara ose pas dhënies së vendimit përfundimtar të arbitrazhit përfshirë:

A. Dëmshpërblim me vendim të ndërmjetëm ose përfundimtar, ose urdhër për kryerjen e veprimeve të veçanta, ose për rimarrjen e ndonjë pasurie;

B. Ngrirjen e aktiveve të tij; dhe

C. Ekzekutimin kundrejt çdo pasurie, të ardhurash apo aktiveve të tjera (pavarësisht për çfarë përdoren apo synohen të përdoren); dhe

iii) heq dorë dhe bie dakord të mos pretendojë imunitet sovran apo ndonjë lloj tjetër imuniteti nga juridiksioni i gjykatave angleze, gjykatave shqiptare dhe gjykatave të çdo juridiksioni tjetër në lidhje me ekzekutimin dhe dhënien e dëmshpërblimit (përfshirë dhe në rastin dhe masën ku ky imunitet mund të lidhet me të) dhe bie dakord të garantojë që asnjë kërkesë e tillë të mos bëhet në emër dhe për llogari të Shtetit.

b) Shteti nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me:

i) “hapësirat ku vendoset misioni diplomatik”, të tashme ose të ardhshme, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1961 “Hapësirat konsullore”, të tashme ose të ardhshme, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar në vitin 1963, ose të përdorura nga një diplomat apo mision diplomatik i Shqipërisë ose çdo agjenci apo mjet në vartësi të tij;

ii) pasuritë e paluajtshme, të cilat në datën bazë rregullohen nga dispozitat e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22 shkurt 2001 “Për pasuritë e paluajtshme të shtetit”;

iii) çdo fond monetar ose shumë të përcaktuar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka në bazë të traktateve të së drejtës ndërkombëtare publike, konventave ndërkombëtare ose marrëveshjeve shtet-shtet, ose marrëveshjeve që Republika e Shqipërisë ka me organizata ndërkombëtare jotregtare.

37. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

37.1 Çdo mosmarrëveshje (me përjashtim të një mosmarrëveshjeje taksash, por përfshirë një mosmarrëveshje nëse ajo mosmarrëveshje është një mosmarrëveshje taksash), që lind nga kjo Marrëveshje ose që në ndonjë mënyrë është e lidhur me këtë Marrëveshje (përfshirë formulimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pyetje në lidhje me arbitraritetin apo ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, përmbushjen, shkeljen ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, ose pasojat e

2688

pavlefshmërisë së saj apo ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me detyrime jokontraktore që lindin nga ose kanë lidhje me këtë Marrëveshje), ose mosmarrëveshjet (me përjashtim të një mosmarrëveshjeje taksash, por përfshirë një mosmarrëveshje nëse ajo mosmarrëveshje është një mosmarrëveshje taksash), që lindin nga ndonjë aktivitet i Projektit (mosmarrëveshje), në përputhje me nenin 37.2 do të zgjidhet nga arbitrazhi sipas neneve 37.3 deri te 37.8 (përfshirë), duke përjashtuar çdo zgjidhje tjetër apo çdo forum tjetër. Secila nga Palët jep miratimin e pakushtëzuar paraqitjen në arbitrazh.

37.2 Pa paragjykuar ndonjë masë të ndërmjetme apo mjet tjetër, që mund të jetë në dispozicion të Investitorit të Projektit, para fillimit të arbitrazhit sipas nenit 37.3:

a) Pala që ngre mosmarrëveshjen do të njoftojë me shkrim mosmarrëveshjen të Pala tjetër, njoftim, i cili do të përmbajë një informacion të shkurtër mbi natyrën dhe rrethanat e mosmarrëveshjes;

b) Palët do të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore; dhe

c) një Palë do të ketë të drejtën të referojë një mosmarrëveshje në arbitrazh sipas nenit 37.3, nëse Palët nuk kanë arritur një marrëveshje miqësore pas një muaji nga data e njoftimit të përcaktuar në nenin 37.2 (a).

37.3 Pala që fillon arbitrazhin sipas këtij neni 37.3, do të paraqesë mosmarrëveshjen sipas gjykimit të tij te:

a) Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit, e themeluar sipas Konventës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, që është hapur për nënshkrim në Uashington, më 18 mars 1965 (në vijim referuar si Konventa ICSID) për mosmarrëveshjet që janë nën juridiksionin e saj, duke iu referuar nenit 25 të saj; ose

b) një panel arbitrazhi, i themeluar sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në fuqi në datën e mosmarrëveshjes,

zgjedhja e së cilës do të jetë përfundimtare dhe detyruese për Palën tjetër.

37.4 Numri i arbitrave do të jetë tre. Pa paragjykuar kompetencat e njohura të institutit përkatës të arbitrazhit për formimin e panelit të arbitrazhit, paneli do të formohet si vijon:

a) secila Palë do të caktojë një arbitër për emërim;

b) arbitri i tretë, i cili do të veprojë si kryetar i panelit do të zgjidhet nga dy arbitrat e emëruar nga dhe për llogari të Palëve. Kryetari i panelit do të ketë shtetësi të ndryshme nga shtetësia e Palëve.

Nëse brenda 30 ditësh nga përfundimi i periudhës njëmuajore pas njoftimit me shkrim të Palës për mosmarrëveshjen, secila Palë ka dështuar të emërojë një arbitër, ose nëse arbitrat e emëruar nga Palët kanë dështuar të zgjedhin një arbitër të tretë brenda 30 ditësh nga data e emërimit të tyre, Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë do të emërojë këtë arbitër ose këta arbitra, të cilët nuk janë emëruar.

37.5 Nëse juridiksioni i ICSID-së është i padisponueshëm ose refuzohet për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje (përfshirë këtu dhe tërheqjen e Shtetit nga, apo paraqitjen e rezervës për Konventën ICSID), Pala që ka filluar arbitrazhin do të ketë të drejtën për të paraqitur mosmarrëveshjen në arbitrazh sipas nenit 37.3 (b).

37.6 Gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

37.7 Paneli do të ketë të drejtën të urdhërojë masa të ndërmjetme ose siguruese, që i konsideron të përshtatshme. Pasi të jepet vendimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët, dhe Palët marrin përsipër të zbatojnë vullnetarisht kushtet e tij pa asnjë vonesë. Për të shmangur çdo dyshim, Palët nuk heqin dorë nga e drejta e tyre për zgjidhjen jashtë gjyqësisht.



37.8 Nëse Palët nuk bien dakord ndryshe me shkrim, Palët bien dakord këtu se selia e arbitrazhit që do të mbahet sipas këtij neni do të jetë në Vjenë, dhe të gjitha seancat do të mbahen në këtë qytet.

Mosmarrëveshjet e taksave

37.9 Sipas nenit 37.10, të gjitha mosmarrëveshjet e taksave do të zgjidhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore (ligji nr. 9920/2008) dhe udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat tatimore (udhëzimi nr. 24/2008), meqenëse ligji dhe udhëzimi janë në datën bazë (procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat).

37.10 Nëse:

a) një pjesëmarrës në Projekt kundërshton apo apelon, apo ka për qëllim të kundërshtojë apo të apelojë një kontroll tatimor, njoftim vlerësimi tatimor apo një konstatim, apo përcaktim të ngjashëm nga një autoritet shtetëror në lidhje me taksat dhe sipas procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat, këtij pjesëmarrësi në Projekt i kërkohet të kryejë ndonjë pagesë të një shume, e cila është objekt kundërshtimi apo apelimi (përfshirë si parakusht ndaj atij kundërshtimi apo apelimi që po shqyrtohet) se detyrimi i pjesëmarrësit në Projekt për të paguar, sipas nenit 37.11 (a) do të konsistojë në shumën 1.000.000 euro (ose shuma ekuivalente në lekë shqiptarë). Me kusht që pjesëmarrësi në Projekt ka kryer (sipas shumës) pagesën përkatëse, autoritetit shtetëror përkatës (përfshirë Drejtorinë e Apelitit Tatimor) dhe do të vlerësojë apelimin apo kundërshtimin në përputhje me ligjin shqiptar të zbatueshëm;

b) pas datës bazë, ligji për procedurat tatimore (ligji nr. 9920/2008) dhe/ose udhëzimi i Ministrit të Financave për procedurat tatimore (udhëzimi nr. 24/2008) janë ndryshuar ose zëvendësuar në mënyrë të tillë që të mos jetë më e nevojshme të kryhet pagesa në shumën, e cila është objekt i kundërshtimit apo i apelitit (përfshirë si parakusht ndaj atij kundërshtimi apo apelimi që po shqyrtohet), procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat, për qëllime të kësaj marrëveshjeje, do të rishikohet automatikisht në të njëjtën kohë në të cilën është kryer ndryshimi apo zëvendësimi përkatës, në mënyrë që sipas procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat të mos jetë e nevojshme të kryhet pagesa në shumën, e cila është objekt i kundërshtimit apo apelitit (përfshirë si parakusht ndaj atij kundërshtimi apo apelimi që po shqyrtohet).

37.11 Nëse ekziston një mosmarrëveshje, qoftë një mosmarrëveshje taksash ose jo, pjesëmarrësi përkatës në Projekt mund të zgjedhë, si masë e brendshme, të pajtohet njëkohësisht me procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat, rast në të cilin (dhe pavarësisht ndonjë ligji shqiptar në kundërshtim me këtë):

a) nëse një mosmarrëveshje përcaktohet se është një mosmarrëveshje taksash, Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat, do të vazhdojë, me kusht që pavarësisht shumës së referuar në nenin 37.10 (a), pjesëmarrësi përkatës në Projekt, si parakusht për këtë vazhdimësi, do të duhet të paguajë brenda 15 ditësh pune nga përcaktimi i shumës së plotë që është objekt i kundërshtimit apo apelitit. Nëse pjesëmarrësi përkatës në Projekt nuk paguan shumën e plotë brenda 15 ditësh pune, do të konsiderohet se ka tërhequr kundërshtimin apo apelimin e tij dhe shuma, e cila ka qenë objekt i kundërshtimit apo apelitit do të bëhet menjëherë e pagueshme në përputhje me ligjin shqiptar; ose

b) nëse përcaktohet se mosmarrëveshja është një mosmarrëveshje:

iii) do të hiqet dorë nga procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat;

iv) të gjitha gjykimet, përcaktimet ose vendimet e kryera në përputhje me procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat do të shpallen të pavlefshme;

v) këto shuma të paguara nga pjesëmarrësi përkatës në Projekt sipas procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat, të cilat ishin objekt i kundërshtimit apo apelitit do t'i kthehen pjesëmarrësit përkatës në Projekt nga autoriteti shtetëror përkatës brenda 15 ditësh pune nga ai përcaktim; dhe

vi) mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh sipas neneve 37.3 deri në 37.8 (përfshirë), duke përjashtuar çdo kompensim tjetër apo forum për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

37.12 Për mënjanimin e çdo dyshimi dhe pavarësisht ndonjë ligji shqiptar në kundërshtim me këtë, përcaktimi i ndonjë mosmarrëveshjeje do të mbizotërojë mbi çdo gjykim, përcaktim apo vendim të kryer në përputhje me procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me taksat.

Vlefshmëria dhe zbatueshmëria

37.13 Dispozitat e këtij neni do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme pavarësisht nga pavlefshmëria, joligjshmëria apo pazbatueshmëria e ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje.

38. LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marrëveshje, përfshirë nenin 37 dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet jashtëkontraktore, që rrjedhin nga ose në lidhje me të do të qeverisen nga ligji anglez.

DISPOZITA TË FUNDIT

39. NATYRA E KËSAJ MARRËVESHJEJE

Kjo Marrëveshje në çdo kohë do të ketë një natyrë të dyfishtë, duke qenë në të njëjtën kohë pjesë e ligjit shqiptar (e përfshirë si ligji zbatues i Marrëveshjes Ndërqeveritare) dhe një kontrate private ndërmjet Investitorit të Projektit dhe Shtetit.

40. NDRYSHIMET E KËSAJ MARRËVESHJEJE

40.1 Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk do të jetë detyrues për Palët, përveç:

a) me qëllim që kjo Marrëveshje duke qenë në të njëjtën kohë pjesë e ligjit shqiptar (e përfshirë si ligji zbatues i Marrëveshjes Ndërqeveritare) dhe një kontratë private ndryshimi apo shtesat e saj të jenë:

- i) të përcaktuara me shkrim dhe të shprehin ndryshimin apo shtimin e kësaj Marrëveshjeje;
- ii) të nënshkruara nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës nga Palët; dhe
- iii) të jenë të miratuara me një vendim të Këshillit të Ministrave të Shtetit; dhe

b) përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 40.1 (a), për qëllim të kësaj Marrëveshjeje duke qenë në të njëjtën kohë pjesë e ligjit shqiptar (e përfshirë si ligji zbatues i Marrëveshjes Ndërqeveritare), që ndryshimi ose shtesa është miratuar (sipas rastit) nga Republika e Greqisë dhe Republika Italiane, sipas Marrëveshjes Ndërqeveritare dhe e miratuar me një ligj të Parlamentit të Shtetit.

40.2 Shteti nuk do të ndryshojë, shfuqizojë, përfundojë, deklarojë të pavlefshme ose të pazbatueshme ose në mënyrë tjetër të synojë të shmangë ose të kufizojë këtë Marrëveshje si pjesë efektive të ligjit shqiptar, pa miratimin paraprak me shkrim të Investitorit të Projektit.

41. INFRASTRUKTURA E MODERNIZIMIT TË LIGJIT

Shteti do të përdorë përpjekjet e tij më të mira për të bërë ndryshimet në legjislacionin shqiptar, të përcaktuara në shtojcën 4, duke miratuar një pjesë të veçantë të legjislacionit parësor brenda 3 muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

42. NORMA E INTERESIT E RËNË DAKORD

Nëse një nga Palët dështon të paguajë shuma të maturuara dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, ose sipas një vendimi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë Marrëveshje, Pala përveç pagimit të kësaj shume do të jetë përgjegjëse për t'i paguar Palës tjetër interesin (e llogaritur në bazë ditore dhe të përmbledhur sipas muajit) mbi shumën e detyrimit nga data kur detyrimi është bërë i pagueshëm deri në datën e pagesës, si dhe pas ose përpara vendimit gjyqësor apo atij të arbitrazhit, me normën e interesit të rënë dakord.

43. SKADIMI DHE PËRFUNDIMI

43.1 Pa paragjykuar nenin 2.6, kjo Marrëveshje do të ketë një afat që fillon në datën efektive dhe përfundon në datën në të cilën Investitori i Projektit do të përfundojë në mënyrë përfundimtare kryerjen e aktiviteteve të Projektit (sipas njoftimit nga Investitori i Projektit drejtuar Shtetit), përveç rasteve kur përfundon më parë në përputhje me këtë nen 43.



43.2 Nëse Investitori i Projektit nuk ka ndërmarrë hapat për fillimin e fazës së ndërtimit të Projektit jo më vonë se 48 muaj nga data efektive, atëherë për një periudhë prej 180 ditësh në vijim, Shteti do të këtë të drejtën të njoftojë me shkrim Investitorin e Projektit për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje. Ky përfundim do të jetë efektiv 60 ditë pas marrjes nga Investitori i Projektit të njoftimit për përfundimin, me përjashtim të rastit kur brenda kësaj periudhe 60-ditore, Investitori i Projektit ndërmerr hapa për fillimin e fazës së ndërtimit të Projektit. Nëse afati 180-ditor i sipërpërmendur skadon pa dërgimin nga ana e Shtetit të njoftimit për përfundimin, e drejta e Shtetit për të përfunduar këtë Marrëveshje do të skadojë dhe Marrëveshja do të qëndrojë në fuqi në përputhje me kushtet e saj. Gjithashtu, periodha 48-mujore e sipërpërmendur do të zgjatet nëse ka dhe për aq sa vonesat do të shkaktohen nga:

a) dështimi ose refuzimi i ndonjë Pale Shtetërore të kryejë ndonjë nga detyrimet e tij në këtë Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje tjetër të Projektit;

b) vonesa ose dështimi i ndodhur *upstream* ose *downstream* Sistemit Gazsjellës, i cili nuk është brenda kontrollit të arsyeshëm të Investitorit të Projektit (përfshirë këtu vonesën nga faza II, Shah Deniz Konsorcium në marrjen e vendimit të tij përfundimtar); ose

c) Forca Madhore që ndikon mbi Investitorin e Projektit.

43.3 Përfundimi ose skadimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet pa paragjykar:

a) të drejtat e Palëve (përfshirë ato të personave, të cilët nuk janë më Palë) dhe të personave të tjerë në lidhje me ndonjë përgjegjësi të Palëve të krijuar deri në datën e përfundimit;

b) përmbushjen e plotë të të gjitha detyrimeve në këtë Marrëveshje, të cilat kanë lindur para datës së përfundimit;

c) ato të drejta dhe detyrime, të cilat shprehimisht janë përcaktuar të qëndrojnë në fuqi dhe pas përfundimit; dhe

d) lënien në fuqi të të gjitha heqjeve dorë dhe dëmshpërblimeve të përcaktuara këtu në favor të një pale (ose ish-Pale) apo të një personi tjetër.

44. Natyra e detyrimeve të Palëve

Detyrimet e marra përsipër nga secila Palë në këtë Marrëveshje do të jenë të ndashme, të pavarura, absolute, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara dhe secili do të përbëjë një angazhim të pavarur të asaj Pale, të zbatueshëm në mënyrë të pavarur nga detyrimet e tjera të asaj Pale në këtë Marrëveshje dhe detyrimet e çdo Pale Shtetërore ose pjesëmarrësi në Projekt sipas Marrëveshjeve të Projektit, pa u kushtëzuar nga mospërmbushja, pavlefshmëria, pazbatueshmëria e këtyre detyrimeve të tjera.

45. TRASHËGIMTARËT DHE PASARDHËSIT E LEJUAR

45.1 Shteti bie dakord se të drejtat dhe përfitimet e Investitorit të Projektit në këtë Marrëveshje përfshijnë dhe të drejtën e transferimit apo cedimit të të drejtave të tij në këtë Marrëveshje në përputhje me dispozitat e këtij neni 45.

45.2 Sipas nenit 45.4, çdo transferim apo cedim i të drejtave dhe detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje nga Investitori i Projektit do të kërkojë njoftimin paraprak nga Investitori i Projektit dhe do të përfshijë detaje të të drejtave të transferuara dhe/ose detyrimeve dhe të palës ku do të transferohen, dhe nëse vendoset nga Investitori i Projektit, do të dorëzohet tek autoritetet shtetërore një marrëveshje e nënshkruar rregullisht nga Investitori i Projektit dhe pala ku propozohet transferimi i këtyre të drejtave dhe/ose detyrimeve, me kusht që autoritetet shtetërore do të kenë të drejtën (duke vepruar në mënyrë të arsyeshme), që brenda 20 ditësh nga marrja e këtij njoftimi të refuzojnë këtë transferim apo cedim të drejtash nëse pala e propozuar për transferimin apo cedimin:

a) paraqet një kërcenim për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

b) është një entitet i themeluar apo i organizuar në një juridiksion, që është subjekt i sanksioneve të Bashkimit Europian apo të Kombeve të Bashkuara;

c) (nëse Investitori i Projektit synon të transferojë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje), nuk ka aftësinë teknike dhe financiare të përmbushë detyrimet e Investitorit të Projektit, sipas kësaj

Marrëveshjeje (të vlerësohet në krahasim me aftësitë e Investitorit të Projektit në kohën kur është dhënë njoftimi nga Investitori i Projektit).

45.3 Me dorëzimin e formës së Marrëveshjes sipas nenit 45.2, Shteti do të nënshkruajë menjëherë Marrëveshjen dhe do t'ia kthejë atë Investitorit të Projektit.

45.4 Shteti pranon çdo transferim (në formë garancie) ose dhënien e garancive të tjera për huadhënësit, ose një entitet që vepron në emër të tyre (përfshirë një agjent ose palë të ngarkuar nga huadhënësit) për përfitim të, apo të drejtat sipas kësaj Marrëveshjeje.

45.5 Në rast transferimi apo cedimi (sipas rastit) të të drejtave dhe detyrimeve të Investitorit të Projektit në këtë Marrëveshje sipas nenit 45, Shteti bie dakord të nënshkruajë dokumentet e nevojshme në vijim për të bërë efektiv transferimin apo cedimin, transferimin e lejes së posaçme të pala përfituese, ekzekutimin e garancive nga huadhënësit dhe çdo transferim të mëvonshëm nga huadhënësit të të drejtave të Investitorit të Projektit të një palë e tretë, tek e cila do të transferohet një pjesë madhore e Projektit si rrjedhojë e ekzekutimit.

46. ÇMONTIMI

Pas skadimit apo përfundimit paraprak të kësaj Marrëveshjeje, Investitori i Projektit do të çmontojë Projektin në përputhje me kushtet e planit të çmontimit, i cili do të vendoset sipas përcaktimit në procesin e ndikimit në ambient dhe social (si mund të ndryshohet kohë pas kohë), të përcaktuar në nenin 17, përveç kur Shteti pranon që të gjitha të drejtat në lidhje me infrastrukturën shqiptare t'i transferohen Shtetit ose personit të përcaktuar nga Shteti. Investitori i Projektit nuk do të ketë detyrime të tjera për çmontimin, përveç atyre të përcaktuara në këtë nen 46.

47. BASHKËPUNIMI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

47.1 Shteti pranon se Investitori i Projekti synon të financojë ndërtimin e Projektit me financime të kufizuara ose me garanci të kufizuara. Shteti, gjithashtu, pranon se ky financim është thelbësor për Projektin dhe se ky financim do të jetë në lidhje me gjithë Projektin dhe jo vetëm me një pjesë të tij. Me kusht që Investitori i Projektit të rimbursojë Shtetin për shpenzimet ligjore të kryera për këtë qëllim, Shteti bie dakord të bashkëpunojë me Investitorin e Projektit në kërkimin e këtij financimi të kufizuar ose me garanci të kufizuara, të bazuar në borxh ose financim titujsh për Projektin, ku ky bashkëpunim do të përfshijë si vijon:

a) vënien në dispozicion të huadhënësve potencialë, mbajtësve të interesit dhe filialeve të tyre të të dhënave jopronësore/josekrete, që janë në dispozicion të Shtetit dhe që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga këta persona;

b) në mbylljen financiare, dhënien e opinioneve ligjore, të cilat mund të përfshijnë kualifikime të zakonshme, tek Investitori i Projektit, huadhënësit, mbajtësit e interesit ose filialeve të tyre përkatëse në lidhje me (por pa u kufizuar në):

i) autorizimin e rregullt dhe miratimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Ndërqeveritare dhe të MÇP-së;

ii) efektin e vlefshëm dhe detyrues të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Ndërqeveritare, të MÇP-së dhe të marrëveshjeve të Projektit për Shtetin dhe Palët e tjera Shtetërore;

iii) mungesën e ndonjë mospërmbushje apo shkelje të njohur (ose çdo rast apo rrethanë, me kalimin e kohës, dhënien e njoftimeve ose kryerjen e një përcaktimi për një shkelje ose mospërmbushje), sipas marrëveshjeve materiale në të cilat Shteti është palë, e cila shkaktohet ose mund të shkaktohet nga nënshkrimi dhe ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Ndërqeveritare ose të MÇP-së; dhe

iv) mungesën e ndonjë çështjeje gjyqësore në pritje, dhe sipas njohurive më të mira të Shtetit, ndonjë proces gjyqësor eventual kundër Shtetit dhe/ose ndonjë Palë tjetër Shtetërore, dhe nëse vendimi do të ishte i pafavorshëm për Shtetin dhe/ose ndonjë Palë tjetër Shtetërore, mund të ketë arsye të pritë që të ketë një efekt material negativ mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Ndërqeveritare, MÇP-së dhe/ose marrëveshjet e Projektit;



c) nëse kërkohet nga Investitori i Projektit, duke hyrë në një marrëveshje të drejtpërdrejtë me huadhënësit (ose agjent ose administrues i trustit të huadhënësve), të zakonshme për një borxh të kufizuar ose financim titujsh, ku kjo marrëveshje të rregullojë çështje që përfshijnë:

i) një pranim nga Shteti të interesave të sigurisë në këtë Marrëveshje të mbajtura nga huadhënësit;

ii) një kërkesë për shumat që duhet të paguhen nga palët shtetërore tek Investitori i Projektit, sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, të paguhen në një llogari të përcaktuar nga huadhënësit, kohë pas kohe;

iii) një kërkesë për Shtetin të njoftojë huadhënësit (ose agjentët, administratorët e trustit ose përfaqësues të tjerë të tyre) për ndonjë mospërbushje nga Investitori i Projektit ose rrethana të tjera (së bashku veprim mospërbushje) që do t'i jepte të drejtën Shtetit të përfundonte këtë Marrëveshje ose të pezullojë detyrimet e tij në këtë Marrëveshje;

iv) një marrëveshje që sapo huadhënësit të marrin këtë njoftim nga Shteti ose kur huadhënësit njoftojnë Shtetin se një rast mospërbushje ka ndodhur sipas dokumenteve të financimit, do të fillojë një “periudhë vendimmarrje”, e cila do të vazhdojë në vijim për një periudhë prej njëqind e njëzetë (120) ditësh. Gjatë periudhës së vendimmarrjes, Shteti do të pranojë njoftime dhe udhëzime nga huadhënësit, njësoj sikur këto të ishin dërguar nga Investitori i Projektit;

v) një marrëveshje që huadhënësit ose përfaqësuesit e tyre mundet që duke ndërhyrë ose pa ndërhyrë në këtë Marrëveshje, të rregullojnë mospërbushjen (dhe ky rregullim do të konsiderohet se ka përmbushur detyrimet përkatëse të Investitorit të Projektit) gjatë periudhës së vendimmarrjes;

vi) një marrëveshje që gjatë periudhës së vendimmarrjes, huadhënësit ose një palë e tretë e caktuar nga huadhënësit mund të ndërhyjnë së bashku në marrëveshje, duke marrë përsipër detyrimet e Investitorit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje (entiteti ndërhyrës) dhe në vijim mund të dalin nga kjo Marrëveshje dhe të zhvishen nga detyrimet e Investitorit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç atyre detyrimeve, të cilat janë mbledhur gjatë periudhës së ndërhyrjes. Kjo dalje nga Marrëveshja mund të ndodhë në njoftimin e parë të huadhënësve, në datën e transferimit të kësaj Marrëveshjeje, si është përcaktuar në nenin 47.1 (c) dhe në datën e përfundimit, sipas kushteve të marrëveshjes së drejtpërdrejtë të kësaj Marrëveshjeje ose në datën e skadimit të kësaj Marrëveshjeje;

vii) një kërkesë se gjatë periudhës së ndërhyrjes, Shteti do të pranojë njoftime dhe udhëzime nga huadhënësit, njësoj sikur këto të ishin dërguar nga Investitori i Projektit dhe do të ketë marrëdhënie vetëm me entitetin ndërhyrës, duke përjashtuar Investitorin e Projektit;

viii) një kërkesë se Shteti nuk mund të ndërmarrë veprime kundër ose në lidhje me Investitorin e Projektit (përfshirë, por pa u kufizuar në ndërmarrjen e veprimeve për likuidimin, administrimin, kujdestarinë, falimentimin ose ndonjë procedurë riorganizimi që do të ndikojë mbi Investitorin e Projektit dhe aktivet e tij) ose të përfundojë apo të pezullojë këtë Marrëveshje (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo), duke përdorur të drejtat e ekzekutimit (përfshirë të drejtat lidhur me interesat e sigurisë apo të përshpejtojë dhe të bëjë të kërkueshme kreditë) nga huadhënësit ose përfaqësuesit e tyre kundrejt Investitorit të Projektit, ose ortakut/ortakëve të tij gjatë periudhës së vendimmarrjes ose të ndërhyrjes;

ix) një marrëveshje se gjatë periudhës së vendimmarrjes ose periudhës së ndërhyrjes, ose në rast të ekzekutimit të garancive nga huadhënësit, huadhënësit mund të transferojnë të drejtat dhe detyrimet e Investitorit të Projektit në këtë Marrëveshje dhe çdo garanci në lidhje me këtë Marrëveshje të një palë e tretë, e emëruar nga huadhënësit (sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 47.1 (c) (x));

x) një kërkesë për çdo zëvendësues të Investitorit të Projektit që të ketë aftësitë teknike dhe financiare për të përmbushur detyrimet e Investitorit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje (të vlerësohet në krahasim me aftësinë e Investitorit të Projektit në kohën përpara fillimit të periudhës së vendimmarrjes); dhe

d) të nënshkruajë ato dokumente të tjera që janë të nevojshme ose të përshtatshme për të shtrirë te të gjithë huadhënësit e mundshëm garancitë, deklarimet, siguritë, angazhimet, sipërmarrjet dhe detyrimet e Shtetit në formën dhe në masën e përcaktuar në këtë Marrëveshje.

47.2 Shteti do të përdorë të gjitha mundësitë e tij të sigurojë që çdo garanci e dhënë nga Investitori i Projektit të huadhënësit (apo ndonjë agjent apo administrator i trustit të huadhënësit), në lidhje me infrastrukturën shqiptare është e regjistruar dhe plotësisht e ekzekutueshme në përputhje me kushtet në të cilat kjo garanci është dhënë.

48. NJOFTIMET

48.1 Njoftimet, miratimet, pëlqimet dhe çdo komunikim tjetër i dhënë sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje (në këtë nen 48, një njoftim):

a) duhet të bëhet me shkrim në gjuhën angleze;

b) duhet të dorëzohet dorazi ose me një shërbim korrier të njohur në rang ndërkombëtar, ose të dërgohet me faks te Pala, së cilës është kërkuar ose është lejuar t'i jepet, ose kryhet, ose të bëhet në adresën e Palës, numrin e faksit ose adresën e e-mail-it të përcaktuar më poshtë dhe të shënohet për vëmendjen e personit të cilit i drejtohet, ose në një adresë tjetër, numër faksi ose adresë e-mail-i dhe/ose i shënuar për në vëmendjen e atij personi që Pala përkatëse mundet, kohë pas kohe, të përcaktojë në njoftimin e dhënë në përputhje me këtë paragraf.

48.2 Çdo njoftim ose dokument tjetër i dërguar me e-mail do të dërgohet si një e-mail, duke i bashkëlidhur njoftimin ose çdo dokument tjetër në një formë të pandryshueshme në formatin PDF. Asnjë njoftim ose dokument nuk do të dërgohet në trupin e e-mail-it.

48.3 Të dhënat përkatëse të çdo Pale në datën e kësaj Marrëveshjeje janë:

Shteti:

Adresa: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, Tiranë, Shqipëri

Faksi: +355 4 2234 052

E-mail: sekretaria@mete.gov.al

Në vëmendje të: Ministrit

Investitori i Projektit:

Adresa: Trans Adriatic Pipeline AG, Lindenstrasse 2, 6340 Baar, Switzerland

Faksi: +41 41 747 34 01

E-mail: tap.dcc@tap-ag.com

Në vëmendje të: Drejtorit Menaxhues

48.4 Në mungesë të vërtetimit të një marrjeje të mëparshme në dorëzim, çdo njoftim do të marrë fuqi nga koha që konsiderohet se është marrë në përputhje me nenin 48.5.

48.5 Bazuar në këtë nen 48.4, një njoftim konsiderohet se është marrë:

a) në rast se dorëzohet dorazi në adresën e personit pritës, me dorëzimin në këtë adresë;

b) në rast dërgimi me një shërbim korrier të njohur në rang ndërkombëtar, kur ky shërbim korrier i njohur në rang ndërkombëtar e ka dorëzuar këtë komunikim ose dokument në adresën përkatëse dhe ka marrë një nënshkrim që konfirmon marrjen në dorëzim;

c) në rast të dërgimit me faks, me printimin e një raporti të transmetimit nga pajisja dërguese e faksit, ku tregohet se faksi ishte dërguar i plotë në numrin e faksit të pritësit; dhe

d) nëse është dërguar me e-mail, pas gjenerimit të një njoftimi marrje nga serveri i pritësit ose nëse ky njoftim nuk gjenerohet me dorëzimin në serverin e pritësit.

48.6 Një njoftim i marrë ose që konsiderohet i marrë në përputhje me këtë nen 48.5 në një ditë që nuk është ditë pune ose pas orës 5:00 pm në çdo ditë pune, sipas orës lokale të vendit të marrjes në dorëzim do të konsiderohet të jetë marrë në ditën e punës vijuese.

49. TË NDRYSHME

49.1 Heqja dorë

a) të drejtat e secilës Palë në këtë Marrëveshje:



- i) mund të ushtrohen sa herë të jetë e nevojshme;
 - ii) përveçse kur është përcaktuar ndryshe në këtë Marrëveshje janë përfshirëse dhe jo përjashtuese të të drejtave dhe kompensimeve të përcaktuara në ligj; dhe
 - iii) nga to mund të hiqet dorë vetëm me shkrim dhe në mënyrë specifike.
- b) vonesa nga një Palë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje nuk përbën një heqje dorë nga ajo e drejtë;
- c) një heqje dorë (qoftë e shprehur apo e nënkuptuar) nga njëra nga Palët nga ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose shkelja apo mospërmblidhja nga Pala tjetër e ndonjërës nga këto dispozita, nuk do të përbëjë një heqje dore të vazhdueshme dhe kjo heqje dore nuk do të ndalojë Palën që ka hequr dorë nga zbatimi i mëtejshëm i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nga të cilat nuk është hequr dorë ose të veprojë kundrejt ndonjë shkeljeje apo mospërmblidhjeje nga Pala tjetër e ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

49.2 Të drejtat e palëve të treta

Pavarësisht nga neni 34, të gjitha të drejtat dhe dëmshpërblimet e shprehura për të qenë në favor të një pale të tretë (përfshirë çdo pjesëmarrës në Projekt), në këtë Marrëveshje mund të ekzekutohen nga këto palë të treta në përputhje me kontratat (të drejtat e palëve të treta), akti i vitit 1999 (siç është në fuqi në Angli dhe Uells), pavarësisht se këto palë të treta nuk janë palë në këtë Marrëveshje.

Sipas nenit 40, por pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje për përfitimin e një pale të tretë (përfshirë këtë nen 49.2), Palët nuk do të kërkohet të kenë miratimin e një pale të tretë për ndonjë ndryshim, heqje dorë apo përfundim të tyre (sipas rastit) në këtë Marrëveshje.

49.3 Deklarata

a) Secila Palë pranon se duke rënë dakord për të lidhur këtë Marrëveshje, nuk është bazuar në ndonjë deklaratë, garanci, kontratë kolaterale apo garanci tjetër të shprehur ose të nënkuptuar (përveç atyre të përsëritura në këtë Marrëveshje dhe në dokumentet e përmendura në të), të bërë nga ndonjë Palë tjetër në çfarëdo kohe para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Secila Palë heq dorë nga të drejtat dhe kompensimet, të cilat, përveç këtij neni 49.3 (a), mund të jenë të mundshme në lidhje me këto deklarime, garanci, kontrata kolaterale, kontratë dhe garanci të tjera.

b) Asgjë në nenin 49.3 (a), nuk kufizon apo përjashton përgjegjësinë për mashtrimin.

49.4 Marrëdhënia midis Palëve

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të konsiderohet se krijon një partneritet midis Palëve ose se njëra Palë është agjent i Palës tjetër për çfarëdo qëllimi.

49.5 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, dhe dokumentet e përmendura në të, përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me transaksionet e përshkruara në këtë Marrëveshje dhe ka përparësi mbi të gjitha marrëveshjet e mëparshme midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Përveç kur kërkohet ndryshe nga ligji, në këtë Marrëveshje nuk do të ketë kushte të nënkuptuara (qoftë nga zakoni, përdorimi apo të përdorura në formë tjetër).

49.6 Garanci të mëtejshme

Çdo Palë bie dakord që me kërkesën e Palës tjetër të nënshkruajë çdo dokument dhe të ndërmarrë hapat që janë të nevojshëm për të zbatuar dhe për t'i dhënë fuqi të plotë kësaj Marrëveshjeje.

49.7 Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në një numër të caktuar kopjesh origjinale, të cilat së bashku do të përbëjnë të njëjtën Marrëveshje dhe secila nga Palët mund të hyjë në këtë Marrëveshje, duke nënshkruar një nga kopjet origjinale.

49.8 Pavarësia

Dispozitat e çdo neni të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra dhe vlefshmëria e tyre nuk do të cenohet nëse ndonjë nga dispozitat e tjera është e

pavlefshme. Nëse ndonjë nga këto dispozita është e pavlefshme, por do të ishte e vlefshme nëse një pjesë e saj do të hiqej, dispozita në fjalë do të zbatohet me ndryshimin që nevojitet për ta bërë të vlefshme.

49.9 Konfidencialiteti

Shteti dhe Investitori i Projektit do të ruajnë dhe Shteti do të garantojë që çdo Palë Shtetërore të ruajë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave dhe informacionit të një natyre jopublike apo personale që ata mund të marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga të tjerët që i përket ndonjërit nga pjesëmarrësit në Projekt apo Projektit.

49.10 Kostot

Çdo Palë do të paguajë kostot dhe shpenzimet e saj në lidhje me negocimin, përgatitjen dhe finalizimin e kësaj Marrëveshjeje.

49.11 Gjuha

a) Marrëveshja do të nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe në atë angleze. Në rast mospërputhjes do të ketë përparësi varianti në gjuhën angleze.

b) Gjuha e kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha njoftimet, kërkesat, deklaratat, certifikatat ose dokumente e komunikime të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë në gjuhën angleze, përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim, me kusht që të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, urdhrat, deklaratimet dhe dokumentet e tjera apo komunikimet nga Shteti do të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze, ku do të ketë përparësi varianti në gjuhën angleze. Nëse kjo Marrëveshje ose dokumente të lidhura me të do të përkthehen në një gjuhë tjetër, do të ketë përparësi varianti në gjuhën angleze.

Palët e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht:

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: Florjon Mima

Pozicioni: Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

INVESTITORI I PROJEKTIT

Trans Adriatic Pipeline AG

Nga: Kjetil Tungland

Pozicioni: Drejtor Menaxhues

SHTOJCAT E MARRËVESHJES ME QEVERINË E VENDIT PRITËS

SHTOJCA 1

TOKA E PROJEKTIT

PJESA 1

TOKA E KËRKUAR PËR PROJEKTIN

Përkufizime

Në këtë shtojcë, përveç përkufizimeve të përcaktuara në nenin 1, përkufizimet e mëposhtme do të kenë këtë kuptim:

“Faza e Ndërtimit” do të thotë periudha nga data kur fillon ndërtimi faktik i infrastrukturës shqiptare deri në datën kur Sistemi i Gazsjellësit do të komisionohet për përdorim tregtar dhe të gjitha pajisjet e ndërtimit janë larguar nga toka e përkohshme.

“Faza Pas Ndërtimit” do të thotë periudha nga përfundimi i fazës së ndërtimit deri në skadimin ose përfundimin më të hershëm të kësaj Marrëveshjeje.

“Faza Para Ndërtimit” do të thotë periudha nga data efektive deri në fillimin e fazës së ndërtimit.



“Faza e Ndërtimit” do të thotë vlera që zëvendëson humbjet e pësuar nga personat e prekur, në përgjithësi mbi bazat e vlerës së drejtë të tregut dhe duke marrë në konsideratë kostot e transaksionit.

“Infrastruktura mbi Tokë” do të thotë ato pjesë të infrastrukturës shqiptare, që janë të nevojshme për të kontrolluar rrjedhën normale të gazit natyror dhe/ose për të garantuar sigurinë dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Gazsjellësit, duke përfshirë stacionet e kompresorëve, stacionet e matjes dhe *pigging*, terminalët pritëse dhe stacionet e valvulave bllokuese.

“Marrëveshja Kadastrale” do të thotë midis Investitorit të Projektit dhe Regjistrat të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë, datë 24 nëntor 2011.

“Korridorit i Interesit” do të thotë ajo pjesë e tokës me një gjerësi prej afërsisht 2 kilometrash në çdo pikë të saj, që shtrihet nga pika e fillimit në pikën e mbarimit, si përshkruhet në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

“Korridori i Ndërtimit” do të thotë toka e përkohshme e identifikuar nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 6.1, që shtrihet nga pika e fillimit në pikën e mbarimit, brenda së cilës do të vendoset qendër-shtrirja e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit dhe që është e nevojshme për ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit dhe aktiviteteve të lidhura të Projektit gjatë fazës së ndërtimit.

“Korridori i Sistemit të Gazsjellësit” do të thotë ajo tokë e përhershme, e cila nuk është toka e infrastrukturës, brenda Korridorit të Ndërtimit, identifikuar nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 6.1 dhe që shtrihet nga pika e fillimit në pikën e mbarimit, brenda, mbi ose nën të cilën do të ndodhet Sistemi i Gazsjellësit (përveç infrastrukturës mbi tokë).

“Materialet e Rrezikshme” do të thotë çdo substancë natyrale apo artificiale, e cila (qoftë më vete, qoftë në lidhje me ndonjë substancë tjetër) shkakton lindjen e një rreziku për shkaktimin e dëmeve, te personat ose ndonjë tjetër person fizik apo shkakton dëme në mjedis dhe përfshin çdo mbetje, material, ujë ose substancë tjetër të rrezikshme (përfshirë këtu naftën, derivatet, nënproduktet dhe hidrokarbure dhe asbeste të tjera), të kontrolluara, të veçanta, të rrezikshme, të ndotura, të kontaminuara, të djegshme, toksike, radioaktive, gërryese/korrozive, kaustike apo të rrezikshme, por përjashton çdo substancë natyrore që shfaqet në mënyrë të natyrshme në çastin e zbulimit të saj. Për këtë qëllim, “shfaqja në mënyrë të natyrshme”, përjashton rrethanat në të cilat vendi i substancës përkatëse rezulton drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga ndonjë zhvillim njerëzor ose veprim tjetër.

“Personat e Prekur” do të thotë mbajtësit ekzistues të licencave, si dhe ata persona (përfshirë dhe përdoruesit informalë të tokës), toka e të cilëve është marrë, rënduar apo cenuar, ose të drejtat e të cilëve në lidhje me këtë tokë janë marrë, rënduar apo cenuar, si rezultat i marrjes së të drejtave përkatëse mbi tokën e kërkuar të Projektit nga Investitori i Projektit dhe përfshin ata persona që janë pronarë, pushtues ose përdorues informalë të tokës, në krah të tokës së kërkuar për Projektin.

“Parimet e Kompensimit” ka kuptimin që është dhënë në paragrafin 8.1 (a) (ii) pjesa 1 e kësaj shtojce.

“Pika e Fillimit” do të thotë pika e gjendur në kufirin midis territorit shqiptar dhe territorit të Republikës së Greqisë, e përcaktuar nga Investitori i Projektit, si teknikisht e përshtatshme për kalimin e Sistemit të Gazsjellësit nga Republika e Greqisë në Republikën e Shqipërisë.

“Pika e Mbarimit” do të thotë pika e gjendur në kufirin e detit Adriatik, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, e përcaktuar nga Investitori i Projektit, si teknikisht e përshtatshme për kalimin e Sistemit të Gazsjellësit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë.

“Plani i Rehabilitimit të Jetesës” do të thotë dokumenti, i cili do të përgatitet nga Investitori i Projektit, bazuar në politikën ambientale dhe sociale, ku do të përcaktohen të drejtat e personave të prekur, ku do të përcaktohen: vlerat e përbashkëta të vlerësimit për tokën në lidhje me personat e

prekur dhe përcakton proceset e hyrjes dhe shpronësimit të tokës, të përshkruara nga kjo Marrëveshje (në çdo rast, në një mënyrë që është në përputhje me këtë Marrëveshje) dhe do të jetë në përputhje me ligjin shqiptar dhe politikën sociale dhe mjedisore.

“Procedurat e Negocimit” ka kuptimin e dhënë në paragrafin 7.1 (b).

“Situata e Emergjencës” do të thotë një situatë në të cilën kanë ndodhur dëme në njerëz ose në pronë, ose kur dëmi i pashmangshëm ndaj personave apo pronës mund të ndodhë arsyeshmërisht nëse ajo situatë nuk zgjidhet.

“Të Drejtat Përkatëse” do të thotë të drejtat e nevojshme për të ndërtuar dhe vënë në funksionim Sistemin e Gazsjellësit.

“Toka e Infrastrukturës” do të thotë toka e përhershme e identifikuar nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 6.1, e cila është e nevojshme për instalimin e infrastrukturës mbi tokë.

“Toka e Kërkuar për Projektin” do të thotë toka e përhershme, toka e përkohshme dhe toka për përmirësimin e rrugëve.

“Toka për Përmirësimin e Rrugëve” do të thotë toka në krah të rrugëve publike ekzistuese, e kërkuar për qëllim të punimeve për hyrjen në rrugët publike.

“Toka e Përkohshme për Hyrjen në Rrugë” do të thotë toka e përkohshme, e identifikuar nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 6.1, që kërkohet për ndërtimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve hyrëse të përkohshme për të lehtësuar aktivitetet e Projektit gjatë fazës së ndërtimit.

“Toka e Përkohshme” është toka e kërkuar nga Investitori i Projektit vetëm për fazën e ndërtimit.

“Toka e Përhershme” do të thotë toka e kërkuar nga Investitori i Projektit për fazën e ndërtimit dhe fazën pas ndërtimit.

“Toka e Tepërt” ka kuptimin e dhënë në paragrafin 6.2.

“Vlera e Zëvendësimit” do të thotë vlera për të zëvendësuar humbjet që ka pësuar një person i prekur, përgjithësisht në bazë të një vlerësimi të drejtë të tregut dhe duke marrë në konsideratë kostot e transaksionit, por të cilat, në çdo rast, nuk do të jenë më të ulëta se shumica e kompensimit, e cila do të jetë e pagueshme në rrethanat përkatëse sipas ligjit të zbatueshëm.

“Zona e Preferuar e Projektit” do të thotë një zonë e tokës që shtrihet nga pika e fillimit në pikën e mbarimit, me gjerësi afërsisht 400 metra, ku disa zona mund të jenë më të gjera sipas ndërtimit inxhinierik të Sistemit të Gazsjellësit dhe metodologjisë së parashikuar për ndërtimin e Sistemit të Gazsjellësit, së bashku me tokën, që është përcaktuar paraprakisht nga Investitori i Projektit, si toka që mund të kërkohet për hyrjen e përkohshme në rrugë dhe toka për përmirësimin e rrugëve.

1. STANDARDET E ZBATUESHME

1.1 Shteti do të përmbushë dhe do të mundësojë që palët e tjera shtetërore të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj shtojce:

- a) brenda kufirit të autoritetit të tyre;
- b) në përputhje me detyrimet e tij sipas ligjit ndërkombëtar publik dhe ligjit shqiptar (siç është ndryshuar nga kjo Marrëveshje);
- c) në përputhje me kërkesat e performancës, përfshirë përmbushjen e kërkesave të Bankës Europiane për Ndërtim dhe Zhvillim, siç janë përcaktuar në politikën sociale dhe ambientale të ndryshuar kohë pas kohe; dhe
- d) standardet dhe kërkesat shtesë të përcaktuara në shtojcën 2.

1.2 Palët pranojnë se proceset e përcaktuara në pjesën 1 të kësaj shtojce do të kryhen brenda kontekstit të përshkruar në pjesën 3 të kësaj shtojce.

2. ADMINISTRIMI



2.1 Brenda 10 ditësh pune nga data efektive e Marrëveshjes, Investitori i Projektit dhe Shteti do t'i përcaktojnë njëri-tjetrit me shkrim ata persona, agjenci dhe organe rregullatore me të cilat secili do të jetë i autorizuar të komunikojë dhe t'iu referohet për sa i përket dhënies së njoftimeve të ndryshme dhe garantimit dhe konfirmimit të të drejtave të ndryshme, të përshkruara në këtë shtojcë. Këta persona kontakti apo organe të njoftuara do të jenë objekt i ndryshimeve, kohë pas kohe, jo më pak se 5 ditë pune përpara njoftimit me shkrim.

2.2 Në bazë të nenit 49.9 të kësaj Marrëveshjeje, kufizimet e aplikueshme të privatësisë dhe mbrojtës së të dhënave sipas ligjit shqiptar dhe të standardeve të aplikueshme të të drejtave të njeriut, Investitori i Projektit do të ketë të drejtë të përdorë, të publikojë dhe/ose të nxjerrë jashtë vendit çdo të dhënë dhe informacion të përftuar nga Investitori i Projektit ose ndonjë tjetër pjesëmarrës në Projekt në lidhje me aktivitetet e përshkruara në këtë shtojcë.

3. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME TOKËN E PROJEKTIT

3.1 Sa i përket tokës së Projektit dhe në përputhje me paragrafin 1.1 këtu më sipër, Shteti:

a) sipas nenit 28 do të lëshojë ose do të mundësojë lëshimin në përputhje me këtë Marrëveshje të të gjitha lejeve, autorizimeve të nevojshme, certifikatave të regjistrimit të tokës, si dhe të gjitha lejet shtetërore të nevojshme sipas ligjit shqiptar për Investitorin e Projektit, në mënyrë që ky i fundit të pajiset dhe të ushtrojë ato të drejta përkatëse të përftuara në përputhje me këtë shtojcë;

b) do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar se Investitori i Projektit është i aftë të gëzojë të drejtat përkatëse që i janë vënë në dispozicion në tokën e Projektit;

c) nuk do t'i lëshojë ndonjë personi tjetër, përveçse Investitorit të Projektit, të drejta përkatëse apo të drejta të tjera në lidhje me tokën e Projektit, të cilat nuk janë në përputhje apo mund të ndikojnë në ushtrimin dhe gëzimin e plotë nga secili pjesëmarrës në Projekt të të drejtave përkatëse, të cilat janë akorduar në përputhje me këtë Marrëveshje;

d) do të garantojë se të gjitha të drejtat përkatëse, që i janë vënë në dispozicion Investitorit të Projektit, vazhdojnë për një periudhë vijuese prej jo më pak se afati i kësaj Marrëveshjeje, përveç rastit kur kjo Marrëveshje parashikon shprehimisht një periudhë më të shkurtër zbatimi;

e) nuk do të revokojë ndonjë të drejtë përkatëse, e cila i është akorduar Investitorit të Projektit pa miratimin paraprak me shkrim të Investitorit të Projektit;

f) do të mbrojë, do të ruajë dhe do të dëmshpërblejë Investitorin e Projektit nga dhe ndaj çdo humbje apo dëmi që mund të shkaktohet në lidhje me çdo dhe të gjitha pretendimet e palëve të treta ose kërkesat e ngritura nga apo në lidhje me:

i) ushtrimin nga ana e Investitorit të Projektit apo nga një pjesëmarrës në Projekt i të drejtave përkatëse; ose

ii) zbatimin (qoftë pjesërisht, qoftë tërësisht ose në përputhje me ligjin shqiptar ose jo) të detyrimeve të palëve shtetërore sipas kësaj shtojce,

përfshirë çdo dhe të gjitha pretendimet ose kërkesat e palëve të treta nga çdo person që pretendon se është një person i prekur nëse Investitori i Projektit, në kohën e pretendimit dhe duke vepruar në mirëbesim, ka kompensuar tashmë një person tjetër në lidhje me të drejtat përkatëse të zbatueshme; dhe

g) do të mbrojë, do të ruajë dhe do të dëmshpërblejë Investitorin e Projektit nga dhe ndaj çdo humbje apo dëmi që mund të shkaktohet në lidhje me zbulimin e ndonjë materiali të rrezikshëm paraekzistues në ndonjërin nga tokat e kërkuara të Projektit, me kusht që Shteti nuk do të ketë asnjë detyrim për të mbrojtur ose për të zhdëmtuar Investitorin e Projektit për aq sa këto humbje ose dëme kanë lindur si rezultat i dështimit të Investitorit të Projektit, ose ndonjërit prej kontraktorëve apo nënkontraktorëve të tij, për të vepruar si një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të aplikueshme.

3.2 Detyrimet e Shtetit dhe të palëve shtetërore në këtë paragraf 3 do të zbatohen në mënyrë të barabartë në tokën shtetërore dhe në tokën joshtetërore.

3.3 Palët shtetërore do të angazhohen në mënyrë aktive, do të marrin pjesë në mbledhje dhe do të mbështesin Investitorin e Projektit në identifikimin dhe përfitim nga ana e Investitorit të Projektit, të tokës së kërkuar të Projektit dhe të të drejtave përkatëse të kërkuara dhe në lidhje me të gjitha aktivitetet e tjera të parashikuara nga ose që mund të lindin nga aktivitetet e marra përsipër në lidhje me këtë shtojcë.

3.4 Informacioni kadastral

a) Palët do të bashkëpunojnë në lidhje me përgatitjen dhe finalizimin e informacionit kadastral lidhur me tokën e Projektit (dhe çdo tokë të mundshme të Projektit) në përputhje me dhe sipas marrëveshjes midis Investitorit të Projektit dhe Regjistrisë të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë, datë 24 nëntor 2011 (Marrëveshja Kadastrale).

b) Shteti do të garantojë se Regjistri i Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë është në përputhje me të gjitha detyrimet sipas Marrëveshjes Kadastrale në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme.

3.5 Licencat ekzistuese

a) Me përjashtim të atyre që nuk janë në përputhje me këtë paragraf 3.5 (i cili do të ketë përparësi), mbajtësit ekzistues të licencave do të trajtohen në të njëjtën mënyrë me palët e prekura, të cilat zotërojnë të drejta kontraktore në lidhje me tokën e kërkuar të Projektit.

b) Pavarësisht nga ndonjë përcaktim i kundërt në këtë shtojcë:

i) Investitori i Projektit do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të negociuar me secilin nga mbajtësit ekzistues të licencave një marrëveshje detyruese, e cila, ndër të tjera:

A. do të jetë një marrëveshje midis Investitorit të Projektit, mbajtësit ekzistues të licencave dhe Shtetit;

B. do të pajisë Investitorin e Projektit me të gjitha pëlqimet, heqjet dorë dhe lejet në lidhje me të drejtat sipas licencës ekzistuese, në mënyrë që të mundësojë implementimin e papenguar të aktiviteteve të Projektit; dhe

C. do të përcaktojë kompensimin (nëse ka) e pagueshëm, duke përjashtuar të gjitha kompensimet e tjera nga Investitori i Projektit të mbajtësit ekzistues të licencave,

dhe Palët pranojnë dhe bien dakord se nëse lidhet një marrëveshje e tillë, kompensimi, në shumën e llogaritur në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës, lidhur me privilegjet e humbura (nëse ka), të cilat do të ishin marrë nga pala shtetërore apo nga autoriteti lokal përkatës sipas licencës ekzistuese nëse jo për efektin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të Projektit do të jetë i pagueshëm nga Investitori i Projektit të palë shtetërore apo autoritet lokal përkatës;

ii) Shteti do të bëjë përpjekjet më të mira për të lehtësuar përfundimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së referuar në paragrafin 3.5 (b) (i);

iii) nëse Investitori i Projektit është, sipas këndvështrimit të tij, i paafte të arrijë një marrëveshje me mbajtësit ekzistues të licencave sipas kushteve që Investitori i Projektit i konsideron të arsyeshme, ai mund të njoftojë Shtetin e këtij të fundit dhe:

A. Shteti:

I) sipas shumës së kompensimit që do t'i paguhet mbajtësit ekzistues të licencave mbi mbajtësit ekzistues të licencave mbi të cilën është rënë dakord, do të veprojë për të pajisur Investitorin e Projektit me të drejtat përkatëse sipas kujtesës së kësaj shtojce;

II) do të zvogëlojë çdo ekspozim që ka Shteti në përputhje me licencën ekzistuese; dhe

III) do të përftojë marrëveshjen e Investitorit të Projektit përpara pagesës së kompensimit kundrejt mbajtësit ekzistues të licencave, me kusht që kjo marrëveshje nuk do të ndalohej nëse shumën e propozuar e kompensimit pasqyron parimet e planit të rehabilitimit të jetesës; dhe

B. Investitori i Projektit do t'i paguajë:

I) mbajtësit ekzistues të licencave atë sa është rënë dakord mbi kompensimin; dhe

II) kompensimin në shumën e llogaritur në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës, lidhur me privilegjet e humbura (nëse ka), të cilat do të ishin marrë nga pala shtetërore apo nga



autoriteti lokal përkatës sipas licencës ekzistuese nëse jo për efektin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të Projektit.

3.6 Ndhimja me kërkesat pranë autoritetit lokal

Shteti do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Investitorin e Projektit në sigurimin e çdo të drejte ose privilegji, që mund t'i jepet ose mund t'i jetë dhënë nga çdo autoritet lokal, që mund të jetë në mospërputhje apo në kundërshtim me, ose që mund të kufizojë apo ndërhyjë në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe privilegjeve të mbajtura nga pjesëmarrësi në Projekt, në bazë të ndonjë marrëveshjeje të Projektit, ose që i janë dhënë në bazë apo në përputhje me këtë Marrëveshje.

4. TOKA E PROJEKTIT DHE LIGJI SHQIPTAR

4.1 Pa kufizuar paragrafin 3.1, Shteti autorizon Këshillin e Ministrave, Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe çdo autoritet shtetëror të përcaktuar nga secili prej tyre për t'i akorduar Investitorit të Projektit këto të drejta servituti sipas nenit 265 të Kodit Civil dhe nenit 50 të ligjit për gazin (procesi për të cilin është përcaktuar në pjesën 2 të kësaj shtojce) lidhur me tokën e Projektit, siç mund të kërkohej, në mënyrë që të zbatohen detyrimet e Shtetit sipas kësaj shtojce sa u takon të drejtave përkatëse.

4.2 Pranohet se zbatimi i nenit 28 të ligjit për shpronësimin është i kufizuar në pronën private mbi të cilën është marrë një vendim shpronësimi. Për aq sa është e nevojshme për të mundësuar ose lehtësuar zbatimin e detyrimeve të Shtetit sipas kësaj Marrëveshjeje lidhur me të drejtat përkatëse, ky kufizim nuk do të zbatohet për qëllime të marrjes së tokës joshtetërore në përdorim të përkohshëm. Kjo pronë private, në përputhje me paragrafin 4.2 dhe me standardet e përcaktuara në pjesën 2 të shtojcës 2, mund të merret në përputhje me nenin 28 të ligjit për shpronësimin, pavarësisht nga fakti nëse është marrë një vendim përkatës shpronësimi.

5. HYRJA NË TOKËN E PROJEKTIT NË FAZËN PËRPARA NDËRTIMIT

5.1 Aktivitetet e Investitorit të Projektit

a) Në lidhje me tokën joshtetërore, gjatë fazës përpara ndërtimit, Palët pranojnë se nevoja për të hyrë në diskutime dhe për të bërë përpjekje për të arritur marrëveshje të negociueshme me pronarët përkatës të tokës dhe personat e prekur, në mënyrë që të përftohet hyrja në tokën joshtetërore, e nevojshme për të bërë të mundur që Investitori i Projektit dhe pjesëmarrësit e tjerë në Projekt të kryejnë ato aktivitete të Projektit, të cilat janë të nevojshme apo të dëshirueshme të kryhen për t'i paraprirë ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit, përfshirë këtu edhe sa i takon mbledhjes së informacionit kadastral dhe atij lidhur me pronësinë dhe përdorimin e tokës dhe nëse Investitori i Projektit vendos kështu kërkitime/hulumtime paraprake lidhur me materiale arkeologjike dhe të rrezikshme.

b) Nëse gjatë fazës përpara ndërtimit, pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme të Investitorit të Projektit, ky i fundit e ka të pamundur që të arrijë një marrëveshje të arsyeshme përmes së cilës ai mund të sigurojë hyrjen në tokën joshtetërore sipas kushteve të arsyeshme për qëllime të ushtrimit të aktiviteteve të Projektit, që janë të kërkueshme apo të dëshirueshme për t'u kryer përpara ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit, Investitori i Projektit mund të njoftojë lidhur me këtë Shtetin dhe Shteti do të procedojë në përputhje me paragrafin 5.2 (a).

c) Sa i përket tokës shtetërore, gjatë fazës përpara ndërtimit, Investitori i Projektit mund të njoftojë Shtetin se ai dhe pjesëmarrësit e tjerë në Projekt kërkojnë hyrje në tokën shtetërore për qëllime të kryerjes së aktiviteteve të Projektit, të cilat janë të nevojshme apo të kërkueshme të kryhen përpara ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit dhe Shteti do të vazhdojë të procedojë në përputhje me paragrafin 5.2 (b).

d) Pranohet se Investitori i Projektit do të fillojë aktivitetin e parashikuar në paragrafët (a) dhe (b), këtu më sipër, përpara datës efektive dhe, gjithashtu, duhet të ketë njoftuar Shtetin, siç është parashikuar në paragrafët (b) dhe (c), këtu më sipër, lidhur me tokën joshtetërore përpara asaj date. Në datën efektive, Shteti do ta konsiderojë menjëherë këtë njoftim si të kryer në përputhje me

paragrafët (b) dhe (c), këtu më sipër, dhe do të vazhdojë të procedojë në përputhje me paragrafin 5.2 (b) menjëherë pas datës efektive.

5.2 Aktivitetet shtetërore

a) Sa i përket tokës joshtetërore, nëse Shteti merr njoftim nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 5.1(a), Shteti, në përputhje me ligjin shqiptar, do të fillojë menjëherë dhe do të kryejë proceset e referuara në paragrafin 4.2, në mënyrë që të sigurojë që Investitori i Projektit të pajiset me të drejtat përkatëse që ai kërkon.

b) Sa i përket tokës shtetërore, nëse Shteti merr njoftim nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 5.1(c), Shteti, në përputhje me ligjin shqiptar, do të sigurojë menjëherë që Investitori i Projektit të pajiset me aksesin që ai kërkon.

6. IDENTIFIKIMI I TOKËS SË KËRKUAR PËR PROJEKTIN

6.1 Faza e 1-rë – faza përpara ndërtimit

a) Korridori i Interesit

Palët pranojnë Korridorin e Interesit dhe bien dakord se Korridori i Interesit pasqyron, në datën bazë, tokën që Investitori i Projektit konsideron se mund të kërkohet për aktivitetet e Projektit. Mendohet që Korridori i Interesit do të ripërcaktohet si inxhinieria e të ardhurave të Sistemit të Gazsjellësit.

b) Zona e preferuar e Projektit

i) Në vijim të punimeve dhe konsultimeve inxhinierike me palët përkatëse të interesuara, bazuar në Korridorin e Interesit, Investitori i Projektit do të zgjedhë zonën e preferuar për Projektin, të cilën Investitori i Projektit konsideron se do të kërkohet për zbatimin e mëtejshëm të aktiviteteve të Projektit dhe do të njoftojë Shtetin lidhur me të.

ii) Njoftimi i kryer nga Investitori i Projektit sipas paragrafit 6.1 (b) (i) do të përfshijë hartat dhe diagramet që përcaktojnë zonën e preferuar të Projektit, si dhe një përshkrim ku përcaktohen bazat për përzgjedhjen e zonës së preferuar për Projektin.

iii) Ndërkohë që zona e preferuar për Projektin do të bazohet në Korridorin e Interesit, Palët pranojnë se devijimet nga Korridori i Projektit mund të jenë të nevojshme për të rregulluar/përshtatur rezultatet e analizës së mëtejshme dhe përmirësimin e itinerarit.

iv) Brenda [40] ditësh pune nga marrja e njoftimit të zonës së preferuar për Projektin nga Investitori i Projektit, Shteti do të sigurojë komentet e tij me shkrim (nëse ka) lidhur me zonën e preferuar për Projektin.

c) Toka e kërkuar për Projektin

i) Në vijim të punimeve dhe konsultimeve inxhinierike me palët përkatëse të interesuara bazuar në zonën e preferuar për Projektin, Investitori i Projektit do të njoftojë Shtetin lidhur me tokën e kërkuar për Projektin dhe të drejtat e veçanta përkatëse, që kërkohen në çdo pjesë të tokës së kërkuar për Projektin.

ii) Pa kufizuar parimet e përgjithshme të paragrafit 6.1 (c) (i), synohet që:

A. Korridori i Ndërtimit, përgjithësisht, do të ketë një gjerësi prej 38 metrash, sipas zonave të caktuara, të cilat janë më të gjera për të pasqyruar inxhinierinë e Sistemit të Gazsjellësit dhe metodologjinë e ndërtimit të projektuar për Sistemin e Gazsjellësit;

B. Korridori i Sistemit të Gazsjellësit (përveç tokës së infrastrukturës), do të ketë, përgjithësisht, një gjerësi prej 18 metrash, ku tubacioni shtrihet në qendër të Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit;

C. Të drejtat përkatëse mbi tokën e infrastrukturës, konsiderohet se janë të drejtat e pronësisë që i janë atribuar Investitorit të Projektit;

D. Të drejtat përkatëse mbi Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit do të konsiderohen të drejta servituti, të cilat i janë atribuar Investitorit të Projektit, të cilat në përgjithësi do të kenë një gjerësi prej 8 metrash, siç është përcaktuar në paragrafin (B) më sipër dhe pjesën 3 të shtojcës 2;



E. Të drejtat përkatëse mbi tokën e përkohshme do të konsiderohen të drejta qiraje, të cilat i janë atribuar Investitorit të Projektit; dhe

F. Të drejtat përkatëse mbi tokën e hyrjes në rrugë do të konsiderohen të drejtat e pronësisë që i janë atribuar Shtetit.

iii) Njoftimi i marrë nga Investitori i Projektit sipas paragrafit 6.1 (c) (i) do të përfshijë hartat dhe diagramet e tokës së kërkuar për Projektin të detajuar në një nivel të tillë që do t'i mundësojë Shtetit të zbatojë detyrimet e tij sipas kësaj shtojce në lidhje me përfundimin e të drejtave përkatëse të kërkuara mbi çdo pjesë të tokës së kërkuar për Projektin. Njoftimi do të përfshijë, gjithashtu, një përshkrim të shkruar ku do të përcaktohet baza për zgjedhjen e tokës së kërkuar për Projektin dhe mënyra sesi komentet, nëse ka, të bëra nga Shteti lidhur me zonën e preferuar për Projektin janë marrë në konsideratë.

iv) Toka e kërkuar për Projektin do të bazohet në zonën e preferuar për Projektin, gjithsesi devijimet në tokën e kërkuar për Projektin do të jenë të lejueshme me kusht që:

A. Në momentin e identifikimit të tokës së kërkuar të Projektit sipas paragrafëve 6.1 (c) (i), Investitori i Projektit do të identifikojë ato devijime (nëse ka), që janë kryer nga zona e preferuar e Projektit së bashku me një përshkrim lidhur me arsyen pse janë kryer këto devijime; dhe

B. Brenda 40 ditësh pune nga marrja e njoftimit lidhur me këto devijime, Shteti mund të sigurojë komentet e veta (nëse ka) lidhur me këto devijime.

6.2 Faza e 2-të – faza pas ndërtimit të Projektit

a) Në momentin kur Investitori i Projektit do të vlerësojë se faza e ndërtimit ka përfunduar, ai do të njoftojë Shtetin dhe do të heqë dorë nga të gjitha të drejtat përkatëse mbi tokën e përkohshme.

b) Në çdo kohë dhe herë pas here, pas përfundimit të Sistemit të Gazsjellësit, Investitori i Projektit mund të njoftojë Shtetin se zona të caktuara të tokës së përhershme nuk janë më të nevojshme për aktivitetet e Projektit (toka e tepërt).

c) Nëse toka e tepërt është përfutur sipas parashikimeve të përcaktuara në pjesën 2 të kësaj shtojce, Investitori i Projektit do t'i njohë pronarit të shpronësuar të drejtën për të rimarrë të gjitha të drejtat përkatëse mbi tokën e tepërt pa kundërshtpërblim ose me një kundërshtpërblim simbolik para zbatimit të paragrafit 6.2 (e).

d) Njoftimi i marrë nga Investitori i Projektit sipas paragrafit 6.2 (b) do të përfshijë hartat dhe diagramet e tokës së tepërt të detajuar në një nivel të tillë që do t'i mundësojë Shtetit të heqë të drejtat përkatëse mbi tokën e tepërt së bashku me bazat për zgjedhjen e tokës së tepërt, si dhe një njoftim të Investitorit të Projektit lidhur me rezultatet e parashikimeve të paragrafit 6.2 (c).

e) Menjëherë pas marrjes së njoftimit nga Investitori i Projektit sipas paragrafit 6.2 (b), Shteti do të pajisjet me të gjitha të drejtat përkatëse mbi tokën e tepërt, që nuk është kthyer sipas paragrafit 6.2 (c) për t'u marrë në konsideratë ose jo në përputhje me ligjin shqiptar. Asnjë taksë nuk do të jetë e pagueshme në lidhje me këtë përfundim. Investitori i Projektit do të sigurojë të gjithë asistencën e arsyeshme që Shteti mund të kërkojë lidhur me zbatimin e këtij përfundimi.

6.3 Faza e 3-të – faza(t) e zgjerimit

Nëse në çdo kohë dhe herë pas here, Investitori i Projektit dëshiron të zgjerojë, të shtyjë apo të ndërmarrë punime lidhur me Sistemin e Gazsjellësit dhe kërkon tokë Projekti shtesë qoftë për një kohë të gjatë, qoftë për qëllime ndërtimi, dispozitat e kësaj shtojce do të zbatohen *mutatis mutandis* për çdo të drejtë përkatëse shtesë të kërkuar për kryerjen e këtij zgjerimi, shtyrje apo punimeve materiale.

7. PËRFTIMI I TË DREJTAVE PËRKATËSE MBI TOKËN E KËRKUAR TË PROJEKTIN

7.1 Aktivitetet e Investitorit të Projektit

a) Pas identifikimit të tokës së kërkuar për Projektin nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 6.1, të drejtat përkatëse të kërkuara mbi atë pjesë të tokës së kërkuar për Projektin do

të përftohen qoftë drejtpërdrejt nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 7.1 ose nga Shteti në përputhje me paragrafin 7.2.

b) Për aq sa të drejtat përkatëse mbi tokën e kërkuar për Projektin lidhen me tokë joshtetërore, Palët pranojnë nevojën për të tentuar të sigurojnë ato të drejta përkatëse në përputhje me procedurat e negocimit të përshkruara në planin e rehabilitimit të jetesës, përfshirë këtu atë pjesë të planit të rehabilitimit të jetesës në të cilin përcaktohet udhëzimi për përfitim të tokës dhe kompensimin ose “GLAC” (procedurat e negocimit).

c) Synohet që shpronësimi i të drejtave përkatëse lidhur me tokën joshtetërore do të përdoret vetëm pasi negocimet për marrëveshjet ose zgjidhjet në përputhje me procedurat e negocimit, të vërtetuara nga Investitori i Projektit, të kenë dështuar në lidhje me përfitim të këtyre të drejtave përkatëse. Në rast dështimi, Investitori i Projektit mund të njoftojë Shtetin lidhur me këtë dhe Shteti do të procedojë në përputhje me paragrafin 7.2 (b).

d) Për aq sa të drejtat përkatëse mbi tokën e kërkuar për Projektin lidhen me tokë shtetërore, Investitori i Projektit do të konsultohet me personat e prekur, të cilët nuk janë palë shtetërore lidhur me atë tokë dhe do të përpiqen të pajisen me të drejtat përkatëse të personave të prekur përmes zgjidhjeve të negociuara në përputhje me procedurat e negocimit që do të zhvillohen sipas procedurave të negocimit. Pas drejtimit të këtyre të drejtave përkatëse ose nëse Investitori i Projektit vërteton se ai ka dështuar në drejtimin e ndonjë të drejte përkatëse, Investitori i Projektit do të njoftojë Shtetin lidhur me të drejtat përkatëse të mbetura, të cilat janë të nevojshme, si dhe lidhur me tokën shtetërore të zbatueshme dhe Shteti do të veprojë në përputhje me paragrafin 7.2 (c) dhe dispozitat e planit të rehabilitimit të jetesës për të gjitha të drejtat përkatëse të padresuara të personave të prekur.

7.2 Aktivitetet shtetërore

a) Palët shtetërore do të asistojnë Investitorin e Projektit gjatë përpjekjeve të tij për t'u pajisur me të drejtat përkatëse mbi tokën e kërkuar për Projektin në përputhje me procedurat e negocimit.

b) Sa i përket tokës joshtetërore, nëse Shteti merr njoftim nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 7.1 (c), Shteti do të ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që këto të drejta përkatëse t'i akordohen Investitorit të Projektit sipas procedurës së parashikuar në pjesën 2 të kësaj shtojce.

c) Në lidhje me tokën shtetërore, nëse Shteti merr njoftim nga Investitori i Projektit në përputhje me paragrafin 7.1 (d), Shteti do të ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që këto të drejta përkatëse t'i akordohen Investitorit të Projektit.

7.3 Toka për përmirësimin e rrugëve

a) Të drejtat përkatëse mbi tokën për përmirësimin e rrugëve do të përftohen në emër të Shtetit, pavarësisht nëse ky përfitim ndërmerret nga Shteti apo nga Investitori i Projektit në përputhje me parashikimet e planit të rehabilitimit të jetesës. Shteti do të mbajë këto të drejta përkatëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

b) Shteti, menjëherë me paraqitjen e kërkesës nga Investitori i Projektit, do t'i vërë në dispozicion Investitorit të Projektit tokën për përmirësimin e rrugëve së bashku me rrugën publike me të cilën lidhet toka për përmirësimin e rrugëve, me qëllim zbatimin e punimeve për hyrjen në rrugën publike.

8. KOMPENSIMI FINANCIAR

8.1 Aktivitetet e Investitorit të Projektit

a) Nëse Investitori i Projektit fiton hyrjen në tokën e Projektit për qëllimet e përshkruara në paragrafin 5.1 (a) ose 5.1 (c), Investitori i Projektit do të paguajë kompensim financiar kundrejt personave përkatës të prekur në përputhje me:

i) kushtet/afatet mbi të cilat Investitori i Projektit dhe personat përkatës të prekur kanë rënë dakord; ose



ii) nëse nuk është rënë dakord mbi kushtet/afatet, në një nivel të pajtueshëm me parimet e përcaktuara në planin e rehabilitimit të jetesës.

b) Nëse Investitori i Projektit fiton të drejtat përkatëse mbi tokën joshtetërore ose nëse Shteti fiton të drejtat përkatëse mbi tokën për përmirësimin e rrugëve, e cila është tokë joshtetërore:

i) përmes marrëveshjeve të negociuara ose zgjidhjeve të negociuara, Investitori i Projektit do të paguajë kompensimin financiar kundrejt personave përkatës të prekur në përputhje me afatet/kushtet e këtyre marrëveshjeve apo zgjidhjeve të negociuara;

ii) përmes procedurës së përcaktuar në pjesën 2 të kësaj shtojce, atëherë, pavarësisht se këto të drejta përkatëse janë fituar nga Shteti dhe më pas i janë transferuar Investitorit të Projektit, Investitori i Projektit do të paguajë kompensimin financiar kundrejt personave përkatës të prekur në një nivel të përputhshëm me parimet e përcaktuara në planin e rehabilitimit të jetesës, një vlerësim i arsyeshëm i totalit të atij kompensimi financiar, që do të vendoset në një llogari *escrow* përpara fillimit të procedurës së përcaktuar në pjesën 2.

c) Nëse Investitori i Projektit fiton të drejtat përkatëse mbi tokën shtetërore, Investitori i Projektit:

i) për aq sa një person i prekur nuk është palë shtetërore, do të paguajë kompensim financiar në përputhje me afatet/kushtet e marrëveshjes apo zgjidhjes së negociuar, ose nëse nuk ekziston asnjë marrëveshje apo zgjidhje e negociuar, në një nivel të përputhshëm me parimet e përcaktuara në planin e rehabilitimit të jetesës; dhe

ii) për aq sa një person i prekur është palë shtetërore, paguan kompensim financiar në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës.

8.2 Detyrimet e Shtetit

Shteti do të kryejë të gjitha përpjekjet e mundshme për të lehtësuar pagesën e kompensimit nga Investitori i Projektit kundrejt personave të prekur, siç parashikohet në shtojcën 1, përfshirë këtu, mbi bazën e kërkesës së Investitorit të Projektit:

a) ndihmën për themelimin e komiteteve apo organizatave të tjera për të ndihmuar në lëvrimin e kompensimit personave të prekur; dhe

b) lehtësimin, sipas mënyrës së rënë dakord midis palëve, e hapjes së llogarive *escrow* apo llogarive të tjera bankare për të asistuar në lëvrimin e kompensimit personave të prekur.

8.3 Kufizimi i pretendimeve lidhur me përdorimin e tokës të filluar pas datës së ndërprerjes

Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje apo të ligjit shqiptar të kundërt, asnjë përdorues joformal i tokës së kërkuar për Projektin, nuk do të konsiderohet si “person i prekur” për qëllime të përfuturit të kompensimit, qoftë në përputhje me këtë Marrëveshje ose sipas ligjit shqiptar kur ka nisur ky përdorim informal i tokës, pas datës së ndërprerjes që do të përcaktohet nga Investitori i Projektit dhe, më pas, do të publikohet në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës.

9. HYRJA E EMERGJENCËS

a) Nëse sipas opinionit të arsyeshëm të Investitorit të Projektit, ekziston një situatë emergjence në lidhje me Sistemin e Gazsjellësit, pjesëmarrësit në Projekt:

i) sa më shpejt që të jetë e praktikueshme, do të njoftojnë autoritetet shtetërore të situatës emergjente;

ii) do të kenë të drejtë të hyjnë dhe do të kalojnë përmes të gjitha tokave joshtetërore dhe të gjitha tokave shtetërore (përveç tokës shtetërore që është objekt i ushtrisë, sigurisë apo ndonjë forme tjetër përdorimi nga ana e Shtetit, e cila kërkon që të gjithë personat të pajisen me leje sigurie përpara hyrjes) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për qëllime të hyrjes në pjesët përkatëse të Sistemit të Gazsjellësit në mënyrën më të përshtatshme të mundshme për të drejtuar atë situatë emergjence dhe (për aq sa është e mundur sipas rrethanave, njoftimin paraprak të pronarit të tokës për hyrjen në tokën në fjalë); dhe

iii) do të jetë i përgjegjshëm për çdo dëm të shkaktuar ndaj ndonjë toke joshtetërore apo toke shtetërore si rezultat i asaj hyrje dhe kalimi.

b) Palët shtetërore do të kryejnë çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të specifikuar në paragrafin 9 (a) (ii) nga pjesëmarrësit në Projekt.

c) Nëse një pjesëmarrës në Projekt hyn apo kërkon të hyjë në tokë sipas të drejtës së specifikuar në paragrafin 9 (a) (ii), pjesëmarrësi në Projekt do të njoftojë pronarët e prekur të tokës sa më shpejt që të jetë e mundur lidhur me këtë hyrje apo me qëllimin për të hyrë, sipas rastit.

PJESA 2

PROCEDURA PËR SHPRONËSIMIN E TOKËS JOSHTETËRORE DHE AKORDIMIN E TË DREJTAVE PËRKATËSE INVESTITORIT TË PROJEKTIT

Shteti, përmes METE-s dhe pas depozitimit të aplikimit për shpronësim pranë METE-s nga Investitori i Projektit, në përputhje me ligjin për shpronësimin (përfshirë bashkëlidhjen e dokumenteve të kërkuara nga neni 10 i ligjit për shpronësimin, nëse ky nen është në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje), dhe në përputhje me politikat mjedisore dhe sociale (cilado qoftë më e saktë), ku kërkohej shpronësimi i titullit të pronësisë dhe/ose kufizimi i të drejtave të pronësisë për shkak të kërkesave të Investitorit të Projektit për të ushtruar dhe për të gëzuar të drejtat e servitutit në lidhje me Projektin mbi tokën e caktuar (duke përcaktuar këtë tokë dhe pronarët përkatës të saj), (aplikimi për shpronësim):

a) do të themelojë një komitet të posaçëm për ndjekjen dhe zbatimin e procesit të shpronësimit;

b) do të analizojë dhe do të verifikojë informacionin e përcaktuar në aplikim dhe në dokumentet përkatëse bashkëngjitur;

c) do të pranojë aplikimin për shpronësim duke njoftuar Investitorin e Projektit;

d) brenda 10 ditëve nga pranimi i njoftimit, METE dhe Investitori i Projektit do të lidhin një marrëveshje në të cilën do të parashikohen procedurat dhe kushtet e shpronësimit, në formën e aktit noterial dhe ku do të bashkëngjiten të gjitha dokumentet shoqëruese të aplikimit për shpronësim;

e) brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së lartpërmendur, METE do të njoftojë direkt (qoftë me postë të regjistruar ose përmes mjetesh të tjera njoftimi, që konfirmojnë se njoftimi është marrë nga marrësi; nëse marrësi banon jashtë shtetit, njoftimi do të kryhet përmes publikimit në komunën/bashkinë në të cilën ndodhet toka objekt i shpronësimit) personat e prekur nga shpronësimi dhe do të publikojë aplikimin për shpronësim në Fletoren Zyrtare, si dhe në një gazetë kombëtare dhe lokale;

f) METE do t'i propozojë Këshillit të Ministrave që të miratojë shpronësimin jo më herët se një muaj nga dita e përfundimit të procedurës së përshkruar në (e) këtu më sipër;

g) METE do të transferojë dosjen e shpronësimit për miratim të Këshilli i Ministrave;

h) brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e miratimit të shpronësimit përmes vendimit të Këshillit të Ministrave, METE do të transferojë dhe do të regjistrojë pranë zyrës përkatëse të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme titullin e pronësisë mbi tokën e shpronësuar në emër dhe në pronësi të Shtetit në rast të shpronësimit të titullit të pronësisë ose do të regjistrojë në emër dhe titull të Shtetit të drejtat e servitutit sipas shpronësimit;

i) do të transferojë tek Investitori i Projektit titullin e pronësisë mbi tokën e shpronësuar dhe/ose servitutit, sipas rastit, që do të regjistrohet në emër të Investitorit të Projektit, me kusht që dhe nëse Investitori i Projektit ka përfunduar ndërtimin e infrastrukturës shqiptare.



PJESA 3

KONTEKSTI I TOKËS SË PROJEKTIT

1. KONTEKSTI PËR IDENTIFIKIMIN E TOKËS SË PROJEKTIT

1.1 Palët pranojnë se zgjedhja e itinerarit të Sistemit të Gazsjellësit, përfshirë të drejtave përkatëse dhe zbatimi i aktiviteteve të Projektit mund të kenë ndikim ekonomik apo mjedisor dhe mund të çojnë në zhvendosje ekonomike apo fizike. Me këto shqetësime në mendje, Investitori i Projektit dhe Shteti do të bashkëpunojnë për të drejtuar këto rreziqe të ndikimit apo zhvendosjes së mundshme në përputhje me kërkesën e performancës 5 të politikës mjedisore dhe sociale dhe proceset e theksuara në këtë shtojcë.

1.2 Palët pranojnë se identifikimi i tokës së kërkuar për Projektin dhe të drejtat përkatëse do të ndërmerren:

a) në kontekstin e zhvillimit inxhinierik të Projektit (përfshirë këtu zhvillimin e projektit inxhinierik fillim-fund dhe projektin vijues të detajuar);

b) në mënyrë të tillë që të merren në konsideratë kërkesat nga palët shtetërore dhe sugjerimet nga palët e tjera të interesuara;

c) të optimizojë Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit dhe konfigurimin e tij për qëllime ndërtimi dhe tregtare;

d) në mënyrë të tillë që të marrë në konsideratë realizueshmërinë teknike dhe tregtare, sigurinë (gjatë dhe pas ndërtimit), natyrën e përmbajtjes tokësore dhe hapësinore, çështjet mjedisore dhe sociale, kostot, programin dhe veprimtarinë përfundimtare të Sistemit të Gazsjellësit;

e) në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me palët përkatëse të interesuara, popullatat e prekura dhe palët përkatëse shtetërore dhe autoritetet lokale, me çështjet, proceset dhe vendimet përkatëse që do të dokumentohen në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social;

f) të mënjanohen aq sa është e arsyeshme ndikimet lidhur me zonat e përcaktuara si “zona ku ndalohet kalimi”, përfshirë këtu instalimet ushtarake, zonat me mbrojtje të lartë, zonat urbane dhe toka dhe resurset e shënuara për zhvillimin në interes publik; dhe

g) me qëllim minimizimin e ndikimit negativ social, mjedisor dhe në komunitet.

2. REHABILITIMI I JETESËS

2.1 Palët pranojnë përfitimet që do të dorëzohen nga pjesëmarrja e të gjitha palëve të interesuara (përfshirë këtu personat dhe autoritetet lokale përkatëse të prekura drejtpërdrejt nga zbatimi fizik i Sistemit të Gazsjellësit) në zhvillimin e itinerarit të Sistemit të Gazsjellësit. Për këtë qëllim, Investitori i Projektit, në konsultim me palët përkatëse të interesuara, do të zhvillojë një ose më shumë plane për rehabilitimin e jetesës që synojnë zvogëlimin e ndikimit të drejtpërdrejtë që zbatimi fizik i Sistemit të Gazsjellësit mund të ketë te personat e prekur. Pa kufizuar sa më sipër, Palët do të bashkëpunojnë për zhvillimin e planit për rehabilitimin e jetesës, së bashku me çdo kuadër për rehabilitimin e jetesës dhe çdo udhëzim drejt përfuturit të tokës dhe kompensimit të saj ose “GLAC” që mund të krijohet sipas apo si pjesë e planit për rehabilitimin e jetesës.

2.2 Çdo plan për rehabilitimin e jetesës do të përcaktojë parimet e përgjithshme të kompensimit për çdo të drejtë takuese dhe, në rast të të drejtave përkatëse që do të fitohen lidhur me tokën e kërkuar të projektit, do të shërbejë si bazë për procedurat e negociimit dhe vlerat e kompensimit dhe do të garantojë se nevojat e veçanta të grupeve të prekshme (siç përcaktohet në politikat mjedisore dhe sociale) do të merren në konsideratë.

2.3 Plani për rehabilitimin e jetesës do të zbatohet me qëllim që kushtet e rehabilitimit dhe të jetesës së të gjithë personave të prekur të rikthehen në nivelin që ato do të kishin arritur nëse aktivitetet e Projektit nuk do të ishin kryer.

2.4 Në rast se zbatimi i Projektit kërkon zhvendosje fizike, Palët dhe palët e tjera të interesuara (përfshirë këtu autoritetet shtetërore, autoritetet lokale dhe personat e prekur nga zbatimi i Sistemit të Gazsjellësit) do të bien dakord të risistemojnë planin e veprimit, që ndër të tjera, do të garantojë se personat e prekur do të marrin:

- a) ndihmë gjatë zhvendosjes;
- b) zmadhim strehimi në shesh me hyrje të krahasueshme me oportunitete ekonomike, infrastrukturë civile dhe shërbime komunitare;
- c) tokë sipas një regjimi të barabartë ose më të mirë se ai i humbur nga personi i prekur;
- d) asistencë zhvillimi, si për shembull: përgatitja e tokës, lehtësira kreditimi, trajnime apo mundësi punësimi; dhe
- e) asistencë për t'u integruar ekonomikisht dhe shoqërisht në komunitetet pritëse.

2.5 Në rast se përfundimi i të drejtave përkatëse kërkon zhvendosje fizike të personave, ky përfundim nuk do të finalizohet deri në momentin e arritjes së një niveli të përshtatshëm kompensimi dhe asistence për të minimizuar ndikimin negativ mbi personat e prekur.

2.6 Palët pranojnë nevojën për të publikuar planet për rehabilitimin e jetesës dhe, nëse është e aplikueshme, planet e veprimtimit për risistemim në nivel lokal në mënyrë të tillë që të jetë e aksesueshme në kohë, e kuptueshme dhe kulturalisht e përshtatshme për të prekurit. Planet përfundimtare do të bëhen të njohura përpara fillimit të çdo ndërtimi lidhur me aktivitetet e përhershme në zonën e prekur.

2.7 Palët pranojnë, gjithashtu, nevojën për të krijuar mekanizma rregullatorë lokalë të pavarur për ankesat bazuar në institucionet sociale dhe kulturore të të prekurve për të zgjidhur ankesat dhe për të drejtuar ankesat/prendimet në kohën e duhur, në mënyrë të paanshme dhe transparente. Nëse në fillim të funksionimit të Sistemit të Gazsjellësit, rehabilitimi i jetesës nuk ka përfunduar, atëherë do të vihen në zbatim masa të reja për të garantuar rezultate të kënaqshme.

3. MINIMIZIMI I NDIKIMIT NEGATIV TË AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT

Palët pranojnë rëndësinë e minimizimit të ndikimit negativ të zbatimit të aktiviteteve të Projektit, veçanërisht të ndërtimit lidhur me aktivitetet e Projektit mbi personat e prekur. Në këtë kuptim, më tej, Palët pranojnë nevojën për të vepruar në përputhje me planet për rehabilitimin e jetesës dhe, në veçanti:

- a) për të kryer të gjitha shpimet eksperimentale, kanalizimet e studimeve, lëniet e pajisjeve mbi tokën e Projektit dhe ngritjen e rrugëve hyrëse të përkohshme, në çdo rast, siç mund të kërkohej përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, me sa më pak shqetësime që të jetë e mundur dhe pas konsultimit me personat e prekur;

- b) për të pajisur personat e prekur me një njoftim paraprak jo më pak se 120 ditë përpara lidhur me qëllimin e tij për të filluar punimet e ndërtimit mbi tokën e kërkuar për Projektin;

- c) për të zhvendosur, tubat, mjetet dhe makineritë për qëllime ndërtimi në përputhje me një program në gjuhën shqipe të vënë në dispozicion personave të prekur paraprakisht;

- d) për të mirëmbajtur të gjitha mjetet e hyrjes në tokën e kërkuar për Projektin, të cilat mund të jenë të nevojshme për qëllime të aktivitetit të Projektit dhe për aq sa është e nevojshme, për të ndërtuar dhe për të mirëmbajtur kryqëzime/udhëkalime të përshtatshme të përkohshme të rëna dakord të nevojshme për hyrjen në tokë pranë tokës së kërkuar për Projektin;

- e) për të ndjekur përfundimin e ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit, për të restauruar rrugët dhe rrugët e kalimtarëve në kushtet në të cilat ato kanë qenë përpara fillimit të ndërtimit, si dhe për t'i bërë ato të përdorshme në përputhje me afatet/kushtet e rëna dakord me Shtetin (në rast të ish-tokës shtetërore) ose me pronarët dhe pushtuesit përkatës (në rast të ish-tokës joshtetërore), sipas nevojës për të ruajtur sigurinë e Sistemit të Gazsjellësit dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të ardhshme të Projektit; dhe

- f) për të siguruar lehtësira për mirëmbajtjen dhe lejimin e mjeteve të komunikacionit dhe hyrjen midis pjesëve të çdo toke që ndodhet pranë tokës së kërkuar për Projektin dhe që është përkohësisht ose në mënyrë të përhershme e shpëputur si rezultat i drejtpërdrejtë i ndërtimit të Sistemit të Gazsjellësit nga Investitori i Projektit.



SHTOJCA 2
STANDARDET
PJESA 1
STANDARDET TEKNIKE DHE TË SIGURISË

Standardet e zbatueshme për gazsjellësit dhe stacionet:

1. Rregullat teknike dhe standardet e sigurisë në fuqi në Greqi (sipas vendimit të Ministrit nr. 666, datë 3 gusht 2009 nxjerrë sipas nenit 7 (2) të ligjit për gazin);

- | | |
|----------|---|
| 2. SE | Standard europian; |
| 3. DE | Direktiva europiane; |
| 4. ISKA | Instituti i Standardeve Kombëtare Amerikane; |
| 5. IAN | Instituti Amerikan i Naftës; |
| 6. SHAIM | Shoqata Amerikane e Inxhinierëve Mekanikë; |
| 7. SHATM | Shoqata Amerikane e Testimit dhe Materialeve; |
| 8. DNV | Det Norske Veritas; |
| 9. DIN | Deutsche Institut für Normung; |
| 10. KNET | Komisioni Ndërkombëtar Elektro-Teknik; |
| 11. OSN | Organizata e Standardeve Ndërkombëtare; |
| 12. UNT | Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit; |
| 13. SHSP | Shoqata e Standardizimit të Prodhuesve. |

Nëse, sipas ligjit shqiptar, çdo pjesëmarrësi në Projekt i kërkohet të jetë në përputhje me kërkesat lidhur me sigurinë dhe kërkesat lidhur me mbrojtjen e mjedisit, për aq sa përputhja me të dyja këto kërkesa nuk është arsyeshmërisht praktike, kërkesat lidhur me sigurinë do të kenë përparësi.

PJESA 2
STANDARDET E SIGURISË, TË SHËNDETIT, TË KOMUNITETIT DHE ATO
MJEDISORE E SOCIALE

1. Direktiva 85/337/EEC e Këshillit të Europës datë 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private.

2. Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Konventën Europiane mbi Aksesin në Informacion, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi në çështjet mjedisore (Aarhus, 1998).

3. Konventa Espoo.

4. Kërkesat e performancës në vijim, të detajuara në politikat sociale dhe mjedisore:

- a) PR 1: Menaxhimi dhe vlerësimi social dhe mjedisor;
- b) PR 2: Kushtet e punës;
- c) PR 3: Pakësimi dhe parandalimi i ndotjes;
- d) PR 4: Siguria, mbrojtja dhe shëndeti;
- e) PR 5: Përfitim i tokës, risistemimi jovullnetar dhe zhvendosja ekonomike;
- f) PR 6: Bashkëbisedimet e biodiversitetit dhe menaxhimi i pandërprerë i burimeve natyrore të jetesës;
- g) PR 7: Popujt indigjenë;
- h) PR 8: Trashëgimia kulturore;
- i) PR 10: Përhapja/zbulimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesuara.

5. Marrëveshja Globale Kompakte e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

6. Parimet udhëzuese për biznes dhe të drejtat e njeriut të nënshkruara nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në datën 16 qershor 2011.

7. Parimet vullnetare të sigurisë dhe të të drejtave të njeriut të zhvilluara nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara dhe të Mbretërisë së Bashkuar, shoqëri të caktuara në sektorët e nxjerrjes dhe të energjisë dhe organizata të caktuara joqeveritare.

8. Standardet sociale dhe mjedisore sipas specifikimeve të Manualit të Investimeve Strategjike të Komunitetit të krijuar dhe të përditësuar herë pas here nga Organizata Financiare Ndërkombëtare.

PJESA 3

KUFIZIMET DHE KËRKESAT E ZONAVE TË SIGURISË DHE TË KONSULTIMIT


Kufizimet dhe kërkesat e zonave të sigurisë dhe të konsultimit do të jenë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, si dhe me standardet përkatëse europiane (EN 1594:2009 të përditësuara herë pas here), përfshirë në lidhje me zonat e mëposhtme të sigurisë:

a) do të vendoset një fashë mbrojtëse për të kontrolluar të gjitha aktivitetet e palëve të treta, në mënyrë që të sigurohet Gazsjellësi nga ndërhyrjet. Bazuar në legjislacionin përkatës të zonave fqinje, kjo zonë do të ketë një gjerësi prej 8 m (4 m në çdo anë të Gazsjellësit);

b) do të krijohet një zonë sigurie për të garantuar një distancë të përshtatshme nga ndërtesat. Bazuar në legjislacionin përkatës të zonave fqinje, kjo zonë do të ketë një gjerësi prej 40 m (20 m në çdo anë të Gazsjellësit);

c) do të krijohet zona e kufizimit të ndërtimit me një gjerësi prej 400 metrash (që do të thotë 200 m nga secila anë e Gazsjellësit), në të cilën numri i shtëpive individuale do të administrohet në përputhje me rregulloren teknike të Greqisë nr. D3/A7ok.4303nE2610;

d) do të krijohet një zonë konsultimi në të cilën mund të tolerohen shtëpi të veçanta, por ato nuk do të përdoren nga shtëpitë, ndërtesat e përdorura nga popullata e prekshme (shkollat, spitalet, burgjet etj.) dhe/ose infrastruktura industriale që pret si një numër të madh njerëzish (>300) ose që janë specifikisht të ekspozuar ndaj zjarreve etj.



Shqipëria

Kufizime të ngjashme do të zbatohen lidhur me zonat e sigurisë dhe konsultimit përreth stacioneve të kompresorit dhe infrastrukturës tjetër të lidhur me këta gazsjellës. Gjerësia e këtyre zonave do të përcaktohet nga një vlerësim sasior i riskut.

SHTOJCA 3

LISTA E LEJEVE SHTETËRORE TË NEVOJSHME PËR PROJEKTIN

Nr.	Emrat e lejes/licencës/autorizimit përkatës	Ligjet sipas të cilëve leja/licenca/autorizimi është i nevojshëm	Autoriteti përgjegjës	Faza e projektit që do të kërkohet
1.	Leje e posaçme	Ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për gazin”	Këshilli i Ministrave	Planifikim
2.	Deklarata mjedisore	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar Ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar Ligji nr. 9424, datë 6.10.2005 “Për ratifikimin e “Protokollit për vlerësimin ndikimit strategjik në mjedis””	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Planifikim

3.	Miratimi për kalimin në pyll	Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimet pyjore”, i ndryshuar	(në varësi të sipërfaqes) Parlamenti / Këshilli i Ministrave / Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.	Planifikim
4.	Miratimi për kalimin në kullotat/livadhet	Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar	Këshilli i Ministrave / Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Planifikim
5.	Autorizimi për kalimin e rrugës	Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Për Kodin Rrugor”, i ndryshuar	Autoriteti Kombëtar i Rrugëve / bashkia / komuna / çdo entitet tjetër i autorizuar nga pushteti lokal ose nga koncesionarët privatë	Planifikim
6.	Miratimi për kalimin e Hekurudhës	Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”	Hekurudha Shqiptare (autoritet publik)	Planifikim
7.	Miratim me shkrim (trashëgimia kulturore)	Neni 47 i ligji nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar	Këshilli Kombëtar i Restaurimit / Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë	Planifikim Ndërtim
8.	Miratim me shkrim (mbrojtja nga zjarri)	Neni 34(1/a) i ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar	Mbrojtja nga Zjarri e Rrethit Policia e Shpëtimit	Planifikim
9.	Miratim me shkrim (shëndeti publik)	Neni 12 i ligjit nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”	Inspektorati i Shëndetit Publik të Rrethit	Planifikim
10.	Kërkesa për zhvillim	Neni 74 dhe 78 i ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar; Neni 11, 17 dhe 20 i vendimit	Bashkia ose komuna/ Ministria/ Këshilli Kombëtar i	Planifikim



		të KM nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme mbi kontrollin e zhvillimit të territorit”	Territorit	
11.	Leja mjedisore	Ligji nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar Ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet mjedisore”, i ndryshuar	Qendra Kombëtare e Licencimit	Ndërtim
12.	Licenca profesionale e ndërtimit	Vendim i KM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit / Komisioni i Posaçëm për Pajisjen me Licenca Profesionale	Planifikim
13.	Leja për ndërtim dhe zhvillim/ leja e Infrastrukturës	Neni 12 i vendimit të KM nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”	Bashkia ose Komuna/ Ministria/ Këshilli Kombëtar i Territorit	Planifikim
14.	Leja për përdorimin e ujit	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”	Këshilli i Basenit/ Këshilli Kombëtar i Ujit	Ndërtim
15.	Autorizimi për përdorimin e ujit	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”	Këshilli i Basenit / Këshilli Kombëtar i Ujit	Ndërtim
16.	Autorizimi për përdorimin e ujit	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”	Këshilli i Basenit / Këshilli Kombëtar i Ujit	Ndërtim
17.	Leja për shpimin e ujit	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”	Këshilli i Basenit/ Këshilli Kombëtar i Ujit	Ndërtim
18.	Autorizim i posaçëm për aktivitetet e ndërtimeve bregdetare	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”	Këshilli i Basenit/ Këshilli Kombëtar i Ujit	Ndërtim

19.	Leja e përdorimit	Neni 78 i ligjit nr. 10 119 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar	Bashkia ose komuna/ ministra	Ndërtim
20.	Licencat e lëshuara nga ERE	Ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar	Enti Rregullator i Energjisë	Operim
21.	Autorizimi i Inspektoratit të Punës	Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar	Inspektorati i Punës	Operim

SHTOJCA 4

PËRJASHTIMET NGA DHE NDRYSHIMET NË LIGJIN SHQIPTAR (përmes miratimit të një ligji të ri për modernizimin e infrastrukturës)

1. Neni 14 i ligjit nr. 9946, datë 30 qershor 2008 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nuk do të zbatohet për secilin transportues (në cilësinë e tij si i tillë) ose çdo transaksion të ndërmarrë sipas, ose për aktivitetet e kryera *upstream* rrjetit shqiptar lidhës sipas çdo MSHG-je shqiptare.

2. Standardet dhe proceset e përcaktuara në ligjin nr. 10 431, datë 9 qershor 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10 440, datë 7 korrik 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, dhe legjislacioni dytësor lidhur me secilin prej këtyre ligjeve, nuk do të zbatohet për pjesëmarrësit në Projekt për aq sa janë në kundërshtim me standardet dhe proceset e listuara në pjesën 2 të shtojcës 2 (në çdo rast siç mund të ndryshohet apo zëvendësohet herë pas here) dhe këto standarde dhe procese të listuara në pjesën 2 të shtojcës do të jenë të zbatueshme. Për më tepër, sipas lejes mjedisore, Investitorit të Projektit nuk do t’i kërkohej të fillojë aktivitetet e Projektit deri në datën, e cila përkon me pesë vite (në vend të dy viteve) pas datës në të cilën kjo leje është dhënë.

3. Sipas ligjit nr. 10 119, datë 23 prill 2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe legjislacioni dytësor lidhur me atë ligj, në bazë të lejes për ndërtimin e infrastrukturës shqiptare, Investitorit të Projektit nuk do t’i kërkohej fillimi i aktiviteteve të Projektit deri në datën që përkon me pesë vite (në vend të një viti) pas datës në të cilën është lëshuar leja. Më tej, ndryshimet janë bërë për aq sa është e nevojshme për të bërë efektiv nenin 28.6.

4. Dispozitat e nenit 28 të ligjit për shpronësimin, që kufizojnë zbatimin e nenit 28 për pronën private ku një vendim shpronësimi është marrë, nuk do të zbatohet për qëllime të marrjes së tokës joshtetërore në përdorim të përkohshëm. Kjo pronë private, në përputhje me këtë Marrëveshje, mund të merret sipas nenit 28 të ligjit për shpronësimin, pavarësisht nëse është marrë një vendim shpronësimi. Më tej, kufizimet dhe limitimet e të drejtës për të përdorur pasuritë e paluajtshme nga pronari dhe krijimi i të drejtave të servitutit në favor të palëve të treta sipas kësaj Marrëveshjeje do të pranohet dhe zbatohet si një formë shpronësimi sipas ligjit nr. 8561, datë 22 dhjetor 1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

SHTOJCA 5

PRANIME DHE KONFIRMIME LIDHUR ME APLIKIMIN E LIGJIT SHQIPTAR PËR TAKSAT

Në përputhje me nenin 24, pranimet dhe konfirmimet për aplikimin e ligjit shqiptar që u përkasin taksave është rënë dakord ndërmjet Palëve:

1. Taksa mbi ndikimin në zhvillim. Është pranuar dhe konfirmuar se, përveç detyrimeve sipas pikës 30.1 të Investitorit të Projektit, Investitori i Projektit është objekt i një rëndese tatimore



të vetme dhe jopërsëritëse prej 0,1% mbi vlerën e investimeve të infrastrukturës shqiptare në bazë të nenit 27 të sistemit të taksave vendore, ligji nr. 9632, datë 30 tetor 2006 dhe se asnjë rëndesë tjetër e ngjashme tatimore nuk do të aplikohet në vijim.

2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Është pranuar dhe konfirmuar se Investitori i Projektit është subjekt i taksave të parashikuara në nenin 9.2 dhe në nenin 20 deri në 25 të ligjit për taksat vendore (ligji nr. 9632, datë 30 tetor 2006 “Për sistemin e taksave vendore”), vetëm në rast se dhe për aq sa Investitori i Projektit do të ketë në pronësi ndërtesa dhe toka bujqësore. Është pranuar dhe konfirmuar se çdo pjesë fizike e Sistemit të Gazsjellësit që ndodhet nën tokë nuk kualifikohet si një ndërtesë në kontekstin e ligjit të cituar.

3. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Është pranuar dhe konfirmuar se Investitori i Projektit është subjekt i taksave të parashikuara në nenet 9.5 dhe 28 të ligjit për taksat vendore (ligji nr. 9632, datë 30 tetor 2006 “Për sistemin e taksave vendore”), i cili mund të zbatohet mbi çdo transferim të titullit të pronësisë mbi tokën dhe pasuritë e tjera të paluajtshme (të cilat janë pjesë e infrastrukturës shqiptare) në pronësi dhe të transferuara nga ai, përveç dhurimit të Shteti, i cili aktualisht është shprehimisht i përjashtuar në bazë të nenit 29 të të njëjtit ligj.

4. Taksa për studimet urbane. Është pranuar dhe konfirmuar se neni 51 i ligjit për urbanistikën (ligji nr. 8450, datë 17 shtator 1998 “Për urbanistikën”) është shfuqizuar dhe se në data base-in asnjë dispozitë e ngjashme, e cila zëvendëson apo ndryshon këtë ligj aplikohet mbi Investitorin e Projektit.

5. Standardet e zbatueshme të kontabilitetit. Është pranuar dhe konfirmuar se neni 19 i ligjit nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” lejon Investitorin e Projektit të llogarisë tatimin shqiptar mbi të ardhurat në bazë të llogarive të hartuara në përputhje me SNRF-në, objekt i rregullimeve tatimore të specifikuara në atë ligj. Për qëllime të tatimit shqiptar mbi të ardhurat referohet në pikën 24.6 të kësaj Marrëveshjeje dhe paragrafin 9 të kësaj shtojce 5.

6. Parimet e transferimit të çmimit. Është pranuar dhe konfirmuar se administrata shqiptare tatimore do të zbatojë Manualin e Transferimit të Çmimit për Ndërmarrjet Multinacionale dhe administratës tatimore të publikuara herë pas here nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në marrëveshjet midis Investitorit të Projektit dhe palëve të lidhura, sikurse parashikohet në nenin 7 dhe 9 të Marrëveshjes së Modelit Tatimor të OBEZH-it.

7. Trajtimi tatimor indirekt i importeve të gazit për mbushjen në linjën e parë dhe për konsum në stacionet kompresore. Është e njohur dhe e konfirmuar se:

a) gazi natyror i importuar nga Investitori i Projektit për mbushjen në linjën e parë është objekt i TVSH-së së importit për normën e zbatueshme dhe se kjo TVSH importi është e rimbursueshme nga Investitori i Projektit si importues dhe se importimi i gazit natyror të tillë është objekt i detyrimeve doganore në masën 2% mbi çmimin e pagueshëm nga Investitori i Projektit për shpërndarjen e këtij gazi natyror CIF (Incoterms); dhe

b) konsumi i gazit që shërben si karburant në stacionet kompresore është objekt i TVSH-së së importit në normën e zbatueshme dhe se kjo TVSH importi është e rimbursueshme nga Investitori i Projektit si importues dhe se ky gaz natyror është objekt i detyrimeve doganore në masën 2% për vlerën e saj të tregut, e cila do të bazohet në normën mesatare të tregut në pikën italiane të shkëmbimit virtual (Italian Punto di Scambio Virtuale) për muajin në të cilin gazi ishte konsumuar.

Asnjë taksë energjie apo konsumi nuk do të zbatohet përveç detyrimeve doganore dhe TVSH-së së importit në Shqipëri.

8. Trajtimi tatimor i zhvillimit dhe rifaturimi i kostove të ndërtimit. Është pranuar dhe konfirmuar se të gjitha shpenzimet e kryera për zhvillimin dhe ndërtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik (përfshirë infrastrukturën shqiptare) do të mbarten nga Investitori i Projektit dhe, si pasojë, çdo rifaturim i zhvillimit dhe kostot e ndërtimit të kryera fillimisht nga selitë e përhershme të Investitorit të Projektit në Shtet ndaj Investitorit të Projektit nuk do të jenë objekt i ndonjë takse direkte ose indirekte në Shqipëri.

9. Zbritja e shpenzimeve. Është pranuar dhe konfirmuar se neni 20 i ligjit nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe paragrafi 3.5 i udhëzimit të Ministrit nr. 5, datë 30 janar 2006 dhe neni 21 i ligjit për tatimin mbi të ardhurat nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998 dhe paragrafi 3.6 i udhëzimit të Ministrit nr. 5, datë 30 janar 2006 do të zbatohet si zbritje e shpenzimeve.

10. Trajtimi tatimor i shpërndarjes së gazit natyror për konsumatorët. Është pranuar dhe konfirmuar se përveç sa parashikohet në mënyrë specifike në paragrafin 7 të kësaj shtojce, nuk do të lindë asnjë përgjegjësi për çdo lloj takse si pasojë e shpërndarjes së gazit natyror te konsumatorët në territorin shqiptar në pikën lidhëse të rrjetit shqiptar.

11. Trajtimi i importit dhe i eksportit. Është pranuar dhe konfirmuar se asnjë ndalim ose kufizim, pavarësisht nga emrat e tyre dhe origjinës, përveç pagesave, taksave apo detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje, nëse janë bërë efektive përmes kuptimeve, licencat e importit apo eksportit ose masa të tjera, do të institucionalizohen ose do të mbahen nga Shteti apo nga secila Palë Shtetërore në importimin ose në eksportimin e gazit natyror, mallrave ose shërbimeve të tjera në lidhje me aktivitetet e Projektit.

SHTOJCA 6 LICENCAT EKZISTUESE

I. Lejet minerare, të cilat kryqëzohen me itinerarin e Gazsjellësit të TAP

1. Leja minerare për shfrytëzim L 1545 – tipi i mineralit bakër – lëshuar në favor të North Star Mining sh.p.k., të ndodhur në Rehove – komuna Vithkuq, Korçë, në datën 15.4.2011.

2. Leja minerare për shfrytëzim L 780 – tipi i mineralit gëlqeror – lëshuar në favor të Anonime sh.p.k., të ndodhur në Poshnje – Berat, në datën 26.7.2004.

3. Leja minerare për shfrytëzim L 836 – tipi i mineralit gëlqeror – lëshuar në favor të I.B.E sh.p.k., të ndodhur në Poshnje – Berat, në datën 30.12.2004.

4. Leja minerare për shfrytëzim L 1437 – tipi i mineralit argjilat për tullat – lëshuar në favor të D.K.S Group sh.p.k., të ndodhur në Vala – Poliçan, në datën 16.9.2009.

5. Leja minerare për shfrytëzim L 1577 – tipi i mineralit gëlqeror – lëshuar në favor të ADMIR sh.p.k., të ndodhur në Kodra Konizbaltës, në datën 18.6.2012.

6. Leja minerare për shfrytëzim L 889 – tipi i mineralit gëlqeror – lëshuar në favor të Rubin Petrol Patos sh.p.k., të ndodhur në Guri i Bardhë – Veterik, Ura Vajguore, në datën 11.7.2005.

II. Kryqëzohet me itinerarin e Gazsjellësit të TAP- Marrëveshja për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në fushën e naftës Patos – Marinza nënshkruar me Bankers Petroleum Ltd. (ish-Saxon International Energy Ltd.) miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 16.7.2004.

III. Koncesionet e hidrocentraleve që kryqëzohen me itinerarin e Gazsjellësit të TAP

1. Koncesioni i hidrocentralit “Mollaj” në rrethin e Korçës, në basenin ujor të Devollit mbi lumin Përroi i Dunavecit – lëshuar në favor të konsorciumit privat (Bilisht Kompani sh.p.k. dhe REJ sh.p.k.) më 15.6.2009.

2. Koncesioni i hidrocentralit “Osum nr. 5 Spathare” në rrethin e Beratit, në Basenin Ujor të Osumit mbi lumin Osum – lëshuar në favor të Konsorciumit Privat (Gejosumi LTD, Constructora Quebec LTDA, Orteng Equipamentos E Sistemas LTDA & Pëllumb Çela sh.p.k.).*

3. Koncesioni i hidrocentralit “Osum nr. 8 Peshtan” në rrethin e Beratit, në Basenin Ujor të Osumit mbi lumin Osum – lëshuar në favor të Konsorciumit Privat (Gejosumi LTD, Constructora Quebec LTDA, Orteng Equipamentos E Sistemas LTDA & Pëllumb Çela sh.p.k.).*

IV. Koncesionet potencialë të hidrocentraleve që mund të kryqëzohen me itinerarin e Gazsjellësit të TAP. (Shënim. Të dhënat kontradiktore janë disponueshme për aksin e koordinatave të dams’Centraleve të Hidroenergjisë.)




1. Koncesioni i hidrocentralit “Osum nr. 6 Bogovë” në rrethin e Beratit, në Basenin Ujor të Osumit mbi lumin Osum – lëshuar në favor të Konsorciumit Privat (Gejosumi LTD, Constructora Quebec LTDA, Orteng Equipamentos E Sistemas LTDA & Pëllumb Çela sh.p.k.).*

2. Koncesioni i hidrocentralit “Osum nr. 7 Poliçan” në rrethin e Beratit, në Basenin Ujor të Osumit mbi lumin Osum – lëshuar në favor të Konsorciumit Privat (Gejosumi LTD, Constructora Quebec LTDA, Orteng Equipamentos E Sistemas LTDA & Pëllumb Çela sh.p.k.).*


* Kontrata e Koncesionit për 8 (tetë) hidrocentralet e kaskadës së lumit Osum pritët të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

ANEKSI 1 HARTA E KORRIDORIT TË INTERESIT

Harta bashkëngjitur në faqen në vijim është paraqitur për informacion. Për një hartë shkallë të plotë, lutemi të bëni referim në versionin e paraqitur nga Investitori i Projektit përmes aplikimit për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social.



PIPELINE TAP Trans Adriatic Pipeline		DOCUMENT TITLE OVERVIEW MAP TAP ALBANIA - ROUTE CORRIDOR / COMPRESSOR STATIONS	
TRANS ADRIATIC PIPELINE 1 E.ON New Build & Technology GmbH Alexander-von-Humboldt-Straße 1 45896 Gelsenkirchen	Company Representative : Turid Thormøden	Scale: 1:400,000	Sheet 1 of 1
	Company Reference : C201	Document-No. APL00- ENT - 100 - F - DFO - 0017	Day 00
	Engineer Representative : Elisabeth Schmidt	Originating System	



ORIGINAL SIZE A3

						ORDERING COMPANY	
						TRANS ADRIATIC PIPE	
						PROJECT TITLE	
						TRANS ADRIAT	
						OWNER	
00	2013-04-03	ISSUED FOR INFORMATION				LOM	GED
REV.	DATE	DESCRIPTION				PREPARED	CHECKED
						APPROVED	DATE
						ACCEPTED	

LIGJ
Nr. 117/2013

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË KATËRT SHITESË TË KONVENTËS
EUROPIANE TË EKSTRADIMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin i katërt shtesë i Konventës Europiane të Ekstradimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8107, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

PROTOKOLLI I KATËRT SHITESË
I KONVENTËS EUROPIANE TË EKSTRADIMIT
VJENË 20.9.2012

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokollin,
duke marrë në konsideratë synimin e Këshillit të Europës për të arritur unitet më të madh midis anëtarëve të tij;

me dëshirën për të forcuar aftësinë e tyre individuale dhe kolektive për t'iu përgjigjur krimit;
duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës Europiane për Ekstradimin (ETS nr. 24) të hapur për nënshkrim në Paris më 13 dhjetor 1957 (më poshtë të quajtur "Konventa"), si dhe tri protokollin shtesë të saj (ETS nr. 886 dhe 98, CETS nr. 209), të lidhur në Strasburg përkatësisht më 15 tetor 1975, 17 mars 1978 dhe 10 nëntor 2010;

duke e konsideruar të përshtatshëm modernizimin e disa dispozitave të Konventës dhe plotësimin e saj në aspekte të caktuara, duke marrë parasysh progresin e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje penale që prej hyrjes në fuqi të Konventës dhe protokolleve shtesë të saj;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kalimi i afatit

Neni 10 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

"Kalimi i afatit

1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të Palës Kërkuese.

2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të Palës së kërkuar.



3. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të mos zbatuar paragrafin 2:

a) Kur kërkesa për ekstradim bazohet në veprat penale për të cilat shteti ka juridiksion sipas ligjit të tij penal; dhe/ose

b) Nëse legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij.

4. Në përcaktimin nëse ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të saj, çdo Palë që ka bërë një rezervë sipas paragrafit 3 të këtij neni merr në konsideratë, në përputhje me ligjin e saj, çdo akt ose ngjarje që ka ndodhur në Palën kërkuuese, në masën që aktet ose ngjarjet e të njëjtës natyrë kanë efektin e ndërprerjes ose pezullimit të parashkrimit në Palën e kërkuar.”

Neni 2

Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse

1. Neni 12 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

“Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa bëhet me shkrim. Ajo dorëzohet nga Ministria e Drejtësisë ose një autoritet tjetër kompetent i Palës kërkuuese në Ministrinë e Drejtësisë ose pranë një autoriteti tjetër kompetent të Palës së kërkuar. Një shtet që dëshiron të caktojë një autoritet tjetër kompetent të ndryshëm nga Ministria e Drejtësisë, njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për autoritetin e tij kompetent në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm në lidhje me autoritetin e tij kompetent.

2. Kërkesa mbështetet nga:

a) Një kopje e urdhrit të dënimit ose ndalimit menjëherë të zbatueshëm ose të urdhrit të arrestit ose urdhri tjetër që ka të njëjtin efekt dhe të lëshuar në përputhje me procedurën e parashtruar në ligjin e Palës kërkuuese.

b) Një deklaram i veprave penale për të cilat kërkohet ekstradimi. Koha dhe vendi i kryerjes së tyre, përshkrimet e tyre ligjore dhe një referencë ndaj dispozitave ligjore, duke përfshirë dispozitat në lidhje me kalimin e afatit, përcaktohen sa më saktë që të jetë e mundur; dhe

c) Një kopje të dekretëve përkatëse ose, kur kjo nuk është e mundur, një deklaram të ligjit përkatës dhe një përshkrim sa më të saktë të personit të kërkuar, së bashku me çdo informacion tjetër që do të ndihmojë për përcaktimin e identitetit, kombësisë dhe vendndodhjes së tij/të saj.”

2. Neni 5 i Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës pushon së zbatuari për çdo shtet që bëhet palë e këtij protokoll.

Neni 3

Rregulli i specialitetit

Neni 14 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

“Rregulli i specialitetit

1. Një person që është ekstraduar nuk arrestohet, ndiqet penalisht, gjykohet, dënohet ose ndalohet, me synim zbatimin e një urdhri ndalimi ose dënimi dhe ai ose ajo nuk kufizohet për asnjë arsye në lirinë e tij ose të saj personale për ndonjë vepër të kryer përpara dorëzimit të tij ose të saj, të ndryshme nga ajo për të cilin ai ose ajo ishte ekstraduar, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) Kur pala që e ka dorëzuar atë, bie dakord. Një kërkesë për miratim paraqitet, e shoqëruar me dokumentet e përmendura në nenin 12 dhe të dhëna penale të çdo deklarate të bërë nga personi i ekstraduar në lidhje me veprën penale përkatëse. Miratimi jepet kur vepra penale për të cilën kërkohet është subjekt ekstradimi, në përputhje me dispozitat e kësaj konvente. Vendimi merret sa

më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 90 ditë pas marrjes së kërkesës për miratim. Kur nuk është e mundur për Palën e kërkuar që të respektojë periudhën e parashikuar në këtë paragraf, ajo do të informojë Palën kërkuuese, duke paraqitur arsyet për vonesën dhe kohën e llogaritur, të nevojshme për marrjen e vendimit;

b) Kur ai person që ka pasur mundësinë për t'u larguar nga territori i palës në të cilën ai ose ajo është dorëzuar, nuk e ka bërë këtë brenda 30 ditëve nga lirimi i tij ose i saj përfundimtar, ose është kthyer në atë territor pasi është larguar prej tij.

2. Megjithatë, pala kërkuuese mund:

a) Të kryejë hetime paraprake, përveç masave që kufizojnë lirinë personale të personit përkatës;

b) të marrë masa të nevojshme sipas ligjit të saj, duke përfshirë procedimet në mungesë, për të parandaluar efektet ligjore të kalimit të afatit;

c) të marrë masat e nevojshme për largimin e personit nga territori i saj.

3. Në kohën e nënshkrimit ose depozimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në një kohë të mëvonshme, çdo shtet mund të deklarojë se në derogim të paragrafit 1, një palë kërkuuese që ka bërë këtë deklaratë, kur një kërkesë për miratimin është paraqitur sipas paragrafit 1.a mund të kufizojë lirinë personale të personit të ekstraduar, me kusht që:

a) pala kërkuuese njofton, ose në të njëjtën kohë me kërkesën për miratim sipas paragrafit 1, nënparagrafi a, ose në një kohë të mëvonshme, datën kur synon të fillojë këtë kufizim; dhe

b) pala e kërkuar konfirmon shprehimisht marrjen e këtij njoftimi.

Pala e kërkuar mund të shprehë në çdo kohë kundërshtimin e saj për atë kufizim, i cili do të përfshijë detyrimin për palën kërkuuese, që t'i japë fund kufizimit menjëherë, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, lirinë e personit të ekstraduar.

4. Kur përshkrimi i veprës penale sipas akuzës, ndryshohet gjatë procedimeve, personi i ekstraduar do të procedohet ose dënohet në masën që vepra penale sipas përshkrimit të saj të ri, tregohet nga elementët e saj përbërës si vepër penale që do të lejonte ekstradimin.

Neni 4

Riekstradimi në një shtet të tretë

Teksti i nenit 15 të Konventës bëhet paragrafi 1 i atij neni dhe plotësohet nga paragrafi i dytë i mëposhtëm:

"2. Pala e kërkuar merr vendimin e saj për miratimin e përmendur në paragrafin 1, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 90 ditë pas marrjes së kërkesës për miratim, dhe kur është e zbatueshme, të dokumenteve të përmendura në nenin 12, paragrafi 2. Kur për palën e kërkuar nuk është e mundur që të respektojë periudhën e parashikuar në këtë paragraf, ajo do të informojë palën kërkuuese, duke paraqitur arsyet për vonesën dhe kohën e llogaritur të nevojshme për marrjen e vendimit."

Neni 5

Transiti

Neni 21 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

"Transiti

1. Transiti përmes territorit të një prej palëve kontraktuese miratohet me paraqitjen e një kërkesë për transit, me kusht që vepra penale përkatëse të mos konsiderohet nga pala e kërkuar për të miratuar transitin, si vepër penale të një karakteri politik ose tërësisht ushtarak, duke marrë në konsideratë nenet 3 dhe 4 të Konventës.

2. Kërkesa për transit përmban informacionin e mëposhtëm:

a) Identitetin e personit që do të ekstradohet, duke përfshirë kombësinë ose kombësitë e tij ose të saj, kur janë në dispozicion;



- b) Autoritetin që kërkon transitin;
 - c) Ekzistencën e një urdhri arresti ose dokumenti tjetër që ka të njëjtin efekt ligjor ose të një vendimi të zbatueshëm, si dhe konfirmimin se personi duhet të ekstradohet;
 - d) natyrën dhe përshkrimin ligjor të veprës penale, duke përfshirë dënimin maksimal ose dënimin e vendosur në vendimin e formës së prerë;
 - e) një përshkrim të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, duke përfshirë kohën, vendin dhe shkallën e përfshirjes së personit të kërkuar.
3. Në rast të një uljeje të paplanifikuar avioni, pala kërkuese do të vërtetojë menjëherë se ekziston një prej dokumenteve të përmendura në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi a. Ky njoftim ka efektin e një kërkesë për arrest të përkohshëm të parashikuar në nenin 16 dhe pala kërkuese i paraqet një kërkesë për transit palës në territorin e të cilës ka ndodhur ulja e avionit.
4. Transiti i një shtetasi, sipas nenit 6, të një vendi të kërkuar për miratimin e transitit, mund të refuzohet.
5. Në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, një shtet mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të miratuar transitin e një personi vetëm për disa ose të gjitha kushtet në bazë të të cilave miraton ekstradimin.
6. Transiti i personit të ekstraduar nuk kryhet përmes një territori kur ka arsye të besohet se jeta ose liria e tij ose e saj mund të rrezikohet për shkak të racës së tij apo të saj, fesë, kombësisë ose opinionit politik.”.

Neni 6

Mënyrat dhe mjetet e komunikimit

Konventa plotësohet nga dispozitat e mëposhtme:

“Mënyrat dhe mjetet e komunikimit

1. Për qëllim të Konventës, komunikimet mund të transmetohen me anë të përdorimit të mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera që japin të dhëna me shkrim, sipas kushteve që lejojnë palët për të përcaktuar vërtetësinë e tyre. Në çdo rast, pala përkatëse, sipas kërkesës dhe në çdo kohë, paraqet kopje origjinale ose kopje të vërtetuara të dokumenteve.
2. Shfrytëzimi i Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol) ose kanaleve diplomatike nuk përjashtohet.
3. Në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, çdo shtet mund të deklarojë se për qëllim të nenit 12 dhe nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi a të Konventës, ai rezervon të drejtën për të kërkuar kopjen origjinale ose të vërtetuar të kërkesës dhe dokumenteve mbështetëse.”.

Neni 7

Marrëdhënia me Konventën dhe instrumente të tjera ndërkombëtare

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll interpretohen brenda kuptimit të Konventës. Për sa u përket palëve të këtij protokollit, dispozitat e Konventës zbatohen *mutatis mutandis*, në masën që ato janë të pajtueshme me dispozitat e këtij protokollit.
2. Dispozitat e këtij protokollit nuk cenojnë zbatimin e nenit 28, paragrafi 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me marrëdhëniet midis Konventës dhe marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 8

Zgjidhja miqësore

Konventa plotësohet nga dispozitat e mëposhtme:

“Zgjidhja miqësore

Komiteti European i Këshillit të Europës për Probleme të Krimit informohet në lidhje me zbatimin e Konventës dhe protokollet shtesë të saj dhe bën gjithçka që është e nevojshme për të

lehtësuar një zgjidhje miqësore të çdo vështirësie që mund të lindë nga interpretimi dhe zbatimi i tyre”.

Neni 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës që janë palë ose kanë nënshkruar Konventën. Ai i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit. Një nënshkrues nuk mund të ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë protokoll nëse nuk ka ratifikuar, pranuar ose miratuar më parë konventën ose e bën këtë në të njëjtën kohë. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose aprovimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

3. Në lidhje me çdo shtet nënshkrues, i cili depoziton më pas instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit, ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe tre mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit.

Neni 10

Aderimi

1. Çdo shtet joanëtar që ka aderuar në Konventë mund të aderojë në këtë protokoll pasi të ketë hyrë në fuqi.

2. Ky aderim kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Në lidhje me çdo shtet aderues, protokollin do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe tre mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit.

Neni 11

Objekti i përkohshëm

Ky protokoll zbatohet për kërkesat e marra pas hyrjes në fuqi të protokollit ndërmjet palëve përkatëse.

Neni 12

Zbatimi territorial

1. Në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, çdo shtet mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet ky protokoll.

2. Në çdo kohë të mëvonshme, çdo shtet me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e këtij protokollin për çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, protokollin do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve pararendës, në lidhje me ndonjë territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe gjashtë mujore pas datës ose marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 13

Deklaratat dhe rezervat

1. Rezervat e bëra nga një shtet për dispozitat e Konventës dhe protokollin shtesë të saj, të cilat nuk janë ndryshuar nga ky protokoll, janë gjithashtu të zbatueshme për këtë protokoll, nëse ai



shtet nuk deklaron ndryshe në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit. Kjo zbatohet për çdo deklaratë të bërë në lidhje me ose në bazë të dispozitave të Konventës dhe protokolleve shtesë të saj.

2. Rezervat dhe deklaratat e bëra nga një shtet për dispozitat e Konventës, të cilat ndryshohen nga ky Protokoll nuk janë të zbatueshme ndërmjet palëve të këtij Protokolli.

3. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e këtij protokolli, me përjashtim të rezervave të parashikuara në nenin 10, paragrafi 3, neni 21, paragrafi 5 i Konventës së ndryshuar nga ky protokoll dhe neni 6, paragrafi 3 i këtij protokolli. Reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë.

4. Çdo shtet mund të tërheqë plotësisht ose pjesërisht një rezervë ose deklaratë që ka bërë në përputhje me këtë protokoll, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së tij.

Neni 14 **Denoncimi**

1. Në masën që ka lidhje me të, çdo palë mund ta denoncojë këtë protokoll me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe gjashtë mujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Denoncimi i konventës përfshin automatikisht denoncimin e këtij protokolli.

Neni 15 **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë protokoll në lidhje me:

- a) Çdo nënshkrim
 - b) Depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
 - c) Çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokolli, në përputhje me nenet 9 dhe 10;
 - d) Çdo rezervë të bërë në përputhje me nenin 10, paragrafi 3 dhe nenin 21, paragrafi 5 të Konventës së ndryshuar nga ky protokoll, si dhe nenin 6, paragrafi 3 i këtij protokolli dhe çdo tërheqje të kësaj rezerve;
 - e) Çdo deklaratë të bërë në përputhje me nenin 12, paragrafi 1 dhe nenin 14, paragrafi 3 të Konventës të ndryshuar nga ky protokoll, si dhe nenin 12 të këtij protokolli dhe çdo tërheqje të kësaj deklarate.
 - f) Çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 14 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi;
 - g) Çdo akt, deklaratë, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë protokoll.
- Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Vjenë më 20 shtator 2012 në gjuhët angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëjloj autentike, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës dhe shteteve joanëtare që kanë aderuar në Konventë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 24.4.2013
Doli nga shtypi më 24.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 92 lekë